



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në subjektin Bashkia Devoll

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

Auditim Financiar

BASHKIA DEVOLL

Tiranë, shtator 2025

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
PMNZSH	Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtim
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
USH	Urdhër Shpenzimi
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

		PËRMBAJTJA	Faqe
SHKURTIME			2-2
I		PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-9
	1	Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit	4-5
	2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-6
	3	Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	6-7
II.		HYRJA	7
	1	Objektivat e auditimit dhe Qëllimi i auditimit	7-8
	2	Identifikimi i çështjes	8
	3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9
	4	Përgjegjësitë e audituesve	10
	5	Kriteret e vlerësimit	10
	6	Standardet e auditimit	10-11
	7	Metodat e auditimit	11-12
	8	Dokumentimi i auditimit	12
III.		PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
	1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	13
	2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	14
	2.1.1	Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin e brendshëm	13-25
	2.1.2	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm	25-31
	2.2	Vlerësimi Raportimit Financiar	31-51
	2.3	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	51-87
IV.		GJETJET DHE REKOMANDIMET	88-100

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia Devolli kufizohet në veri me Bashkinë Pustec, në perëndim me bashkitë Maliq dhe Korçë, në jug me bashkinë Kolonjë, ndërsa në lindje me Greqinë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Bilishtit. Sipas Censurit të vitit 2023, Bashkia numëron 25,897 banorë, ndërsa sipas Regjistrisë Civil kjo bashki numëron një popullsi prej 42,388 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 453.27 km². Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 44 fshatra.

Buxheti i Bashkisë Devoll, si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore, financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, nenit 50 “Auditimi i jashtëm”, pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. *Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisë të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm.* 2. *Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë*”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Devoll si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësim me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Devoll. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- mbi vlerësimin e raportimit financiar për vitin 2024.
- mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku.

Vlerësimi i riskut të kontrollit;

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm, për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2%, për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0,7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet. Për vitin 2024 niveli

i materialitetit pranohet në vlerën 20,318 mijë lekë dhe gabimi i lejuar (10% - 20%) në vlerën 2,031 mijë lekë për t'u konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Mbi transaksionet u aplikuan: - teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli); Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit, apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 10 gjetje dhe ka dhënë 11 rekomandime,

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

Nga auditimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit u konstatua si mëposhtë:

- Nuk ka përditësuar formularët e përshkrimit të punës për pozicionet me Kod Pune.

-Nuk janë hartuar programe për forcimin e etikës dhe mirëmbajtjen e aktiveve dhe pajisjeve IT nga çdo përdorues.

- Nuk ka miratuar gjurmët standarde të auditimit dhe listën (hartën)/manualin e proceseve të punës; rregullore të menaxhimit të aktiveve; rregulloren e parandalimit të konfliktit të interesit.

-Nuk ka takime të dokumentuara të GMS, plane dhe raporte vjetore mbi problematikat e hasura dhe zgjidhjen që iu është dhënë gjatë veprimtarisë së njësisë publike.

Nga auditimi mbi veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Devoll, u konstatuan këto problematika kryesore:

-Nuk janë audituar fushat me risk si, Sektori i prokurimit publik, Drejtoria e Urbanistikës dhe zbatimit të kontratave.

Nga auditimi mbi veprimtarinë e raportimit financiar u konstatua problematikat si mëposhtë:

-Nga auditimi u konstatua llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Devoll më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 26,089,133 lekë, ndërsa në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 13,146,699 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Për 5 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Devoll janë ngurtësuar fonde në vlerën 1,312,900 lekë.

- Nga auditimi u konstatua se në llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” janë kontabilizuar 36 projekte investime me vlerë kontrate 313,198,535 lekë. Nga këto kontrata deri në datën 31.12.2024 janë realizuar punime në vlerën 273,652,147 lekë dhe vlera e mbetur e pa realizuar është në shumën 42,085,797 lekë.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Bashkia Devoll duhet të ndërmarrë masa për të organizuar trajnime të rregullta mbi etikën, integritetin dhe kontrollin e brendshëm për stafin. Gjithashtu të caktojë një koordinator për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të hartojë dhe miratojë manuale pune për njësitë strukturore,

si dhe të sigurojë miratimin dhe zbatimin e gjurmës së auditimit për çdo drejtori, në përputhje me kërkesat ligjore.

-Bashkia Devoll, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të hartojë dhe miratojë rregullore për menaxhimin e IT-së dhe sigurinë e të dhënave, si dhe të krijojë një sistem të qartë monitorimi dhe raportimi për ndjekjen e objektivave dhe për rritjen e efektivitetit të kontrollit të brendshëm në të gjitha nivelet

- Njësia e Auditimit të Brendshëm të përmirësojë planifikimin e auditimeve përmes një frekuence të rregullt në të gjitha njësitë, vlerësimin të riskut dhe mjedisit të kontrollit, dhe përdorimit të testeve individuale për dokumentim më të mirë. Të vendoset sistem monitorimi dhe vetëvlerësimi periodik, si dhe të përcaktohen afate të qarta për zbatimin e rekomandimeve.

-Drejtoria e Financës, Bashkia Devoll të kryej saktë amortizimin e llogarisë së klasës 2, për të pasur informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

- Drejtoria e Financës të kryejë një analizë të detajuar të dokumentacionit financiar dhe ligjor të të dhënave për llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstrukione”. Gjatë vitit 2025 të marrë masa për sistemimin e vlerës 119,680,203 lekë.

-Drejtoria e Financës pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

-Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Projekteve dhe Investimeve, të marrin masa, për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466 dhe duke njoftuar subjektet, për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm, për të sistemuar dhe zhbllokuar garancitë, të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.

I. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Devoll për periudhën ushtrimore 2024, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

*"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Devoll janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikuar me rezervë**”.*

Baza për opinionin të modifikuar me rezervë¹.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA^{-të}). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin

¹ Një “Opinion i modifikuar me rezervë”, jepet në rastet kur: - audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë;

e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga njësia shpenzuese Bashkia Devoll, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 është 73,128 mijë lekë.

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

Nga auditimi ka rezultuar se në disa raste, trajtuar hollësisht në Raportin e Auditimit, nga Drejtoria e Financës janë kryer veprime mbi pasqyrimin e ngjarjeve ekonomike në kontabilitet në mënyrë jo të drejtë, kryesisht:

-Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione” është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 119,680,203 lekë. Në këtë llogari janë kontabilizuar 10 aktive të cilat nuk janë aktive që nuk janë posedim të Bashkisë Devoll. Këto janë asete në pronësi të komunitetit të cilët nëpërmjet programeve të ndryshme sociale janë përfitues të granteve të ndryshme.

-Llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata” është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 271,112,738 lekë. Në këtë llogari janë kontabilizuar 36 investime jo me vlerën e kryer të punimeve por me vlerën e mbetur të kontratës.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. prot. 614/1, datë 30.05.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së i ndryshuar, nga data 05.06.2025 deri në datë 07.07.2025, në subjektin Bashkia Devoll për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024 u krye auditimi “Mbi auditimin Financiar”, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. K. H., Përgjegjës grupi,
2. Xh. K., auditues;
3. S. J., auditues;
4. A. S., auditues;

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objektivat dhe qëllimi

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve të aktivitetit të subjektit për periudhën e aktivitetit të audituar.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t'i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

Në përfundim të auditimit, hartohet Raporti i Auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Devoll.

2. Identifikimi i çështjes

Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 *“Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi”*, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Devoll, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Devoll.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Kryetari i Bashkisë Devoll (*Administratori i Përgjithshëm*), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës

për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Devoll, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësive së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.²

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t’i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Bashkisë Devoll dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si përkatësia, plotësia, saktësia vlerësimi, periudha, klasifikimi, kuptueshmëria, ligjshmëria dhe rregullsia, ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi, transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Devoll është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet

² Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, neni 15

ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- *Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit:* Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm publik*”; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes Vendore*”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues*”; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “*Për miratimin e manualit të MFK*”; Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 “*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*”.

- *Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:* Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*”; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “*Për huamarrjen e qeverisjes vendore*”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*” i ndryshuar; VKM 783 datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël*”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” etj.; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “*Për përgatitjen e buxhetit vendor*”; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*”.

- *Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:* Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*”; VKM nr. 248, date 10.4.1998 “*Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre*” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël*”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “*Për procedurat afatet*”.

kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” .

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

6. Standardet e auditimit

ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodat e auditimit

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
 - *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë. Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u hartuan dhe u mbajtën 3 akt-konstatime dhe 1 akt-verifikimi. Gjatë hartimit të projekt-raportit, sipas përcaktimeve ligjore nuk janë paraqitur kundërshtime nga subjekti Bashkia Devoll.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm:

Auditimi në Bashkinë Devoll u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan disa të meta e dobësi në drejtim të menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe kontabilizimit të klasave të llogarive.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin dhe realizimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar

subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Zona Gjeografike: Bashkia Devolli kufizohet në veri me Bashkinë Pustec, në perëndim me bashkitë Maliq dhe Korçë, në jug me bashkinë Kolonjë, ndërsa në lindje me Greqinë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Bilishtit. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 453.27 km². Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 44 fshatra.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2024, Bashkia Devoll numëron 25,897 banorë. Bashkia e Devollit ka një sipërfaqe prej 453.27 km².

Historik i zhvillimit ekonomik:

Bashkia e Devollit është një zonë që dominohet nga popullsia me banim në fshatra, sigurimi i të ardhurave të cilës mbështeten në dy burime kryesore, bujqësia dhe blegtoria nga njëra anë dhe remitancat nga emigracioni nga ana tjetër. Përveç kultivimit të kulturave të ndryshme, banorët merren shumë me pemëtarinë duke qenë ndër zonat me prodhim më të lartë në vend. Blegtoria është një tjetër aspekt përmes të cilës banorët gjenerojnë të ardhura.

Në kuadër të nxitjes së turizmit, qyteti i Devollit ka përfituar grante të kushtëzuara për përmirësimin e infrastrukturës së qytetit. dhe të zonave përreth.

Megjithëse janë kryer investime të mëdha në infrastrukturë kjo zonë vazhdon të karakterizohet nga depopullim i shpejtë.

Sfidat me të cilat përballlet: Bashkia përballlet me një sërë sfidash të rëndësishme janë: Menaxhimi i mbetjeve urbane dhe sistemimi i rrjetit të kanalizimeve; Ndërhyrja në infrastrukturën e rrugëve dytësore të qytetit dhe fshatrave përreth, mirëmbajtja e institucioneve arsimore dhe shëndetësore; Mbështetja dhe nxitja më tej e turizmit historik dhe kulturor përmes lehtësimin e procedurave dhe politikave fiskale të banorëve për vetëpunësim në këtë fushë, ruajtjen e banesave muzeale nga erozioni dhe zjarret, por dhe ndalimi i ndërtimeve pa leje në qendrën historike; Krijimi i mundësisë së integrimit të formave alternative të turizmit në zonat përreth qytetit, si ekoturizmi dhe turizmi i aventurës; Ripërtëritja e jetës kulturore dhe artistike të zonës, por dhe zhvillimi i ambienteve dhe aktiviteteve sportive për rritjen e përfshirjes së të rinjve në jetën sociale të qytetit, etj.

Rëndësia e këtij auditimi është të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur që subjekti i audituar të ndër marrë veprimet korrigjuese sipas rastit, të rritë përgjegjshmërinë në llogaridhënie, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara, si dhe parandalimin e shkeljeve me synim rritjen e vlerës së pasurisë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Devoll, nga grupi i auditimit u kryen verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit

të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët MFK: “Mjedisi i kontrollit”, “Menaxhimi i riskut”, “Aktivitetet e kontrollit”, “Informimi & Komunikimi” si dhe “Monitorimi & Raportimi”, në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime”, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri-tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxherial dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrave, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Referuar nenit 20 të Ligjit nr. 10296 “Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli”, titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit. Nga auditimi u konstatua se, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, Kreu II, neni 8, pika 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e Titullarit”; neni 9 pika 4/a “Përgjegjshmëria menaxheriale e Nëpunësit Autorizues”, në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i ndryshuar, Kreu IV.

Njësia Publike demonstron angazhim për integritetin dhe vlerat etike

Mjedisi i kontrollit është një komponent thelbësor i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK), që siguron vendosjen dhe realizimin e objektivave të institucionit. Ai përfshin:

- Etikën profesionale dhe integritetin e stafit;
- Strukturën organizative, ndarjen e qartë të përgjegjësive dhe linjat e raportimit;
- Politikat për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin e aftësive profesionale;

Ligji nr. 10296/2010 përcakton përgjegjësinë e titullarit të institucionit për ngritjen dhe përmirësimin e këtij mjedisi.

Faktorët e mjedisit të kontrollit të brendshëm përfshijnë:

- a. integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike;
- b. politikatat menaxheriale dhe stilin e punës;
- c. strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;
- d. politikatat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- e. aftësitë profesionale të punonjësve.

a. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike:

- Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, ka rezultuar se Titullari i Bashkisë Devoll, ka përcaktuar kuadrin e sjelljes së menaxherëve dhe stafit nëpërmjet miratimit të Rregullores së Brendshme.

- Nga Titullari janë ndërtuar mekanizma të cilat i dedikohen ankesave për korrupsion, bazuar në Ligjin nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar. Në lidhje me këtë ka dalë Urdhri i Ministrit nr.360/3 prot., datë 12.10.2018 “Për ngritjen e Njesisë Përgjegjëse për Sinjalizimin e Brendshëm”;
- Janë miratuar si mëposhtë:
 - Regjistri i mbrojtjes së sinjalizuesit nga hakmarrja, regjistri i sinjalizimit të brendshëm në Njësinë Përgjegjëse.
 - Regjistri i sinjalizimit të jashtëm pranë ILDKPKI.
- Bashkia Devoll ka kryer në përputhje me Ligjin nr. 152/2013 me ndryshime si dhe me aktet në zbatim të tij vlerësimin e nëpunësve civilë dhe atyre me kod pune.

b. Politikat menaxheriale dhe stili i punës;

- Në Bashkinë Devoll janë të përcaktuara rolet e Titullarit të institucionit dhe Nëpunësit Autorizues.

Në nenin 3 të rregullores janë përcaktuar qartë strukturat përbërëse dhe funksionet si ato politike dhe administrative. Gjithashtu, në nenet 4 dhe 13 janë përcaktuar funksionet dhe detyrat e Titullarit dhe Sekretarit të Përgjithshëm, duke cilësuar dhe formën e komunikimit dhe raportimit. Përcaktimi i tyre është bërë në përputhje me Ligjin nr. nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit” dhe nenin 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”.

- Gjithashtu, në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar neni 8, ku përcaktohet kompetenca për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, titullari i Bashkisë Devoll, për vitin 2024 ka ngritur *Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS)* me Urdhrin e Kryetarit nr. 68 datë 04.03.2024 me nr. 662 prot., datë 04.03.2024 “Për krijimin e GMS” i ndryshuar datë 10.05.2024. Referuar Udhëzimit nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” përcaktohet se: “*GMS duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike*”. Gjatë vitit 2024 GMS ka zhvilluar disa mbledhje të cilat nuk i ka pasqyruar në regjistër, por vetëm me proces verbale.
- Nga auditimi rezultoi se GMS ka realizuar 1 takim në fazën strategjike dhe ka hartuar grafikun e takimeve dhe miratuar kalendarin e hartimit të PBA 2025-2027 dhe më pas janë miratuar nga Këshilli Bashkiak përkatësisht “faza strategjike dhe Faza finale miratuar me Vendimin Nr. 69 datë 27.12.2024 “Për miratimin e Buxhetit për vitin 2025 dhe PBA përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Devoll” .

- Projekt Planit vjetor 2024 të Buxhetit, është miratuar me Vendimin nr. 99 datë 18.12.2023;

GMS	Plani dhe grafiku i takimeve	Proces verbalet e takimeve
	Vendim nr. 99 datë 18.12.2023	datë 25.03.2024
	.	datë 24.04.2024
	Urdhër nr. 68 datë 04.03.2024 “Për krijimin e GMS”	datë 06.06.2024
		datë 02.09.2024
		datë 19.11.2024

Burimi: Bashkia Devoll dhe grupi i auditimit

- Bashkia Devoll, ka përcaktuar në përputhje me kërkesat ligjore Nëpunësin autorizues dhe Nëpunësin zbatues, të cilët janë konfirmues sipas sistemit me dy firma të shpenzimeve (nënshkrim elektronik).

Në Bashkinë Devoll për realizimin e objektivave me efikasitet, ekzistojnë dhe përdoren manuale për proceset kryesore operacionale dhe financiare, të cilët specifikojnë qarkullimin e dokumentacionit. Veprimtaritë e Kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave:

Nr.	Sektorët	Manualet që përdoren
1	Sektori i Financës	» Manuali i Klasifikimit të llogarive
		» Manuali i pasqyrave financiare
2	Drejtoria e Shërbimit Urban dhe Shërbimeve Publike	» Manuali teknik i punimeve të ndërtimit në fuqi, miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015” Për miratimin e manualeve teknike të punimeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave të tyre.
3	Njësia e Prokurimit	» Manuali mbi prokurimin elektronik në SPE të blerjeve me vlerë të vogël
		» Manuali mbi përdorimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE)

Veprimtaritë e kontrollit, përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.

- Lloji i Kontrollit që zbatohet në Bashkinë Devoll është ai parandalues, ndërsa kontrollet pas faktit realizohen çdo vit nga *KLSH* dhe nga NJAB

a) Kontrolle në shqyrtimin e dokumentacionit që nënshkruhet, praktika e saj dhe verifikohet saktësia e materialit;

b. Ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person pasi janë të miratuar (NA-NZ);

c. Të gjitha angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA&NZ (sistemi i dy firmave);

d. Çdo dalje e Aktiveve afatgjata autorizohet dhe monitorohet nga NA; kontroll i dokumenteve të inventarëve, regjistrave financiarë, librat e kontabilitetit etj.

e. *Nuk ka* rregullore për Sistemet IT në vitin 2024 të cilat nuk iu janë vënë në dispozicion çdo përdoruesi;

f. Parashikuar procedura të qarta mbi komunikimin e shkresave brenda dhe jashtë Bashkisë: hyrja, trajtimi, mbajtja e dokumentacionit lidhur me depozitimin e protokollimin, komunikimin shkresor dhe elektronik;

g. Komunikimi dhe trajtimi urdhrave të brendshëm dhe udhëzimeve përshtatur sipas përgjegjësi individuale të çdo pozicioni;

h. Institucioni ka parashikuar politika të ruajtjes së dokumenteve, *nuk ka* një plan masash për trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin gjatë punës;

i. Bashkia Devoll *ka hartuar* dhe është në fazë shqyrtimi për miratim nga Titullari në cilësinë e NA, Manualin e proceseve për menaxhimin e aktiveve vendore”. Ky dokument është një kombinim i “Manualit të proceseve të punës” dhe Rregullores për menaxhimin e aktiveve të Bashkisë, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik.

j. Bashkia Devoll me Urdhër e Kryetarit nr. 31 datë 23.01.2024 dhe nr. 226 prot., datë 23.01.2024, ka miratuar “Ngritjen e strukturës përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Bashkinë Devoll” të përbërë nga 3 anëtarë: Sekretar i përgjithshëm në cilësinë e përgjegjësit të njësisë (NJSMS);

c. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;

Me miratimin e VKB nr.101, datë 22.12.2023 dhe Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Devoll me nr.05, datë 10.01.2024 është miratuar Struktura Organizative të Bashkisë Devoll. Për zbatimin e kësaj strukture është miratuar Urdhri nr.06, datë 10.01.2024 për periudhën objekt auditimi (2024) struktura organizative, pozicionet e punës, detyrat, linjat e raportimit janë të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme, por jo në mënyrë të detajuar. Numri total i miratuar është 416 punonjës.

d. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;

Bashkia Devoll ka përcaktuar në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm e miratuar me vendimin 06 datë 10.01.2024 me nr. 88 prot., datë 10.01.2024;, dhe ka përshkrime për çdo pozicion pune jo me detaje.

- Nga auditimi mbi “Menaxhimin e burimeve njerëzore” objekt i këtij auditimi, ka rezultuar se përgjithësisht Bashkia Devoll ka ndjekur politika të drejta dhe të qarta në lidhje me rekrutimin, emërimin, vlerësimin e performancës, ngritjen në detyrë etj., të stafit;
- Në dosjen e çdo punonjësi ndodhej përshkrimi individual të punës;
- Vlerësimi periodik i performancës së punonjësve është kryer gjatë vitit 2024 në zbatim të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe VKM nr. 109, datë 26.02.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë", i ndryshuar;
- Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkia Devoll, është pasqyruar në HRMIS, të dhënat për edukimin, trajnimet, rekrutimet, procedurat disiplinore, etj. për të gjithë punonjësit e institucionit, pasi faqja ishte përditësuar dhe kishte probleme të vazhdueshme.

e. Aftësitë profesionale të punonjësve

Aftësimi profesional i punonjësve është një proces i vazhdueshëm dhe i domosdoshëm me qëllim përditësimin me njohuritë e reja të fushave përkatëse. Kjo kërkon që kërkesat sipas nevojave individuale të jenë të materializuara në planet vjetore të trajnimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional të stafit. Nga auditimi ka rezultuar se:

- Bashkia Devoll ka hartuar planifikim vjetor të trajnimit të stafit, për vitin 2024, i cili i është përcjellë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike me e-mail.
- Kërkesat e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike për vlerësimin e nevojave për trajnim ju janë shpërndarë stafit të Bashkisë Devoll me email. Bashkia Devoll në mënyrë periodike merr informacion mbi trajnimet e kryera nga punonjësit. Për vitin 2024 janë trajnuar 26 nëpunës.

Konstatim 1:NjSMS nuk ka të përditësuar Rregulloret “Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja nga njësia e sinjalizimit” shoqëruar me regjistrin, i përcaktuar si formulari tip I dhe tip II, në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” neni 19 pika 8. Kjo rregullore është miratuar me Urdhërin nr 501, datë 31.12.2019 “Për hetim administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjes së konfidencialitetit” dhe me Urdhërin 501/1, datë 31.12.2019 “Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja”, megjithëse ka të ngritur strukturën e sinjalizimit edhe për vitin 2024.

- Për vitin 2024 Bashkia Devoll, vazhdon të mos ketë hartuar “Rregulloren e Parandalimit të konfliktit të intereve”;

- Për periudhën 01.01.2024-31.12.2024, grupit të auditimit iu vu në dispozicion raporti vjetor i dërguar në ILDKPKI me nr. 105 prot., datë 14.01.2025 për vitin 2024, i cili rezulton pa raste

konflikti interesi në procedurat e realizuara në punë publike, mallra e shërbime gjatë vitit 2024. Deri më 31.12.2024 në Bashkinë Devoll nuk ka patur raste informacioni/denoncimi nga komuniteti, grupe interesi apo media për raste të konfliktit të interesit.

4 Bashkia Devoll ka faqen e saj zyrtare në ëeb me adresë <https://.bashkiadevoll.gov.al/> dhe pasaportën e Bashkisë në Portalin Porta Vendore me adresë <https://portavendore.al/bashkia-devoll/pasaporta-e-bashkise-devoll/>, të cilat përdorin një lidhje të sigurt (connectionsecurity) HTTPS (HyperTextTransferProtocolSecure), që do të thotë se serveri i faqes së internetit përdor një certifikatë sigurie, për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletuesit e ndryshëm;

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva.

Nga auditimi i të dhënave rezulton se Bashkia Devoll ka përgatitur Planin Buxhetor Afatmesëm (PBA), ku evidentohen të gjitha objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet përkatëse. Objektivat e përfshira në planet vjetore të veprimtarisë, përfshirë planifikimin e investimeve dhe planet buxhetore vjetore, janë në përputhje me strategjitë dhe politikat sektoriale, si dhe me vizionin dhe misionin e përcaktuar në Planin e Përgjithshëm Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Devoll. Këto objektiva bëhen të njohura për stafin e bashkisë përmes shkresave drejtuar drejtorive, dhe prezantohen në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Këshillin Bashkiak, si dhe në dëgjesat me publikun.

-Mungon evidenca për përcaktimin e niveleve të tolerancës së riskut, ç’ka bën që gjatë monitorimit të zbatimit të buxhetit, Bashkia të mos ketë mundësi të vlerësojë nëse është arritur niveli i dëshiruar i performancës financiare dhe realizimi i objektivave.

Në lidhje me parimin 7:“Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin e ngjarjeve apo situatave që mund të dëmtojnë arritjen e objektivave të njësisë publike, duke siguruar që këto objektiva të realizohen me siguri të arsyeshme. Sipas nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, titullari i njësisë publike duhet të miratojë një strategji menaxhimi risku, e cila duhet të përditësohet çdo tre vjet ose kur ka ndryshime të rëndësishme në mjedisin e riskut. Për më tepër, nëpunësi autorizues duhet të analizojë dhe përditësojë kontrollet për minimizimin e riskut të paktën një herë në vit.

-Në rastin e Bashkisë Devoll, është hartuar Strategjinë e Menaxhimit të Riskut (nr. 662 prot., datë 04.03.2024), por deri në përfundim të periudhës së auditimit, kjo strategji nuk është përditësuar për periudhën e ardhshme 3-vjeçare.

Në nenin 10 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se “Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përmbushje të përgjegjësive të tij, nëpunësi autorizues mund t’i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së financës.”

Me shkresë me datë 04.03.2024 (NA) për vitin 2024 ka nxjerrë Urdhrin nr. 626, datë 04.03.2024, për ngritjen e Grupit për Menaxhimin dhe Koordinimin e Riskut në Bashkinë Devoll. Ky veprim është në mbështetje të nenit 8/b dhe 11 të ligjit nr. 10296, “Për menaxhimin financiar dhe

kontrollin”, i ndryshuar, ku janë përcaktuar z. E.D., si Koordinator i riskut i cila mban pozicionin Kryetarit të Bashkisë Devoll.

Është hartuar dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë regjistri i riskut me urdhrin nr.68/1, datë 04.03.2024 “Për menaxhimin dhe koordinimin e riskut”.

Në këtë regjistër janë identifikuar dhe vlerësuar risqet për secilën drejtori përkatëse, duke përfshirë të gjitha risqet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm. Qëllimi është përgatitja e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut.

Grupi i GMS, Bashkia Devoll:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Statusi në GMS
1	E. D.	Kryetar i Bashkisë	Kryetar
2	E. P.	N/Kryetar	Koordinator MFK dhe DEMP
3	Xh. K.	N/Kryetar	Koordinator Risku
4	A. F.	NZ	Sekretar i GMS
5	G. K.	Dr. AUKA	Anëtar dhe DEMP
6	B. K.	Dr.ShSoc Streh	Anëtar
7	Xh. P.	Dr.Ars,Kult Sport	Anëtar
8	A. S.	Sekret i Pergj	Anëtar
9	A. K.	Audit i Brendshëm	Pa të drejtë Vote

Burimi: Bashkia Devoll

Në lidhje me parimin 8: “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”.

Institucioni nuk ka kryer vlerësimin e riskut të mashtrimit, për shkak se mungojnë politika dhe procedura të përcaktuara për këtë fushë. Gjithashtu, nuk janë krijuar evidenca për monitorimin e riskut nga niveli i lartë drejtues, duke mos realizuar vlerësime periodike të ekspozimit ndaj veprimtarive mashtruese. Kjo situatë paraqet një rrezik për funksionimin e bashkisë dhe arritjen e objektivave, si dhe pengon marrjen e masave efektive kundër mashtrimit, rryshfetit dhe korrupsionit.

-Në rregulloren e brendshme mungojnë përcaktimet për detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut, ç’ka kufizon funksionimin efektiv dhe të plotë të këtij komponenti të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK).

Në lidhje me parimin 9: “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.

-Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel mesatar.

-Nuk është bërë përditësimi i riskut dy herë në vit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 3 – Përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të riskut: Koordinator ka detyrën për të organizuar dhe monitoruar procesin e menaxhimit të riskut në njësinë publike, duke përfshirë identifikimin, vlerësimin, dhe përditësimin e riskut në mënyrë të vazhdueshme, pika 4 – Hapat për ngritjen e sistemit të menaxhimit të riskut: Përfshin edhe përditësimin periodik të riskut, duke rekomanduar përditësime më të shpeshta, të paktën dy herë në vit, për të siguruar që sistemi i menaxhimit të riskut përshtatet me ndryshimet e mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm. Mospërbushja e kësaj kërkesë është në kundërshtim me rregulloret në fuqi dhe dobëson efektivitetin e menaxhimit të riskut në institucion

-Nga të dhënat e hartimit të kalendarit të trajnimeve rezulton se janë planifikuar trajnime nga personeli përgjegjës për menaxhimin e riskut, por janë të pamjaftueshme për të përmbushur nevojat e plota të këtij procesi.

III. Komponenti: “ Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: “ Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”.

Në rregulloren e brendshme janë përcaktuar në mënyrë të përgjithshme detyrat dhe proceset e punës për secilën strukturë. Për më tepër, ekzistojnë procedura të brendshme që lidhen me këto procese, të cilat bazohen edhe në hartën e proceseve të punës të përcaktuara nga dispozitat ligjore, siç janë procedurat standarde për zbatimin e buxhetit, menaxhimin e aktiveve në sektorin publik, arkivat, dhe kodin e procedurave administrative.

-Nga të dhënat e vëna në dispozicion, rezulton se asnjë prej drejtorive nuk ka të miratuar hartë dhe manual të proceseve të punës në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i cili kërkon që të gjitha drejtoritë dhe sektorët të hartojnë dhe miratojnë proceset dhe manualet e punës për të garantuar funksionimin efektiv të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm. Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, Neni 14, pika 1, shkronja “dh”: “*Njësitë publike duhet të organizojnë dhe të dokumentojnë sistemet e kontrollit të brendshëm, duke përfshirë procedurat dhe manualet e punës, në mënyrë që të garantojnë funksionimin efektiv dhe efikas të menaxhimit financiar dhe kontrollit*”.

-Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimit i tij përpara njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës dhe Buxhetit (Nëpunësi Zbatues – NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare realizohet nga NZ, ndërsa autorizimi për pagesë kryhet nga Kryetari i Bashkisë, i cili ushtron funksionin e Nëpunësit Autorizues (NA).

Në zbatim të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, Bashkia Devoll ka të qarta procedurat për organizimin e prokurimeve publike. Janë ngritur komisione prokurimi sipas fazave të procesit si: komisioni i prokurimit, i hartimit të specifikimeve teknike, i vlerësimit të ofertave dhe i pranimit të mallit/shërbimit, të cilët caktohen nga drejtorët përkatës në varësi të llojit të prokurimit.

Për çdo vit buxhetor, hartohet dhe përditësohet regjistri i planifikimit dhe realizimit të prokurimeve, i cili publikohet në faqen e APP. Procedurat dokumentohen në dosje të veçanta, ku evidencohen të gjitha fazat dhe dokumentet financiare përkatëse (kontrata, fatura, akt-marrje në dorëzim, urdhër-shpenzime, fletëhyrje etj.), të cilat verifikohen dhe vulozen nga Thesari, si dhe pasqyrohen në sistemin SIFQ për çeljen e fondeve dhe veprimet financiare.

Në lidhje me administrimin e dokumentacionit financiar, Bashkia Devoll nuk ka të përcaktuar ndonjë rregullore të brendshme specifike, por vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat shtetërore. Aktualisht, për procesin e pagesave përdoret sistemi elektronik AMFIS, i cili siguron ruajtjen në mënyrë të automatizuar dhe të sigurt të praktikave të pagesave të kryera përmes Degës së Thesarit. Ky sistem ndihmon në menaxhimin dhe gjurmueshmërinë e transaksioneve financiare.

-Nuk janë kryer analiza të detajuara për identifikimin dhe parashikimin e risqeve financiare që lidhen me krijimin e detyrimeve të prapambetura, me qëllim reduktimin dhe shlyerjen në kohë të

tyre. Kjo situatë krijon rrezik për shtim të detyrimeve të prapambetura dhe cënon besueshmërinë e institucionit ndaj palëve të treta.

-Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011“*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike*” i ndryshuar.

- Bashkia Devoll nuk ka krijuar një regjistër aktivesh i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet.

Në lidhje me parimin 11: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.

- Bashkia Devoll nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Ruajtja e të dhënave bëhet në mënyrë shkresore dhe elektronike.

Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste ndërhyrjesh të paautorizuara apo fatkeqësish.

Në lidhje me parimin 12: “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.

- Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, ku përgjegjësitë janë të identifikuar në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë, nuk ka plan-veprime të ndryshme operative për menaxhimin e riskut, pavarësisht se është bërë identifikimi dhe vlerësimi i riskut sipas aktiviteteve.

Në nenin 68 të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Devoll janë përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit për të gjitha nivelet dhe aktivitetet që ajo mbulon. Kjo ndarje e funksioneve siguron parimin e ndarjes së detyrave dhe shmang riskun që i njëjti punonjës të kryejë më shumë se një funksion në të katër fazat e një transakcioni financiar: hartim, miratim, zbatim dhe monitorim.

Gjithashtu, për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e kontratave të sipërmarrjeve në fushën e ndërtimit, përgjegjës është Drejtoria e Planifikimit të Territorit, sipas detyrave të përcaktuara në nenet 72.10 dhe 72.11 të Rregullores së Brendshme. Ndërkohë, Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit të Tokës Bujqësore ka përgjegjësi për monitorimin e kontratave të qirasë për përdorimin e tokës bujqësore, sipas përcaktimeve të nenit 73 të së njëjtës rregullore. Këto përcaktime synojnë garantimin e kontrollit të brendshëm dhe transparencës në administrimin e fondeve dhe pasurive publike.

Gjurma e auditimit:

Ekzistojnë procedura të mirëpërcaktuara për kontrollin e integritetit të të dhënave financiare në Bashkinë Devoll. Përgjegjësit e kontabilitetit kryejnë kontrolle dhe rregullime për veprimet e kryera nga specialistët përkatës, që përfshijnë mbajtjen e ditarëve, hartimin e pasqyrave financiare (PF), rakordimet me Thesarin dhe bankat e nivelit të dytë, përgatitjen e listëpagesave dhe urdhërshpenzimeve. Këto veprime më pas verifikohen nga Drejtori i Financës.

Pasqyrat financiare përfundimtare miratohen nga Nëpunësi Autorizues (NA) dhe Nëpunësi Zbatues (NZ). Për më tepër, auditimi i brendshëm (AB) kryen rishikim të kontabilitetit dhe pasqyrave financiare. Hartimi i PF-ve bëhet në përputhje me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.08.2018 “*Për hartimin e pasqyrave financiare*”.

Gjithashtu, auditimi i jashtëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) jep opinion profesional për besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe nëse ato paraqesin drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen financiare të bashkisë në përfundim të vitit fiskal, duke shërbyer si bazë për besueshmërinë e raportimeve financiare nga njësia.

-Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se asnjë prej drejtorive nuk ka të miratuar hartën e proceseve të punës.

Sipas nenit 16 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar: “Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedurat që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet të dokumentohen në një formë që u mundëson audituesve dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit”. Moszbatimi i kësaj dispozite, si dhe mungesa e hartimit të gjurmëve të auditimit për të gjitha drejtoritë e Bashkisë, përbëjnë shkelje të kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Kjo situatë ndikon negativisht në rritjen e transparencës dhe gjurmueshmërisë së veprimeve operacionale brenda njësisë, duke e bërë të pamundur një monitorim të plotë dhe efektiv nga strukturat e kontrollit të brendshëm, si dhe duke kufizuar kapacitetin mbikëqyrës të strukturave të jashtme të auditimit.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1; me Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 5.2.7 “Monitorimi dhe Raportimi”, me “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: “Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.

Menaxhimi i Informacionit dhe Sistemi i Raportimit në Bashkinë Devoll:

-Identifikimi dhe përçimi i informacionit: Drejtuesit kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e nevojshëm përmes raportimit financiar dhe operacional në nivelet përkatëse, duke e përshtatur atë për personelin e duhur.

-Sistemi i Raportimit: Sistemi aktual i raportimit nuk siguron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave të përgjithshme të institucionit dhe njësive vartëse.

-Raportet e Monitorimit të Buxhetit: Raportet e zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujor dhe vjetor dhe dërgohen pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE). Ka raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, krahasuar me planin dhe fondet e parashikuara. Analiza faktoriale e këtyre raporteve paraqitet pranë menaxhimit dhe Këshillit Bashkiak.

-Raportet për detyrimet e prapambetura: Hartohen dhe dorëzohen çdo muaj pranë Degës së Thesarit dhe çdo katër muaj pranë MFE. Stoku i detyrimeve të prapambetura për vitin 2024 është 7,000 mijë lekë. Detyrimet dhe të drejtat janë evidentuar në llogaritë e klasës 4 në pasqyrat financiare (aktiv dhe pasiv).

-Sistemi i Kontabilitetit: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit operon me program Excel për mbajtjen e kontabilitetit, pa dubluar të dhënat në sistemin zyrtar SIFQ. Specialistët e kësaj drejtorie evidentojnë transaksionet dhe dokumentacionin në SIFQ. Programi excel lejon monitorimin e shpenzimeve dhe hartimin e pasqyrave financiare.

-Akt-rakordimet: Çdo muaj dhe vit kryhen akt-rakordimet për të ardhurat dhe shpenzimet me Degën e Thesarit. Të ardhurat arkëtohen përmes bankës.

-Menaxhimi i Aseteve: Për lëvizjet e Aseteve, (AAGJM) mbahen dokumente financiare. Inventarizimi i asetëve kryhet çdo vit. Procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve amortizuara bëhen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Në përgjithësi, sistemi financiar ka procese të përcaktuara për raportim dhe monitorim, por përdorimi i mjeteve jo-standard (Excel) dhe mungesa e plotësisht të informacionit të plotë në raportim, mund të ndikojnë në efektivitetin dhe transparencën e menaxhimit financiar.

Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm, sistemin elektronik dhe shkresor.

-Informacioni nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve transmetohet herë pas here titullarit të bashkisë, i cili informohet mbi shpenzimet aktuale dhe buxhetin e planifikuar.

-Komunikimi zyrtar mes punonjësve kryhet në mënyra të ndryshme: verbal, shkresor, në format elektronik (e-mail zyrtar), si dhe në rrugë zyrtare shkresore.

-Mbledhjet e stafit drejtues dhe menaxherëve me Këshillin Bashkiak shoqërohen me procesverbale të dokumentuara.

-Në faqen zyrtare publikohen dokumente kryesore si: planet strategjike, raportet periodike, struktura organike, Vendimet e Këshillit Bashkiak, publikime të ndryshme dhe informacione të tjera nga veprimtaria e bashkisë.

-Drejtuesit e programeve kanë qasje në informacionin për miratimet e buxhetit, alokimet dhe rialokimet gjatë vitit, si dhe realizimin faktik të shpenzimeve.

-Hartohen raporte periodike dhe publikime vjetore për performancën e bashkisë lidhur me shërbimet publike të ofruara.

-Bashkia kryen konsultime me publikun dhe palët e interesit, të evidentuara në dokumentin e konsultimit publik, sipas një kalendari të miratuar në fillim të vitit.

Në lidhje me parimin 15: Komunikimi i jashtëm në Bashkinë Devoll:

-Bashkia Devoll ka një faqe zyrtare ëeb ku publikohen informacione të rëndësishme për qytetarët dhe palët e interesit.

-Në rregulloren e brendshme janë përcaktuar mënyrat e informimit, komunikimit dhe qarkullimit të dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit, në nenet:

-Neni 9: Marrëdhëniet me Këshillin Bashkiak;

- Neni 10: Bashkëpunimi ndërmjet strukturave të administratës së bashkisë;

- Neni 11: Marrëdhëniet me institucionet e tjera;

- Neni 13: Marrëdhëniet me publikun.

Në përgjithësi, Bashkia Devoll ka një sistem të mirëorganizuar komunikimi të jashtëm dhe brendshëm, duke përdorur si kanale tradicionale ashtu edhe mjetet elektronike, dhe ka përfshirje aktive të komunitetit përmes konsultimeve publike dhe publikimeve online.

V. Komponenti: “Monitorimi”.

Në lidhje me parimin 16: “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.

- Hartohen plane mujore dhe vjetore pune, si dhe analiza për aktivitetet e bashkisë, por mungojnë raportimet nga drejtuesi e drejtorive mbi përmbushjen e objektivave në bazë impakti dhe produkti.

- Monitorimi aktual është përqëndruar kryesisht në zbatimin e buxhetit çdo katër muaj, ndërsa i kushtohet më pak vëmendje vlerësimit të arritjes së objektivave të kontrollit të brendshëm për ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet.
 - Nuk publikohet raporti i zbatimit të buxhetit në faqen zyrtare të bashkisë brenda afatit ligjor prej një muaji pas përfundimit të periudhës raportuese.
 - Struktura dhe çertifikimi i njësisë së auditimit të brendshëm janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative; nuk janë evidentuar parregullsi. Për vitin 2024 janë realizuar 6 auditime në njësi vartëse dhe një auditim tematik për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme.
 - Monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit nga ana e Bashkisë kryhet nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit, i cili dorëzohet çdo vit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në MFE. Për vitin 2024 me datë 28.02.2025 është dërguar në Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave, Pyetësi i Vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm; “Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Bashkia Devoll dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”; Plan veprimi për kontrollin e brendshëm për çdo komponent të MFK-së. Monitorimi bëhet nëpërmjet veprimtarive para dhe pas faktit, për të garantuar ligjshmëri dhe rregullshmëri të veprimeve, në përputhje me parimet e ekonomizmit, eficiencës dhe efektivitetit.
 - Raportimet pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe GMS-së realizohen në mënyrë të rregullt, në përputhje me parashikimet e Planit Buxhetor Afatmesëm (PBA). Për vitin 2024, Bashkia ka përbushur detyrimin për vetëvlerësimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK), duke dorëzuar dokumentacionin përkatës pranë Njësisë Qendrore të Harmonizimit në Ministrinë e Financave. Dokumentacioni është përcjellë zyrtarisht me datë 28.02.2025, drejtuar Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar (DHMF).
 - Sistemi i kontrollit të brendshëm është objekt rekomandimesh të vazhdueshme nga institucionet mbikëqyrëse dhe monitoruese. Gjatë vitit 2023, rekomandime janë dhënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të KBFP-së, si dhe nga Auditimi i Brendshëm. Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm ka qenë një nga drejtimitet e monitorimit për vitin 2024, gjatë të cilit janë audituar 6 njësi vartëse dhe është kryer një auditim tematik për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve nga auditimet e mëparshme.
- Në Bashkinë Devoll aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungon një analizë sistematike e objektivave dhe e performancës së shërbimeve publike dhe alternativat për përmirësim.

Në lidhje me parimin 17: “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”.

- Sipas kontakteve me drejtuesit e drejtorive dhe përgjigjeve të marra përmes pyetësorëve të vetëvlerësimit, nuk janë raportuar ankesa apo shqetësime në lidhje me funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
- Megjithatë, mangësitë dhe veprimet në kundërshtim me rregullat, të evidentuara nga drejtuesit e programeve, janë trajtuar gjatë mbledhjeve periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin dhe parandalimin.
- Titullari i këtij institucioni si për rekomandimet e lëna nga KLSH edhe për ato të lëna nga Auditimi i Brendshëm, është angazhuar për ndërmarrjen e masave korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve, por nuk ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 24, “Monitorimi” pika 1, me- “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.5, Kapitulli V, Aneksët.

Sa më sipër arrihet në konkluzion se:

Në Bashkinë Devoll për implementimin e Ligjit nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, rezultoi se:

- Ndryshimet në strukturën organizative të Bashkisë Devoll për vitin 2024, janë shoqëruar me pasqyrimin e tyre në *Rregulloren e Brendshme* institucionale, përshkrimet e punës por të pa miratuara në DAP³;
- Përditësimi i dosjeve të personelit;
- Njësia Publike deri më 31.12.2024 nuk ka hartuar *Gjurmët e Auditimit për çdo sektor*;
- Bashkia Devoll deri më 31.12.2024 nuk ka regjistër takimesh të dokumentuara të *Grupit të Menaxhimit Strategjik*, ka realizuar vetëm takimet e mbi tavanet buxhetore të PBA dhe duke mos realizuar takimet e detyrueshme vjetore, për trajtimin e çështjeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Njesisë;
- Nuk kanë hartuar dhe miratuar *Programe vjetore trajnimi* për rritjen e aftësive profesionale të stafin, lidhur me etikën, mirëmbajtjen e aktiveve dhe veçanërisht pajisjeve IT, si dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve apo veprimeve të përditshme që operohen, kjo sipas nevojave dhe kërkesave të cdo njësie të strukturës organizative;
- Nga Bashkia Devoll nuk janë marrë masa për hartimin dhe miratimin e *Hartës(Listës)/Manualit të proceseve të punës* së cdo njësie të strukturës organizative të Bashkisë;
- Nga institucioni *nuk ka një Plan të Kontrollit të Brendshëm* (sipas Aneksit nr. 11 të Manualit), i cili është një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh) me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen. Mungesa e planeve të kontrollit kanë ndikuar dhe në mos monitorimin e detyrave që menaxherët i ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përmbushjes së tyre;

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1- Z. E.D., Kryetar i Bashkia Devoll
- 2- Znj. E.P., Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Devoll

2.1.2 Organizimi i Njesisë së Auditit të Brendshëm;

Nga auditimi i kryer mbi funksionimin e NJAB të Bashkisë Devoll, rezultoi se:

1.Organizimi dhe Funksionimi:

Bashkia Devoll ka ngritur NJAB, struktura e së cilës për vitin 2024 është pjesë e strukturës organike të bashkisë, miratuar fillimisht me VKB nr.101, datë 22.12.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Devoll dhe ndërmarrjeve në varësi”, në përputhje me nenin 64 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr.114/2015, datë 20.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 10, pika 1, ku përcaktohet se: “Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, sipas formave të përcaktuara në geramat a-c të kësaj pike.

³ Për pozicionet me status të Nëpunësit civil

Njësia e auditimit në organikë është përcaktuar dhe funksionon me 3 punonjës në përputhje me VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” pika 3, e cila përcakton se: “Njësia e Auditimit të Brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3(tre) punonjës, përfshirë drejtuesin e njësisë” dhe në përmbushje të detyrimit ligjor të pavarësisë, i parashikuar në Standardin Atributiv nr. 1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditimit të Brendshëm.

Detyrat dhe kompetencat e NJAB janë përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të Funksionimit të Administratës së Bashkisë Devoll, bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 i ndryshuar, Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë, sipas së cilës: “Miraton strukturën, organikën e kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi”. Në nenin 66, 66.1, 66.2 të kësaj rregulloreje janë përcaktuar misioni i njësisë së auditimit të brendshëm, mënyra e organizimit, kuadri ligjor, përgjegjësitë e drejtuesit të NJAB dhe audituesve të brendshëm, detyrat funksionale të tyre, bashkëpunimi me menaxhimin dhe Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm etj.

Tabela Nr.1 :Struktura e NJAB, niveli i arsimit, çertifikimi, përvoja dhe trajnimet e audituesve paraqiten sipas tabelës se mëposhtme:

Nr	Periudha 2023	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi pune	Vjetërsi auditim/vite	Certifikimi	Trajnime vijueshme
1	A.K.	Përgjegjës	I lartë	29	5	2013	Po
2	E.Sh.	Auditues	I lartë	16	8	2013	Po
3	E.Gj.	Auditues	I lartë	15	4 muaj	Pa certifikuar	Jo

Burimi: Bashkia Devoll

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjeve së punonjësve të strukturës së Auditimit të Brendshëm rezulton se, 2 (dy) punonjës janë të pajisur me certifikatë si “Auditues i brendshëm” dhe 1 punonjës është kandidat për auditues të brendshëm dhe është në pritje për regjistrim, pas shpalljes së procedurave nga MF, referuar rregullores “Për procedurat e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik”, neni 3 “Përkufizime” ku cilësohet: “Në kuptim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1) “**Kandidat për auditues të brendshëm**”, (më poshtë kandidati) është punonjësi i njësisë së auditimit në sektorin publik, që plotëson kriteret dhe përgatitet e trajnohet për t’u certifikuar, sipas kërkesave të përcaktuara në këtë rregullore”, si dhe në përputhje me VKM nr. 83, datë 03.02.2016 me ndryshime “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 3.

2. Kuadri rregullator mbi të cilën mbështetet aktivitetin e saj NJAB Bashkia Devoll

Në zbatim të Programit të Auditimit nr.614/1prot., datë 30.05.2025 me e-mailin e datës 10.06.2025 Njësia së Auditimit të Brendshëm referuar dokumentacionit të paraqitur si dhe pyetësorit “Mbi organizimin, funksionimin dhe rezultatet e aktivitetit të njësisë të Auditimit të Brendshëm” rezultoi se NJAB, Bashkia Devoll për veprimtarinë e saj ka të miratuar :

a. Karta e Auditimit të Brendshëm luan rol të rëndësishëm në përmbushjen e objektivave të veprimtarisë audituese të NJAB Bashkia Devoll, është miratuar me Urdhrin nr. 683 datë 19.12.2023, me nr. 4206 prot., datë 19.12.2023 të kryetarit të Bashkisë Devoll, dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MF, me shkresën nr. 4206/1 prot., datë 19.12.2023.

b. Kodi Etik i Auditimit të Brendshëm ka për qëllim të promovojë një kulturë etike nga ana e Njësisë së Auditimit të Brendshëm. Kodi Etik i NJAB në Bashkinë Devoll është miratuar me shkresën nr.735/1prot., date 13.03.2024, të Urdhrit të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll nr. 80/1, datë13.03.2024 në kuadër të zbatimit të Urdhrit të MF Nr.86, date 10.12.2012 “*Për Miratimin e Kodit të Etikës për Audituesit e Brendshëm në Sektorin Publik*”, i ndryshuar.

c. Deklarata e Konfliktit të Interesit të Audituesit të Brendshëm. Të gjitha procedurat kanë të përfshirë Deklaratën e Konfliktit të Interesit si një dokument i detyrueshëm dhe standard që synon të sigurojë paanshmërinë, integritetin dhe objektivitetin e punës së audituesit të brendshëm gjatë realizimit të misionëve të auditimit. Ajo është një garanci etike dhe ligjore që çdo auditues të dhënë përpara fillimit të auditimeve.

d. Plani strategjik 2024-2026 dhe Plani vjetor 2024, janë të hartuar sipas kërkesave të nenit 14, të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” i ndryshuar, të nenit 18, seksioni 3, kreu II në Manualin të Auditimit të Brendshëm, për rishikimin e planeve i është referuar kapitullit III, pika 3.5 “Rishikimi i planeve strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm”. Realizimi i planeve është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE për veprimtarinë e AB në Bashkinë Devoll me shkresën nr. 675 prot., datë 16.01.2025.

Hartimi dhe zbatimi i planeve strategjike nga Auditi i Brendshëm për periudhën 2024-2026. NJAB e Bashkisë Devoll ka hartuar dhe miratuar nga Kryetar i Bashkisë, Planet Strategjike dhe ato vjetore respektive, konform përcaktimeve ligjore, të cilat i ka dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në MFE/Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, brenda afatit kohor (20 tetor).

Angazhimet e auditimeve për vitin 2024 janë kryer në zbatim të Ligjit Nr.114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”, i ndryshuar, në zbatim të Manualit të auditit të brendshëm të miratuar me urdhrin nr.100, datë 15.10.2016, i ndryshuar, të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, kapitulli i IV *Kryerja e Auditimit të Brendshëm, ndjekja e procedurave dhe raportimi e komunikimi i auditimit,*

Për vitin 2024 nga Kryetari i Bashkisë Devoll, z. E.D., me shkresë nr. 2964/1prot., datë 10.10.2023 është miratuar plani vjetor për auditimet në vitin 2024 ku auditime të planifikuara kanë qenë 6 (gjashtë). Ky plan ka qenë i ndarë sipas programeve mujore miratuar përsëri nga Kryetari i Bashkisë Në total janë realizuar 6(gjashtë) auditime, përkatësisht:

1. Misioni i auditimit (Janar-Mars),mbi vlerësimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve të adresuara nga auditi i brendshëm gjatë vitit të mëparshëm:

-Njoftimi i fillimit të auditimit shkresë nr.86 prot., datë 10.01.2024

-Programi i angazhim të auditimit me nr.86/1prot., datë 23.01.2024.

2. Sektori i Projekteve dhe Integritet në BE:

Vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve dhe operacioneve të menaxhimit të brendshëm në strukturat që menaxhojnë fondet IPA dhe fonde të tjera nga BE përfituese të këtyre fondeve.

-Njoftimi i fillimit të auditimit shkresë nr.514 prot., datë15.02.2024

-Programi i angazhim auditimit me nr.514/1prot., datë28.02.2024.

3. Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit dhe Mjedisit:

Aktmarrëveshja midis Bashkisë Pustec dhe Bashkisë Devoll me shkresën 1326 prot, datë 10.10.2023. Miratimi nga Ministria e Financës me shkresë nr.13331prot., datë 07.10.2024

-Njoftimi i fillimit të auditimit shkresë nr.1157 prot, datë 26.04.2024

-Programi i angazhim auditimit me shkresë n nr.1157/1 prot.,datë 28.02.2024

4. Agjencia e Shërbimeve Utilitare, Komunitare dhe Administrative:

-Njoftimi i fillimit të auditimit shkresë nr.1679 prot., datë 27.05.2024,

-Programi i angazhimit të auditimit me shkresën nr.1679/1prot., datë 07.06.2024.

5. Auditim në Bashkinë Pustec sipas Akt-Marrëveshjes:

6. Aktmarrëveshja midis Bashkisë Pustec dhe Bashkisë Devoll me shkresën 1326 prot, datë 10.10.2023. Miratimi nga Ministria e Financës me shkresë nr.13331prot., datë 07.10.2024

-Njoftimi i fillimit të auditimit shkresë nr.3194/1 prot., datë 08.10.2024

-Programi i angazhim auditimit shkresë nr.3194/2prot, datë 21.10.2024

7. Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit:

Për auditimin e analizës së situatës për detyrimet e prapambetura (situatës së borxhit) në Bashkinë Devoll.

- Njoftimi i fillimit të auditimit shkresë nr.3759 prot., datë 18.11.2024;

- Programi i angazhim auditimit shkresë nr.3759/1 prot, datë 03.12.2024;

Angazhimet e auditimeve për vitin 2024 janë kryer në zbatim të Ligjit Nr.114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, në Manualin e auditit të brendshëm të miratuar me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave ndryshuar me urdhërin nr. 4, datë 10.01.2020, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, kapitulli i IV-t "Kryerja e auditimit të brendshëm, ndjekja e procedurave dhe raportimi e komunikimi i auditimit" Standarteve Ndërkombëtare dhe Kodin e Etikës.

Tabela Nr.2: Krahasimi i të dhënave me vitin 2023-2024

Nr	Periudha	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime te planifikuara	Auditime te realizuara	Nga te realizuarat, sipas llojit				
				Perputh	Financ	Kombi	Performace	Tjera
1	Viti 2023	6	6	4		1(përputhshmëri +kombinuar)	1	
2	Viti 2024	6	6	4			2	
	Totali	12	12	8		1	3	

Burimi: Bashkia Devoll dhe Grupi i auditimit

Tabela nr.3: Krahasimi i rekomandimeve 2023-2024

Nr	Periudha	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT							
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim dëmi)			
		Gjithsej	Zbatuar	Ne proces	Pa zbatuar	Gjithsej	Zbatuar	Në proces	Pa zbatuar
1	Viti 2023	25	15	5	5	-	-	-	-
2	Viti 2024	22	14	8		-	-	-	-
	Totali	47	29	13	5				

Burimi: Bashkia Devoll dhe Grupi i auditimit

Nga auditimi mbi rekomandimet e lëna nga NjAB Devoll në misionet audituese të saj, rezulton se numri i rekomandimeve në proces vijnë në rritje dhe rezulton se për vitin 2024 nuk ka rekomandime të pazbatuara. Të dhënat jepen në tabelën nr.5 shprehin se performanca e zbatimit është e mirë, me një nivel zbatimi të përgjithshëm prej rreth **62%**, por ende ka nevojë për

përmirësim në përfundimin e atyre në proces dhe në eliminimin e rekomandimeve të pazbatuara nga 2023. Përsa i përket planifikimit dhe realizimit të auditimeve nga NjAB të Bashkisë Devoll për periudhën 2024, rezulton se NjAB ka realizuar 100%, numrin e angazhimeve audituese të miratuara në “Planin vjetor dhe Strategjik”.

Dosjet e auditimit të përhershme

Për periudhën 01.01.2024-31.12.2024, rezulton se Struktura e NJAB në Bashkinë Devoll është funksionale, por konstatohet se nuk ka siguruar mbulim të plotë me auditim të fushave me risk, si teknologjia e informacionit, sistemi i menaxhimit të të ardhurave apo punimet në terren për investimet publike. Audituesit e Brendshëm duhet të njohin në mënyrë të plotë strukturën organizative, e cila përfshin edhe vlerësimin e sistemeve dhe proceseve që janë pjesë integrale e aktivitetit të përditshëm. NJAB nuk kishte dosjet me dokumentat për këto veprimtari, në kundërshtim me Ligjin nr.114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm, që kërkojnë mbulim të fushave me risk dhe përdorimin e burimeve të nevojshme. Audituesit duhet të njohin mirë njësinë e audituar, ndërsa në NJAB duhet të mbahen edhe dosjet e përhershme për çdo subjekt, si bazë për auditimet e ardhshme.

Dosjet për subjektet e audituara, përmbanin dokumentacionin në përputhje me aktet ligjore/nënligjore në fuqi.

Konstatim Nga ana e Bashkisë Devoll **vazhdon** të mos sigurohet ende mbulimi i plotë me auditim për të gjitha sistemet, veçanërisht në fushën e teknologjisë së informacionit (IT), sistemi i menaxhimit të të ardhurave si dhe i punimeve në terren që lidhen me investimet publike të Bashkisë. Për të garantuar këtë mbulim, përveç kapaciteteve të brendshme, është e nevojshme plotësimi i mëtejshëm me personel të kualifikuar të fushës, veçanërisht në fushat teknike (si inxhinieria, IT, etj), qoftë edhe nëpërmjet përfshirjes së ekspertëve të jashtëm në mungesë personeli të përhershëm.

Në aneksin 1/1 të raportit të auditimit janë paraqitur pasqyra e realizimit të auditimeve gjatë vitit 2024.

NjAB ka realizuar misione audituese me fokus “Vlerësimin e detyrimeve të prapambetura” dhe “Zbatimin e rekomandimeve të lëna”, në përputhje me Udhëzimin nr. 42, datë 27.10.2020 “*Mbi ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik*”. Gjatë këtyre misioneve është vlerësuar edhe statusi i zbatimit të rekomandimeve, ku nga auditimi i dosjeve përkatëse, rezultoi se subjektet e audituara kanë hartuar planet e veprimit brenda afatit 30-ditor, përmes të cilëve NjAB është informuar mbi pranimin ose mospranimin e rekomandimeve si dhe mbi personat përgjegjës për zbatimin e tyre. Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve nga NjAB ka qenë i strukturuar, dhe rezultoi se subjektet e audituara kanë raportuar mbi zbatimin e tyre brenda afatit 6-mujor të parashikuar.

Sigurimi i cilësisë në auditimet e kryera dhe kontrolli i zbatimit të detyrave të lëna

Sigurimi i cilësisë është pjesë e procesit që bën të mundur zbatimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “*Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*” i ndryshuar. Nga Njësia e AB, Bashkia Devoll rezultoi se pas përfundimit të auditimeve të realizuara për veprimtarinë e periudhës 2024, janë lënë gjithsej 25 rekomandime, nga të cilat janë pranuar 22 rekomandime, kjo e pasqyruar në planin e veprimit të hartuar dhe miratuar nga subjekti i audituar

nga të cilat 22 rekomandime të pranura 14 rekomandime të zbatuara dhe 8 rekomandime në proces zbatimi dhe nuk ka rekomandime të pazbatuara.

Vlerësimi i procedurave dhe zbatimit të standardeve në kryerjen e auditimit të brendshëm.

Nga ana e Njësisë së Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Devoll, planifikimi i angazhimit është kryer në përputhje me Manualin e AB, Kapitulli IV, pika 4.1.1, duke zhvilluar takime paraprake me subjektin e auditimit dhe duke dokumentuar procesin e mbledhjes së informacionit dhe përgatitjes së programit të auditimit.

Gjatë angazhimit NjAB ka ndjekur të gjitha fazat e planifikimit, njoftimit paraprak, takimit fillestar, deklarata e konfliktit të interesit, vlerësimi i riskut, përcaktimi i fushave dhe testeve të auditimit, kostot dhe masat për sigurimin e cilësisë. Në zbatim të Manualit të AB (kap. IV, pika 4.1.6), janë adresuar fusha prioritare si: zbatimi i rekomandimeve, vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe MFK-së, mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, përputhshmëria me rregullat dhe ligjin, informacioni, komunikimi dhe monitorimi.

Programet janë hartuar sipas Manualit të AB (Urdhri MF nr. 100, datë 25.10.2016), duke përfshirë qartë subjektin, llojin e auditimit, periudhën, drejtimet dhe grupin e audituesve.

Vlerësimi i procedurave të parashikuara për raportimin dhe komunikimin e auditimit

NjAB e Bashkisë ka ndjekur të gjitha fazat e auditimit sipas Manualit të Auditimit të Brendshëm, nga planifikimi, puna në terren, deri te dokumentimi i gjetjeve. Për shkeljet e konstatuara ishte mbajtur dokumentacion me personat përgjegjës. Gjithashtu, është plotësuar pyetëtori mbi veprimtarinë e NjAB dhe bazuar në nivelin e risku është dhënë opinioni mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm...

- Autorizimi për caktimin e grupit të punës për të kryer angazhimin e auditimit.

- Njoftimi paraprak për fillimin e angazhimit të auditimit.

- ✓ Takimi fillestar për fillimin e misionit të auditimit.
- ✓ Programi i angazhimit të auditimit.
- ✓ Dokumentet që lidhen me kryerjen e angazhimit të auditimit.
- ✓ Testet dhe shënimet e mbajtura nga audituesi.
- ✓ Takimi i ballafaqimit përfundimtar të misionit të auditimit.
- ✓ Projekt Raporti i auditimit.
- ✓ Raporti Përfundimtar i auditimit.
- ✓ Memo (përmbledhja e shkurtër përfundimtare) e cila i është paraqitur titullarit të Institucionit.
- ✓ Monitorimi i brendshëm të aktivitetit të auditimit të brendshëm nga çdo auditues.
- ✓ Kontrolli i vlerësimit të cilësisë për monitorimin e brendshëm për çdo auditim.

Vlerësimi i procedurave për rishikimin e brendshëm të cilësisë së punës audituese.

Nga dosjet objekt auditimi për periudhën audituese, grupi i punës konstatoi se, procedurat e rishikimit të brendshëm të cilësisë së punës audituese janë ndjekur vazhdimisht, siç është parashikuar në kërkesat e manualit të AB (Kap. IV, Pika 4.8.3).

Vlerësimi i dokumentimit të punës audituese.

Nga njësia e AB të Bashkisë, është plotësuar inventari i sugjeruar i dosjes koherente të auditimit, si dhe dosjet e përhershme për të gjitha subjektet që auditohet nga kjo njësi, ku janë plotësuar me dokumentacionin përkatës, kjo sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapit. VI

“Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”, formati 1 “Inventari i sugjeruar i dosjes koherente të auditimit” si dhe pikës 6.2 “Dosja e përhershme”.

Nga ekzaminimi i dokumentacionit, u vu re se të gjithë dosjet e evaduar janë arkivuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat” dhe në zbatim të tij “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”. Dosjet e auditimit vlerësohen të plotësuara sipas kërkesave të manualit, dhe të gatshme për arkivim.

Për sa është trajtuar në lidhje me këtë pikë në Projekt Raportin Përfundimtar të Auditimit është paraqitur observacioni me nr. 1804/3 prot., datë 08.09.2025 protokolluar me nr.614/3 prot., datë 12.09.2025 të Kontrollit të Lartë të Shtetit, për të cilin japim sqarimet si më poshtë.

Pretendim i Subjektit:

Bazuar në gjetjet/rekomandimet përkatëse për NJAB Bashkia Devoll sipas Projekt Raportit të Auditimit po paraqesim observacionet si mëposhtë.

Njësia e Auditit të Brendshëm, Bashkia Devoll ka kryer planifikimin e auditimeve duke ndjekur një frekuencë të rregullt në të gjitha njësitë, vlerësimin e riskut për fushën/sistemin e llogarisë së kombinuar me mjedisin e kontrollit (format standart 4,5), përcaktimi i fushave dhe testeve individuale të auditimit (formati nr.9), kostot dhe masat për sigurimin e cilësisë të dokumentuara në dosjet e audituara.

Njësia e Auditit të Brendshëm, Bashkia Devoll ka vendosur sistem monitorimi dhe vetvlerësimi periodik si dhe ka përcaktuar afate të qarta për zbatimin e rekomandimeve. Dosjet për subjektet e audituara përmbajnë dokumentacionin në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.

Qendrimi i Grupit të auditimit:

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion grupit të auditimit, gjatë vitit 2024 u verifikua se NJAB Devoll referuar formatit nr.4 për vlerësimin e riskut nuk është kryer.

Gjatë vitit 2024 Drejtori dhe Sektorë me risk të lartë nuk janë mbuluar me auditim si teknologjia e informacionit, Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Projekteve/Infrastrukturës.

Për sa më sipër observacioni i paraqitur nuk merret në konsideratë në hartimin e raportit të auditimit.

2. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2024 japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.”

2.1. Auditimi i përkatësisë, plotësisë dhe saktësisë së paraqitjes së aktiveve afatgjata në pasyrën e pozicionit financiar:

- Rregjistrimi fillestar dhe klasifikimi i tyre
- Inventarizimi periodik

2.2. Auditimi i saktësisë dhe raportimit të paraqitjes në pasqyrën e pozicionit financiar të:

- Llogarive të arkëtueshme,
- Llogarive të pagueshme,

2.3. Auditimi i plotësisë dhe saktësisë së pasqyrës së performancës financiare:

- Mbi realizimin dhe regjistrimin e të ardhurave nga burimet e veta dhe transfertat,
- Mbi realizimin dhe regjistrimin e shpenzimeve

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

-Pasqyrat Financiare për periudhën ushtrimore raportuese (janar-dhjetor 2024).

- Ditarët e kontabilitetit për periudhën raportuese ushtrimore viti 2024.
- Listë pagesat me përzgjedhje të periudhës raportuese ushtrimore e vitit 2024.
- Dokumentet e bankës dhe të arkës për periudhën raportuese ushtrimore të vitit 2024.
- Akt-rakordimet e kryera me degën e Thesarit Korçë për periudhën raportuese të vitit 2024.
- Dokumentet e inventarizimit fizik të AAGJM, etj, për periudhën raportuese ushtrimore viti 2024.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:

- **Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:**

Për vitin 2024 Bashkia Devoll ka hartuar pasqyrat e konsoliduara në të cilat përfshihet vetëm Bashkia Devoll si njësi shpenzuese.

Bashkia Devoll për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Korçë si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimi.

Për vitin 2024 nga Bashkia Devoll është përgatitur bilanci i konsoliduar i vitit 2024 është përgatitur nga znj. A.F. me detyrë drejtor i financës dhe Nëpunës Zbatues dhe janë konfirmuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll, z. E.D. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, si dhe është depozituar me datë 29.03.2025 dhe është miratuar nga Dega e Thesarit Korçë në datën 30.03.2025 jashtë afateve ligjore.

- **Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.**

Për vitin 2024 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Floë).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

- **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Bashkisë Devoll për vitin 2024 janë të nënshkruara nga z. E.D. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. A.F. me detyrë Drejtor i Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Korçë në datë 29.03.2025 dhe janë miratuar në datën 30.03.2025, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.

- **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2024 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël.

- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave.

Është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël, deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumentacionit bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-shpenzimet, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtyre dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

• **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Devoll për aktivitetin ekonomiko- financiar për periudhën 01.01.2024- 31.12.2024.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2024 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2024:

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënzërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejtë në pasqyrën e bilancit.

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar të Bashkisë Devoll në 31.12.2024, sipas **formatit F1**, është paraqitur më poshtë:

Pasqyra e pozicionit financiar (F1).

Aktivët neto janë të barabarta me Aktivët-Pasivët

Pasqyra e pozicionit financiar (F1).

- **Aktivët neto janë të barabarta me Aktivët-Pasivët=3,087,048,798 lekë.**

- Aktivët 3,191,970,607 lekë

- Detyrimet 104,921,809 lekë

- Aktivët Neto 3,087,048,798 lekë

▪ **Aktivët afatshkurtra**

Aktivët afatshkurtra më datë 31.12.2024 paraqiten në vlerën lekë dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 98,478,928 lekë;

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 56,558,552 lekë;

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 152,967,577 lekë lekë;

Të tjera aktive aftashkurtra në shumën 227,500 lekë.

Tabela Nr.4:Llogaritë e klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre”

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca
				(2024-2023)
531	Mjete monetare në arkë	0	0	0
512, 56	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	98,478,928	107,162,505	8,683,577
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akredeitiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provigjone zhvlerësimi	0	0	0
Totali		98,478,928	107,162,505	8,683,577

Burimi:Bashkia Devoll

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 98,478,928 lekë, përbëhet nga: gjendja e llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në shumën 85,332,229 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 13,146,699 lekë .

1-Bashkia Devoll:

Sipas pasqyrës së performancës financiare të Bashkisë Devoll për vitin 2024 kemi informacionin si më poshtë:

Klasa 7 (Të ardhurat në vlerën 1,062,084,594 lekë).

Klasa 6 (Shpenzimet në vlerën 976,752,365 lekë).

Llogaria 85"Rezultati i vitit ushtrimor", është paraqitur në vlerën 85,332,229 lekë e cila kuadron me diferencën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Sipas ditarit të të ardhurave të arkëtuara mbajtjet e të ardhurave për vitin 2024 janë si më poshtë:

Të ardhurat

1-Trasfertë e pakushtëzuar dhe specifike viti 2024 e papërdorur 72,187,460 lekë.

2-Të ardhurat pa çelur viti 2024 në shumën 0 lekë.

3-Të ardhurat të çelura të papërdorura në shumën 13,144,769 lekë.

4 -Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme rindërtimi viti 2024 në vlerën 0 lekë.

Totali i fondeve të papërdorura është në shumën 85,332,229 lekë fonde të cilat do të trashëgohen për vitin 2025.

Totali i fondeve të papërdorura nga të ardhurat është në shumën 85,332,229 lekë fonde të cilat do të trashëgohen për vitin 2025 dhe kuadrojnë me vlerën e llog.85 “rezultat i veprimtarisë ushtrimore” dhe atë të llog.466 “mjete në ruajtje” e cila pasqyron vlerën për shumën e fondeve të trashëguara prej 99,454,295 lekë.

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”:

Tabela Nr.5: Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”.

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca
				(2024-2023)
31	Materiale	12,499,386	15,245,493	(- 2,746,107)
32	Objekte inventari/Inventar imët	44,059,166	43,655,531	403,635
33	Prodhime, punime e shërbime ne proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmeri	0	0	0

37	Gjendje te pambritura ose pranë të treteve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provizjone për zhvlerësim e inventarit(-)	0	0	0
Totali		56,558,552	58,901,023	-2,342,471

Burimi:Bashkia Devoll

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar në 31.12.2024 paraqitet në vlerën 56,558,552 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në shumën 12,499,386 lekë dhe nga llogaria kontabel 32 “Objekte/inventari imët” në shumën 44,059,166 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit, vlerë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 2,342,471 lekë.

Nga verifikimi me zgjedhje sipas ditarit të bankës u verifikuan disa shpenzime për të cilat u kërkuar dokumentacion justifikues nga magazina për hyrjet dhe daljet e këtyre mallrave.

Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion për të gjitha shpenzimet e mëposhtme disponohet dokumentacioni i mëposhtëm:

- Fletë hyrje në magazinë me dokumentat mbështetëse,
- Fletë daljet e magazinës me dokumentat mbështetëse,

Llogaria 312 “Materiale”, në fillim të vitit 2024 ka vlerën 15,245,493 lekë dhe në mbyllje të vitit ka vlerën 12,499,386 lekë, është pakësuar me vlerën 2,746,107 lekë, për vlerën e materialeve të blera gjatë vitit 2024 gjendje në magazinë. Lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela Nr.6: Lëvizjet e llogarisë 312 “Materiale”

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë	Diferenca 2024-2023
Gjendje në 01.01.2024	15,245,493	2,746,107
Hyrje gjatë vitit 2024	48,831,420	
Dalje nga magazina gjatë vitit 2024	51,577,527	
Gjendja në 31.12.2024	12,499,386	

Burimi:Bashkia Devoll

Llogaria 327 “Objekte inventari”, në fund të vitit 2023 ka vlerën 43,655,531 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 44,059,166 lekë, është shtuar në vlerën 403,635 lekë, për vlerën e inventarit të imët hyrje gjatë vitit 2024. Kjo vlerë përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor.

Tabela Nr.7: Lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë	Diferenca
Gjendja në 01.01.2024	43,655,531	403,635
Hyrje gjatë vitit 2024	1,280,909	
Dalje nga magazina gjatë vitit 2024	877,273	
Gjendja në 31.12.2024	44,059,166	

Burimi:Bashkia Devoll

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve, llog 63 evidentuar në pasqyrën e performancës financiare. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”. Titullari i ka nxjerrë Urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit për inventarizimin fizik, vlerësimin të aktiveve që klasifikohen të dëmtuara dhe atë të nxjerrjes jashtë përdorimit.

- **Inventarizimi i aktiveve**

Gjatë vitit 2024, mbështetur dhe në UMF 30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar, nga ana e titullarit të bashkisë është miratuar urdhri nr.607 datë 12.11.2024 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit, vlerësimit të aktiveve dhe të nxjerrjes jashtë përdorimit për vitin 2024” në Bashkisë Devoll ku janë përcaktuar ngritja e 3 grupe te ndryshme sipas përgjegjësiave. Fillimi i procesit të inventarizimit është njoftuar nga Nëpunësit zbatues znj. A.F., me shkresën me nr. 3268 prot., datë 15.11.2024 “Njoftim për fillimin e procesit të inventarizimit”. Komisioni për inventarizim sipas relacionit të mbajtur ka verifikuar se gjendja fizike e inventarëve dhe fletëve të inventarizimit kontabël hartuar nga financa rezulton të jetë e barabartë.

Kostatimi: Vazhdon të mos jetë sistemuar problemi i detajimit të zërave të aktiveve të pasqyruara në “llogarinë 212”, të cilat janë trashëguar nga Njësitë administrative.

Për asetet e pasqyruara në “llogarinë 212”, me vlerën 47,447,782 lekë dhe në “llogarinë 213” për asetet për vlerat 233,586,281 lekë trashëguar nga ish-komuna Hoçisht dhe 338,481,513 lekë nga ish Komunën Qendër të cilat janë trajtuar edhe nga auditimi i mëparshëm nuk ka asnjë plan veprimi për sistemimin e tyre, por në relacionin sqarues të pasqyrave financiare janë pasqyruar problematikat me këto vlera.

Relacioni i drejtuar Titullarit të Institucionit ka pasqyruar për gjendjen e të gjithë artikujve gjendjen fizike në magazinë dhe vlerat e asetëve dhe është firmosur nga anëtarët e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit. Komisioni për inventarizimin, ka verifikuar se gjendja fizike e inventarëve sipas fletëve të inventarizimit kontabël të hartuara nga financa rezulton të jetë e barabartë dhe pa diferenca në plus dhe minus.

Konstatimi: Mospërfshirja e të gjithë faktorëve të kërkuar për vlerësimin e aktiveve

Grupi i auditimit konstaton se, në procesin e vlerësimit të aktiveve, nuk janë administruar dhe marrë në konsideratë faktorët e kërkuar ligjërisht, si nga nëpunësi zbatues ashtu edhe nga grupi i ngarkuar për realizimin e procedurës së vlerësimit. Më konkretisht, gjatë hartimit të listës së aktiveve që do t’i nënshtrohen vlerësimit, nuk janë përdorur informacione thelbësore si:

- mundësia për riaftësimin e aktiveve në raport me analizën kosto/përfitim,
- informacioni zyrtar mbi dobishmërinë e aktiveve nga drejtuesit e programeve buxhetore (DEMP) apo nga punonjës të tjerë të njësisë.

Kjo bie në kundërshtim me pikën 102 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, ku cilësohet : “Nëpunësi zbatues i njësisë, në bazë të gjendjes faktike të aktiveve të rezultuar nga inventarizimi, normave të amortizimit, afatit të skadencës, vitit të vënies në punë, vlerës së shtuar ndër vite, mundësive për riaftësimin e aktiveve në raport me kosto/përfitim për një veprim të tillë, informacionit zyrtar të marrë mbi dobishmërinë e aktiveve nga drejtuesit e programeve buxhetore dhe punonjësit e tjerë të njësisë, përcakton gjendjen e aktiveve dhe harton listën e atyre që do të vlerësohen.”

Ky proces ka rëndësi për vendimmarrjen mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, planifikimin buxhetor për zëvendësimin e tyre si investime administrative, dhe garantimin që vetëm aktivet që e kanë realisht humbur dobishmërinë t’i nënshtrohen eliminimit.

Pavarësisht kësaj, relacioni përfundimtar i vlerësimit është firmosur nga anëtarët e komisionit të inventarizimit dhe të vlerësimit, si dhe është paraqitur Titullarit të institucionit.

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme”&“Të tjera aktive afatshkurtra” pasqyrohen në në **aneksi nr.2/4** në anekset e raportit të auditimit.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 66,664,236 lekë dhe po me të njëjtën vlerë edhe në vitin 2023. Llogaria 468 për vlerat e pasqyruara në fund të vitit 2024 duhej të pasqyronte në total a) vlerat e konstatuara si të ardhura të paarkëtuara të vitit 2024 edhe b) vlerat nga vitet e mëparshme të detajuara dhe pasqyruar në llogarinë 470 “Llogari në pritje/Të ardhura për t’u marrë”, për taksa e tarifa vendore për bizneset dhe familjarë, dhe të ardhura të tjera.

Konstatim: Kontabilizimi jo i saktë i vlerave në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Nga analiza e llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” nuk kemi informacion të detajuar për detyrimet që janë konstatuar si për vitin korrent 2024 por edhe për vitet e mëparshme. Të dhënat e nevojshme duhet të përmbajnë informacion për detyrimet familjarë, gjobat e IMTV, kamatvonesat e llogaritura, detyrimet për ish punonjës ish-komuna, detyrimet biznesit si (fjetje hoteli, leje ndërtimi, zhvillimi, reklame, tabele etj).

Gjithashtu në vitin 2024 nga ana e nëpunësit zbatues nuk janë pranuar të dhënat dhe informacioni mbi detyrimet e llogarisë 468 që Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve, Licencave dhe Borxhit në Bashkinë Devoll ka konstatuar. Korrespondenca ka qenë zyrtare me shkresat si vijon:

- 1) Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit i ka kërkuar informacion me shkresën me nr. 821 prot., datë 27.02.2025 “Kërkesë për informacion”, Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve, Licencave dhe Borxhit.
- 2) Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve, Licencave dhe Borxhit ka kthyer përgjigje me shkresën me nr 906 prot., datë 07.03.2025” Dërgim informacioni” për listën e debitorëve në vlerën totale 17,003,191 lekë,
- 3) Nëpunësi zbatues ka refuzuar zyrtarisht informacionin me shkresën me nr 906/1 prot., datë 10.03.2025” Refuzim të informacionit të paraqitur mbi listën e debitorëve deri në datën 31.12.2024” dhe i është drejtuar Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve, Licencave dhe Borxhit, Kryetarit të Bashkisë dhe Zëvendëskryetarit të Bashkisë, pasi informacioni ka patur mangësi dhe deri në momentin e hartimit të pasqyrave nuk ka patur asnjë kthim përgjigje as zyrtar dhe as me e-mail dhe për pasojë nuk është kryer procesi i kontabilizimit.

Për sa vijon këto të ardhura nuk janë kontabilizuar për mungesë të informacionit dhe për të cilën mbajnë përgjegjësi Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve, Licencave dhe Borxhit, Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues për mos marrjen e masave për kontabilizimin dhe përfshirjen e të ardhurave në pasqyrat financiare. Kjo gjë ka sjellë pasqyrim jo të saktë të kësaj llogarie, ulje të vlerës reale të debitorëve, ulje të llogarisë së të ardhurave dhe të rezultatit të vitit ushtrimor.

Gjithashtu konstatohet se edhe pse llogaria 468 nuk është kontabilizuar për vlerën e debitorëve për vitin 2024, kjo vlerë nuk përputhet me llogarinë 470 Llogari në pritje - të ardhura për t’u marrë, ku të pasqyrohen vlerat e debitorëve, detyrime nga vitet e mëparshme. Për disa nga këto detyrime nga ana e Drejtorisë së Financës nuk disponohet listë analitike për subjektet debitorë të viteve të mëparshme, pasi u takojnë ish komunave.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 85,443,509 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare. Vlera prej 85,443,509 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga: Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF8: Detajet e nënrubrikës “Të tjera operacione me shtetin”.

Emërtimi i llogarive	2024	2023
Llogari 401-408	44,906,296	99,212,495
Paga personeli llog 42	23,011,037	17,227,154
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	5,839,448	4,672,394
Sigurime shoqërore llog.435	6,230,367	4,897,267
Sigurime shëndetësore llog.436	858,972	672,949
Kreditor të ndryshëm llog.467	4,597,389	4,413,389
Totali	85,443,509	85,443,509

Burimi:Bashkia Devoll

Llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”:

Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Devoll gjendja e llogarisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” më datë 31.12.2024 paraqitet me vlerë 85,443,509 lekë e barabarte me llogarinë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (te drejta)”

Tabela 9: Detajet e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin”.

Nr	Njësitë shpenzuese	4342	7206	401-408	42	431	435	436	467	Klasa 4	Diferenca 4342-Klasa 4
1	Bashkia	85,443,509	85,443,509	44,906,296	23,011,037	5,839,448	6,230,367	858,972	4,597,389	85,443,509	0
	Total	85,443,509	85,443,509	44,906,296	23,011,037	5,839,448	6,230,367	858,972	4,597,389	85,443,509	0

Burimi: Bashkia Devoll dhe Grupi i auditit

Aktivët Afatgjatë jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivët Afatgjatë Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe Kërkime”, dhe paraqiten me kosto historike 64,348,976 lekë, amortizim i akumuluar në vlerën 10,778,798 lekë, shtesa gjatë vitit 2024 në vlerën 10,320,000 lekë, amortizim i vitit 2024 në vlerën 1,755,051 lekë dhe pakësimet në vlerën 21,198,820 lekë. Llogaria 202 “Studime dhe Kërkime” është pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 43,666,533 lekë.

Nga auditimi i llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” gjatë vitit 2024 kjo llogari është pakësuar për vlerën 21,198,820 lekë dhe amortizim 2,730,256 lekë. 9 (Nëntë) projekte të cilat janë kontabilizuar në këtë llogari prej vitit 2019 janë transferuar në llogaritë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” duke ju shtuar vlerës së aktivit të cilit i përkasin. Projektet janë paraqitur në tabelën mëposhtë.

Tabela Nr.10: Projektet e përfunduara dhe kapitalizuar në llogaritë 212 dhe 213

Në lekë

Data/Viti	Emërtimi	Vlera bruto	Vlera neto	Amortizim	Llog
2016	Projektim i sistemim i perroit te SMT	2,958,084	2,135,736	822,347	213
2018	Studim projektim objekti sistemim perroit Dobranj	1,059,216	860,348	198,867	213
2019	Projekt zgjerimi i rrugës.vendore aksi superstrada e Devollit Rr.Ismail.Qemali Rr.D. Progri, Rr.Ethem Osmani (Xhaci)	1,621,071	1,389,865	231,205	213
2019	Projektim Rr.vendore lagje nr.2 dhe nr.3	1,738,929	1,490,914	248,014	213
2019	Studime projektme per ujesjellesin Hociisht	3,240,000	2,777,895	462,105	213
2013	Projektim rikonstruksion zyrat e komunes	200,000	117,325	82,675	212
21.09.2021	Permiresimi I infrastruktures shkolla Miras	1,562,000	1,409,705	152,295	212
02.12.2021	Studim i permiresimit te rrjetit energjitik per qendren kulturore te femijeve	1,932,000	1,743,630	188,370	212
23.03.2022	Ndertim nje ujesjellesi te jashtem dhe te brendshem, NJA Miras	6,887,520	6,543,144	344,376	213
	Totali i pakësimeve kaili llog 212 dhe 213	21,198,820	18,468,563	2,730,256	

Burimi: Bashkia Devoll

Tabela Nr.11: Projektet e përfunduara dhe kapitalizuar në llogaritë 212 dhe 213

Në lekë

Data/ Viti	Emërtimi	Vlera bruto	Vlera neto	Amortizim	Llog
2024	Studime projektimi shtesa	10,320,000	8,564,919	1,755,081	

Burimi: Bashkia Devoll

Regjistri i aseteve për llogarinë 202 “Studime dhe Projektme”, i mbajtur në format excel nga Bashkia Devoll, përmban informacion për secilin projekt, përfshirë: vitin e kapitalizimit, përshkrimin, koston historike, amortizimin vjetor, amortizimin e akumuluar dhe vlerën neto kontabël.

Në total janë të regjistruara 85 projekte, nga të cilat 9 projekte janë hequr nga llogaria 202 dhe janë transferuar në llogaritë e aktiveve afatgjata, konkretisht në llogaritë 212 dhe 213, për shkak se kanë kaluar në fazën e zbatimit dhe të kapitalizimit.

Vlera totale kontabël e projekteve të transferuara është pasqyruar si aktive të hyra nga brenda sistemit dhe është reflektuar si e tillë si në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, ashtu edhe në Aneksin statistikor nr. 7/b të pasqyrave financiare vjetore.

Konstatim: Norma e amortizimit për AAGJM në zhvillim nuk është llogaritur saktë.

Grupi i auditimit konstatoi se amortizimi i aktiveve të kontabilizuara në llogarinë 202 "Studime dhe Kërkime" është përlllogaritur në mënyrë jo të saktë, pasi në vend që të zbatohet norma e parashikuar prej 15% sipas metodës lineare, siç përcaktohet në pikën 36 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, të ndryshuar, njësia ka aplikuar gabimisht normën 5% mbi vlerën e mbetur, duke devijuar nga kërkesat për amortizim. Ky trajtim kontabël i pasaktë ka sjellë:

- nënvlerësim të amortizimit;
- mbivlerësim të vlerës neto kontabël në llogarinë 202;

Si pasojë, edhe mbivlerësim të vlerave të transferuara në llogaritë 212 dhe 213 për projektet e zbatuara. Këto vlera janë reflektuar edhe në pasqyrën e pozicionit financiar, kalimi i projekteve në zbatim me një vlerë të mbetur të llogaritur gabimisht, ka ndikuar në mbivlerësimin e aktiveve afatgjata, duke evidentuar pasaktësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare.

II. Aktivët afatgjata

Në Formatin 1 “Pozicioni Financiar”, “Aktivët afatgjata” paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog.231). Gjendja në total paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 2,675,819,024 lekë dhe në fund të vitit 2024 është në vlerën 2,832,367,303 lekë, që përbëhet nga shuma e llogarive të klasës 21 të AAM;

Tabela Nr.12: Gjendja e AAM

Nr. Referencë Llogar ije	Emertimi	Gjendje ne Fillim vit te vitit	Shtesa gjate vitit ushtrimo, Kosto Historike					Pakesime gjate vitit , Kosto Historike				Gjendja mbyllje te ushtrimit
			Blerje e krijuar me pagese	Shtesa pa pagese		Levizje brenda aktiveve	Gjithe sej	Shitje	Nx.jasht perdor	Pakesime te Tjera	Gjithe sej	
				Jashte sistemit	Brenda sistemit							
b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
20	I. AAGJ/JM	63,348,976	0	10,320,000	0	0	10,320,000	0	0	21,198,820	21,18,820	53,470,156
21- 28	II. AAGJ/M	3,581,982,746	280,644,384	6,420,707	21,198,820	0	308,263,911	0	4,358,198	176,400	4,534,598	3,885,712,059
TOTALI (I + II)		3,646,331,722	280,644,384	16,740,707	21,198,820	0	318,583,911	0	4,358,198	21,375,220	25,733,418	3,939,182,215

Burimi: Bashkia Devoll

Aktivet e afatgjata materiale (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale” në Formatin 1 (Aktivi i bilancit), paraqiten me vlerën neto për vitin ushtrimor 2024 në shumën 2,788,700,770 lekë; në vitin paraardhës 2023 vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 2,622,248,846 lekë, me një shtim të AAM-ve me 166,451,924 lekë.

Tabela Nr.13: Gjendja me vlerë neto e AAM

21	2.Aktive Afatgjata materiale	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca
210	Toka, Troje, Terrene	3,228,553	3,228,553	-
211	Pyje, Plantacione	2,591,250	2,470,050	121,200
212	Ndertesat e Konstruksione	681,918,447	561,883,407	120,035,040
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	2,000,387,825	1,963,818,968	36,568,857
214	Instalime teknike, makineri e paisje	6,028,056	6,396,986	(368,930)
215	Mjete Transporti	81,179,856	73,964,850	7,215,006
218	Inventar ekonomik	13,366,783	10,486,032	2,880,751
TOTALI AAM		2,788,700,770	2,622,248,846	166,451,924

Burimi: Bashkia Devoll

Për vitin 2024 kostot historike, amortizim i akumuluar dhe vlera neto jepen si vijon:

Tabela Nr. 14:Pasqyra Statistike 7b: Gjendja dhe ndryshimet e llog 210 -218, 24,28 në lekë

Llog	II. AAGJ/ MATERIALE	Teprica ne Fund		
		Kosto	Amortizim	Teprica
		Historike	Akumuluar	Neto
210	Toka,troje,terene	3,228,553	0	3,228,553
211	Pyje,Kullota Plantacione	2,591,250	0	2,591,250
212	Ndertime e Konstruksione	916,363,672	234,445,224	681,918,448
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	2,746,661,817	746,273,992	2,000,387,825
214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	19,877,034	13,848,978	6,028,056
215	Mjete transporti	117,358,083	36,178,227	81,179,856
218	Inventar ekonomik	79,631,650	66,264,867	13,366,783
	Totali	3,885,712,059	1,097,011,289	2,788,700,770

Burimi: Bashkia Devoll

Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” paraqitet në mbyllje të viteve 2023 e 2024 në vlerën 0 lekë; si dhe në Formatin 7/a e 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” paraqitet pa vlerë.

Nr	Emërtimi i Aktiveve – llog. 210	Gjendja 31.12.2023	Shtesa dhe pakësime gjatë vitit 2024		Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2024
1	Toka, troje, terrene	3,228,553	0	0	-	3,228,553

Burimi: Bashkia Devoll

Llogaria 211 “Pyje, plantacione” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në shumën 2,470,050 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 2,591,250 lekë dhe kuadron me llog.211 në Formatin 7/a e 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata”. Analiza e llog.211 “Pyje, plantacione” si më poshtë:

Nr	Emërtimi i Aktiveve – llog. 211	Gjendja 31.12.2023	Shtesa dhe pakësime gjatë vitit 2024		Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2024
1	Pyje, Plantacione	2,470,050	121,200	-	0	2,591,250

Burimi: Bashkia Devoll

Llogaria 211 “Pyje, plantacione” gjatë vitit 2024 është shtuar në vlerën 121,200 lekë e cila i përket blerjes së pemëve dekorative.

Llogaria 212 “ Ndërtesa dhe konstruksione”. Në fund të vitit 2023 në pasqyrën e pozicionit financiar është pasqyruar për vlerën kontabël neto 561,883,407 lekë. Gjatë vitit 2024 kjo llogari ka pasur shtesa me pagesë në vlerën 143,351,497 lekë shtesa pa pagesë në vlerën 5,364,587 lekë dhe lëvizje brenda sistemit 0 lekë. Amortizimi i vitit 2024 në vlerën 28,681,043 lekë. Në fund të

vitet 2024 kjo llogari është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 681,918,448 lekë.

Analiza e llog. 212 është si më poshtë:

në lekë

Nr	Emërtimi i Aktiveve – llog. 212	Gjendja 31.12.2023	Shtesa dhe pakësime gjatë vitit 2024	Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2024
1	Ndërtesa dhe Konstruksione	561,883,407	148,716,084	28,681,043	681,918,44

Burimi: Bashkia Devoll

Referuar regjistrin të aktiveve të vendosur në dispozicion nga Bashkia Devoll u konstatuan aktivet e mëposhtme të kontabilizuara në kundërshtim me udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

Tabela Nr. 15: Aktivet e kontabilizuara në llogarinë 212 pa certifikatë pronësie.

Nr	Emërtimi	Viti i marrjes në dorëzim	VKN 2023	A.Akumuluar 2024	VKN 2024
1	Permiresim i kushteve per Kom te pafavori.	2017	7,575,029	2,379,316	5,195,712
2	Permiresim i kushteve per Kom te pafavori.	2018	14,614,829	3,963,998	10,650,830
3	Permiresim i kushteve per Kom te pafavori.	2019	116,200	26,535	89,664
4	Permiresim i kushteve per Kom te pafavori.	2019	9,011,260	2,057,833	6,953,426
5	Permiresim i kushteve per Kom te pafavori.	2020	17,952,480	3,330,072	14,622,407
6	Permiresim i kushteve per Kom te pafavori.	2021	21,047,887	2,052,168	18,995,718
7	Permiresim i kushteve per Kom te pafavori.	2023	27,789,943	1,389,497	26,400,445
8	Permiresim i kushteve per Kom te pafavori.	2024			35,101,414
9	Banesa me nr.1/132+1-4 banues z.B. S.	2024			752,127
10	Banesa me nr.1/132+1-2 banues z. K. N. & F. M.	2024			918,460
Total			98,107,628	15,199,419	119,680,203

Burimi: Bashkia Devoll

Referuar tabelës së mësipërme në llogarinë 212 janë kontabilizuar 10 aktive me vlerë kontabël neto 119,680,203 lekë. Aktivet e kontabilizuara në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” nuk janë aktive në posedim të Bashkisë Devoll. Këto janë asete në pronësi të komunitetit të cilët nëpërmjet programeve të ndryshme sociale janë përfitues të granteve të ndryshme. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”. Vlera 119,680,203 lekë ka mbivlerësuar llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”.

Tabela Nr. 16: Objektet e kapitalizuara në llogarinë 212 gjatë vitit 2024.

Nr	Objekti	Vlera e Kontabilizuar
1	Banesa me nr.1/132+1-4 banues z.B. S.	752,127
2	Banesa me nr.1/132+1-2 banues z.K. N. & F. M.	918,460
3	Shtepize druri ne Pedonalen e Qytetit	450,000
4	Dyer te brendshme shkollave	414,000
5	Grila ,Rrjeta,Porta me dy kate ,Prag	42,960
6	Shkolla Myrteza Sala	107,320,866
7	Përmirësim i kushteve të banimit	35,101,414
8	Kolaudim qender multifunksionale	22,255
Total		145,022,082

Burimi: Bashkia Devoll

Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. Në fund të vitit 2023 në pasqyrën e pozicionit financiar është pasqyruar për vlerën kontabël neto 1,963,818,968 lekë. Gjatë vitit 2024 kjo llogari ka pasur shtesa me pagesë në vlerën 117,771,676 lekë., shtesa pa pagesë në vlerën 20,054,940 lekë Amortizimi i vitit 2024 në vlerën 101,257,759 lekë. Në fund të vitit 2024 kjo llogari është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 2,000,387,825 lekë.

Analiza e llog. 213 është si më poshtë:

në lekë

Nr	Emërtimi i Aktiveve – llog. 213	Gjendja 31.12.2023	Shtesa dhe pakësime gjatë vitit 2024	Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2024
1	Rrugë, rrjete, vepra ujore	1,963,818,968	137,826,616	101,257,759	2,000,387,825

Burimi:Bashkia Devoll

Tabela Nr. 17: Objektet e kapitalizuara në llogarinë 213 gjatë vitit 2024.

Nr	Viti	Emërtimi	Vlera Kontabël
1	2024	Ure nga Ministria e mbrojtjes	2,550,120
2	2024	Rehabilitimi I rrugeve fshati Poncare	7,314,691
3	2024	Rehabilitimi I rrugeve fshati Bitincke	5,523,736
4	2024	Supervizim " Zgjerim rr.vendore aks superstrada e Dev..	724,428
5	2024	Rehabilitimi I rrugeve te qytetit Bilisht 2	41,565,995
6	2024	Kolaudim Ujësullësi i jashtëm dhe i brendshëm Miras	376,447
7	2024	Mbrojtja nga ujrata e larta dhe sis. I perroit te SMT	43,821,319
8	2024	Rehabilitimi I rrugeve te fshatit Miras	5,301,467
9	2024	Mbikqyrje ujesullësi Hociisht	230,668
10	2024	Rehabilitimi I rrugeve te brend. te qytetit Bilisht	9,450,463
11	2024	Rehabilitimi I rrugeve te fshatit Proger	3,462,459
Totali			120,321,796

Burimi:Bashkia Devoll

Llogaria kontabël 214 “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune”. Kjo llogari përfaqëson makineri paisje dhe vegla pune në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Devoll. Sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë gjendja e llogarisë 214 më datë 31.12.2024 paraqitet me vlerë neto kontabël 19,877,034 lekë.

Bashkia gjatë vitit 2024 ka blerë më pagesë më anë të procedurave të prokurimit materiale me vlerë 2,524,680 lekë. Blerje pa pagesë gjatë vitit 2024 janë në vlerën 0 lekë. Levizje brenda aktiveve me vlerë prej 0 lekë.

Tabela Nr.18: Shtesat gjatë vitit 2024 në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune”:

Nr	Njësitë shpenzuese	Blerje me pagesë	Pa pagesë		Lëvizje brenda aktiveve
			Jashtë sistemit	Brenda sistemit	
1	Bashkia	2,524,680	-	-	-
Total		2,524,680	-	-	-

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Tabela Nr.19: Detajet e nënrubrikës “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune”.

Teprica në fillim			Shtesa		Pakësimet		Teprica Ne fund		
K.Historike	A.Akumuluar	Teprica Neto	K.histoike	Amortizim	K.Historike	Amortizim	K.historike	A.Akumuluar	Teprica Neto
19,326,020	12,929,034	6,396,986	2,524,680	919,944	1,973,666	919,944	19,877,034	13,848,978	6,028,056

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria 215 “Mjete transporti”. Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve te transportit në pronësi të Bashkisë Devoll.

Në fund të vitit 2023 referuar aneksit nr.7/b në pasqyrën e pozicionit financiar është pasqyruar për vlerën kontabël neto 73,964,850 lekë. Gjatë vitit 2024 kjo llogari ka pasur shtesa me pagesë në vlerën 9,699,000 lekë shtesa pa pagesë në vlerën 2,200,000 lekë. Amortizimi i vitit 2024 në vlerën 4,683,994 lekë. Në fund të vitit 2024 kjo llogari është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 81,179,856 lekë.

Tabela Nr.20: Shtesat gjatë vitit 2024 në llogarinë 215 “Mjete Transporti”:

Nr	Njësitë shpenzuese	Blerje me pagesë	Pa pagesë		Lëvizje brenda aktiveve
			Jashtë sistemit	Brenda sistemit	
1	Bashkia	9,699,000	2,200,000	-	-
Total		9,699,000	2,200,000	-	-

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit**Tabela Nr.21:** Detajet e nënrubrikës “Mjete Transporti”.

Teprica në fillim			Shtesa		Pakësimet		Teprica Ne fund		
K.Historike	A.Akumuluar	Teprica Neto	K.historike	Amortizim	K.Historike	Amortizim	K.historike	A.Akumuluar	Teprica Neto
105,459,083	31,494,233	73,964,850	11,899,000	4,683,994	-	--	117,358,083	36,178,227	81,179,856

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Gjatë vitit 2024 ka pasur shtesa llogaria 215 “Mjete Transporti” 3 mjete të kontabilizuara me vlerë 11,899,000 lekë.

Tabela Nr.22: Mjetet e kontabilizuar në llogarinë 215, gjatë vitit 2024.

Nr	Viti i marrjes në dorëzim	Lloji I mjetit	Burimi i Financimit	Vlera Kontabël
1	2024	Automjet Zjarrfikës (Mercedes benz)	Donacion	2,200,000
2	2024	Eskavator	Të ardhurat	3,750,000
3	2024	Traktor (Thike Debore , Korrese Bari & Degesh	Të ardhurat	5,949,000
Total				11,899,000

Burimi: Bashkia Devoll

Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”. Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Devoll. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Devoll gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2024 paraqitet në vlerën 13,366,783 lekë. Krahasuar me vitin 2023 llogaria 218 “Inventari ekonomik” është shtuar me vlerën 2,880,751 lekë.

Bashkia Devoll gjatë vitit 2024 ka blerë më pagesë më anë të procedurave të prokurimit materiale me vlerë 7,176,331 lekë. Blerje pa pagesë gjatë vitit 2024 janë në vlerën 0 lekë. Amortizim i vitit është në vlerën 1,734,648 lekë dhe pakësim nga nxjerrja jashtë përdorimit në vlerën 2,560,932 lekë.

Pasqyra PF23: Shtesat gjatë vitit 2024 në llogarinë 218 “Inventar ekonomik”:

Nr	Njësitë shpenzuese	Blerje me pagesë	Pa pagesë		Lëvizje brenda aktiveve
			Jashtë sistemit	Brenda sistemit	
1	Bashkia	7,176,331	-	-	-
Total		7,176,331	-	-	-

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit**Pasqyra PF24:** Detajet e nënrubrikës “Inventar ekonomik”.

Teprica në fillim			Shtesa		Pakësimet		Teprica Ne fund		
K.Historike	A.Akumuluar	Teprica Neto	K.historike	Amortizim	K.Historike	Amortizim	K.historike	A.Akumuluar	Teprica Neto
75,016,251	64,530,219	10,486,032	7,176,331	1,734,648	2,560,932	-	79,631,650	66,264,867	13,366,783

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Devoll në fund të vitit 2024, paraqitet në vlerën (1,459,189,108) lekë që ka të bëjë me amortizimin e akumuluar me datë 31.12.2024. Krahasuar me vitin 2023 llogaria 219 “Amortizimi

i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” paraqitet me shtesë prej (138,539,698) lekë, shtesë e cila ka të bëjë me amortizimin vjetor të vitit 2024.

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr 05 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Devoll , janë si më poshtë:

- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%
- për mjetet e transportit 20%
- për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

Informacioni për amortizimin e akumuluar dhe amortizimin vjetor për aktivet afatgjata të Bashkisë Devoll është paraqitur në **aneksin 2/2** në anekset e raportit të auditimit.

Aktivitet Afatgjata Financiare

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund 2024 në vlerën 1,189,200 lekë. Ky seksion i bilancit kontabël 2024 është paraqitur në vlerën 1,189,200 lekë siç shihet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

-Bashkia Devoll në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 7.76% të aksioneve të “Shoqëria Rajonale U.Ka.Ko.” sh.a me NUIS “M24431001N” e cila është shoqëri aksionere me objekt, “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të 21 furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve”.

Numri i aksioneve është 7,762 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 776,000 lekë.

Vlerat e “Shoqëria Rajonale U. Ka. Ko.” sh.a sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit paraqiten në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2024, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesmarrje në kapitalet e veta”

-Bashkia Devoll në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 11 % të aksioneve të “KRMË” sh.a me NUIS “K84227001O”.

Numri i aksioneve është 226 me vlerë nominale 16,550 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 3,740,300 lekë nga kjo Bashkisë Devoll i përkasin 24.86 aksione me vlerë monetare 411,433 lekë.

Vlerat e “Shoqërisë KRMË” sh.a sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit paraqiten në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2024 , më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesmarrje në kapitalet e veta”

Investimet:

Gjendja e llogarive 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqitet në vlerën 8,095,000 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2024 paraqitet në vlerën 42,085,797 lekë Në PF të disponueshme në sistemin e thesarit, vlera totale e investimeve është 50,180,797 lekë, përkatësisht 8,095,000 lekë në llogarinë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 42,085,797 lekë në llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”.

Referuar udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, këto llogari paraqesin

vlerën e investimeve në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 “Aktive afatgjata materiale”.

Investimet sipas kontratave të lidhura në vitet më përpara të cilat janë në proces punimesh janë paraqitur në **aneksin 2/3 në anekset** e raportit të auditimit.

Nga auditimi u konstatua se llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” janë kontabilizuar 36 projekte investime me vlerë kontrate 313,198,535 lekë. Nga këto kontrata deri në datën 31.12.2024 janë realizuar punime në vlerën 273,652,147 lekë dhe vlera e mbetur e pa realizur është në shumën 42,085,797 lekë.

Referuar analizës së mësipërme llogaria 231 duhet të paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 313,198,535 lekë, kjo llogari është nënvlerësuar për vlerën 271,112,738 lekë në kundërshtim me udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”.

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme dhe paraqesin detyrimet deri më 31.12.2024, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2023, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2024, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Tabela Nr.25: Gjendja e llogarive të klasës 4

Llogaritë	Përshkrimi	Viti 2024	Viti 2023
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	44,906,296	99,212,495
42	Detyrime ndaj personelit	23,011,037	17,227,154
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	5,839,448	4,672,394
435	Sigurime shoqërore	6,230,367	4,897,267
436	Sigurime shëndetësore	858,972	672,949
467	Kreditorë të ndryshëm	4,597,389	4,413,389

Burimi: Bashkia Devoll

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit 2023 është 99,212,495 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 është 44,906,296 lekë me një diferencë (54,306,199) lekë; ndërsa gjendja e llog. 401-408 paraqet faturat e palikuiduara ndaj të tretëve nga Bashkia Devoll deri më 31.12.2024.

- **Llogaria 42**, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura nga Bashkia Devoll, paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në shumën 17,227,154 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 23,011,037 lekë me një diferencë (shtim) në vlerën 5,783,883 lekë. Vlera e llog.42 përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

- **Llogaria 431**, “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, paraqitet në vitin 2023 në vlerën 4,672,394 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 5,839,448 lekë me një diferencë (shtim) prej 1,167,054 lekë; vlera e llog. 431 përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor dhe e paguar në janar të vitit pasardhës. Vlera rakordon me vlerën sipas listëpagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2023 për detyrimet tatimi mbi pagën.

- **Llogaria 435**, “Sigurime shoqërore” dhe **llogaria 436** “Sigurime shëndetësore” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 4,897,267 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 6,230,367 lekë për sig. Shënd; në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 672,949 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën 858,972 lekë dhe përbën vlerën e papaguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për

pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës. Rezulton se llogaritë janë plotësuar në vlera të sakta dhe se ka informacion analitik për çdo llogari.

Nga verifikimi i pagesave në bankë janar 2025, rezultoi se vlera e regjistruar dhe paguar sipas urdhër shpenzimeve kuadron me shumën totale të llogarive.

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në shumën 26,089,133 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën 13,146,699 lekë, gjendje e cila përfaqëson vlerën e garancisë 5% kontratave, të cilat rakordojnë me Akt rakordimin me Degën e Thesarit Korçë. Analiza e detajuar e llog.466 pasqyrohet **në aneksin nr.2/4** në anekset e raportit të auditimit.

Analitike llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” ngurtësimet për të cilat ka kaluar afati i garancisë paraqitet **në aneksin 2/5** në anekset e raportit të auditimit e cila përbëhet nga 5 ngurtësime me vlerë 1,312,900 lekë.

Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Veprimet dhe mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50, ku përcaktohet:

Pika 30: “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet”,

Pika 50: “Tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” dhe të llogarisë 466, “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet)”.

UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10 ku përcaktohet:

Pika 10: “Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për difektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.”

Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit”, paraqitet me tepricë kreditorë në vlerën 85,332,229 lekë në mbyllje të vitit 2024 dhe në vlerën 107,162,505 lekë në mbyllje të vitit 2023 me një diferencë (pakësim) në vlerën -21,830,276 lekë; dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Vlera e saj është e barabartë me diferencën e të ardhurave me shpenzimet, që Bashkia Devoll trashëgon për t’u përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me akt-rakordimin e mbajtur me Degën e Thesarit Korçë mbi fondet që trashëgohen dhe kuadron me llog. 85 "teprica ose deficioni i periudhës" në pasqyrën format 2 "performanca Financiare".

Pasqyra Format 2 “Performanca financiare” dhe analiza e llogarive të të “Ardhurat” dhe “Shpenzimet”.

Nga pasqyrat rezultojnë se rubrika e të “Ardhurave” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,095,857,541 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,062,084,594 lekë me një diferencë (shtim) në shumën 33,772,947 lekë. Analiza e llogarive të të Ardhurave paraqitet si më poshtë vijon:

- **Llog. 70** “të ardhura nga taksa e tatime” paraqitet në bilanc të vitit 2023 në vlerën 79,629,532 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 73,395,418 lekë, e cila kuadron me akt rakordimin me thesarin; llog. 70 përbëhet nga:

Llog. 700 “Tatim mbi të ardhurat” në shumën 113,124 lekë, që përfshin nënlog. 7002 “Tatim mbi biznesin e vogël” në shumën 113,124 lekë;

Llog. 702 “Tatim mbi pasurinë” paraqitet në bilanc të vitit 2024 në vlerën 16,611,757 lekë dhe përfshin nënlog. 7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme” në shumën 16,423,031 lekë dhe nënlogarinë 7021 “Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme” në vlerën 188,726 lekë;

Llog. 703 “Tatime mbi mallrat dhe shërbimet brenda vendit” paraqitet në shumën 56,670,537 lekë dhe përfaqëson taksën e pastrimit, ndriçimit, ndërtesës, zënie hapësire publike, etj në nënlog. 7033 dhe 7035;

- **Llog. 71** “të ardhurat jotatimore” paraqitet në bilanc të vitit 2024 në vlerën 57,343,472 lekë, e cila kuadron me akt rakordimin me thesarin;

Llog. 710 “të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia” paraqitet në vlerën 6,397,158 lekë dhe përfshin vlerën e nënlog. 7109 “të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia” dhe përbëhet qiraja e asetëve;

Llog. 711 “shërbimet administrative dhe të ardhura sekondare” në vlerën 50,946,314 lekë, që përbëhet nga: nënlog. 7110 “Tarifa administrative dhe rregullatore” në vlerën e 30,568,972 lekë; nënlog. 7111 “të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh” në vlerën 8,407,950 lekë; nënlog. 7113 “të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve” në vlerën 48,600 lekë; nënlog. 7115 “gjoba, kamatvonesa dhe zhdëmtime” në vlerën 11,920,792 lekë;

- **Llog. 72** “Grante korrente” në bilancin e vitit 2024 paraqitet në shumën 929,167,186 lekë dhe përbëhet nga:

Llog. 720 “Grant korrent i brendshëm” paraqitet në vitin 2024 në shumën 929,167,186 lekë në të cilën përfshihen:

nënlog. 7200 “Nga buxheti për NJQP (qendrore)” në vlerën 828,401,401 lekë;

nënlog. 7204 “Pjesëmarrje në institucione në tatime nacionale” në vlerën 12,009,546 lekë;

nënlog. 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në vlerën 85,443,509 lekë,

nënlog. 7207 “Sponsorizime të brendshme” në vlerën 3,312,730 lekë,

- **Të Ardhura të tjera** në pasqyrat e bilancit të vitit 2024 paraqitet në shumën 2,178,518 lekë;

Llog. 73 “Ndryshim i gjendjes së inventarit të produkteve” paraqitet pa vlerë.

Të ardhurat rakordojnë me akt rakordimin e Degës së Thesarit Korçë të datës 30.01.2025.

Për vitin 2024 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën **197,082 mijë lekë** dhe realizimi në vlerën **143,793 mijë lekë** referuar Akt-Rakordimit të datës 30.01.2025, me Degën e Thesarit Korçë ose në masën **72%** me një diferencë mos realizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën **53,289 mijë lekë**. Referuar të dhënave të sipërpërmendura me tejkalim paraqiten zërat fiskal si më poshtë:

- a. “Tatim mbi të ardhurat personale TAP” është planifikuar në vlerën 9,000 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 11,997 mijë lekë ose realizuar 133%
- b. “Taksë vjetore e qarkullimit të mjeteve të përdorura” është planifikuar në vlerën 11,000 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 12,702 mijë lekë ose realizuar 115%

Si dhe disa prej zërave fiskal nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:

- a. “Tarifë e pastrimit” është planifikuar në vlerën 41,633 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 28,459 mijë lekë ose realizuar në masën 68 %.
- b. “Tarifë ndriçimi ” është planifikuar në vlerën 19,000 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 14,984 mijë lekë ose realizuar në masën 78 %.
- c. “Taksa ndërtese ” është planifikuar në vlerën 19,150 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 16,763 mijë lekë ose realizuar në masën 87%.

Nga analiza e trajtuar më sipër për sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkallim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.

Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kjo drejtori nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifatat vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë viteve paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave.

Në këtë kontekst është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Devoll që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkallimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar defiçit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj., në dëm të interesave të publikut. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200.

Shpenzimet

Kategoria “Shpenzimet“ për vitin 2023 paraqitet në shumën 988,695,036 lekë dhe në vitin 2024 paraqitet në shumën 976,752,365 lekë, dhe paraqiten si më poshtë vijon:

- **Llog. 600** “paga dhe përfitime e punonjësve” paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 261,023,857 lekë, dhe rakordon me akt rakordimin me thesarin; vlera e kësaj llogarie përbëhet nga:

Nënlllog. 6001 “paga personeli i përhershëm” në shumën 260,283,414 lekë;

Nënlllog. 6003 “shpërblime” në shumën 740,443 lekë;

- **Llog. 601** “kontribute të sigurimeve” në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën 43,362,317 lekë ku rezulton e pasqyruar vetëm në llogarinë/nënlllog. 6010 “kontribut i sigurimeve shoqërore” në shumën 38,945,368 lekë dhe nënlllog. 6011” kontribut i sigurimeve shëndetsore” në shumën 4,416,949 lekë.

- **Llog. 602** “blerje mallra e shërbime” në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën 175,751,655 lekë dhe përbëhet nga vlerat e llogarive si më poshtë:

nënlllog. 6020 “materiale zyre të përgjithshme” në vlerën 9,872,000 lekë;
nënlllog. 6021 “materiale dhe shërbime speciale” në vlerën 43,967,168 lekë;
nënlllog. 6022 “shërbime nga të tretë” në vlerën 70,686,420 lekë;
nënlllog. 6023 “shpenzime transporti” në vlerën 40,546,039 lekë;
nënlllog. 6024 “shpenzime udhëtimi” në vlerën 241,320 lekë;
nënlllog. 6025 “shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme” në vlerën 0 lekë;
nënlllog. 6026 “shpenzime për qiramarrje” në vlerën 320,000 lekë;
nënlllog. 6027 “shpenzime për detyrime për kompensime legale” në vlerën 0 lekë;
nënlllog. 6029 “shpenzime të tjera operative” në vlerën 10,118,708 lekë.

- **“Transferime korente”** në pasqyrat financiare të bilancit të vitit 2024 paraqiten në vlerën 279,943,197 lekë, dhe përbëhet nga:

- **Llog. 604** “Transferime korrente të brendshme” paraqitet në shumën 22,412,458 lekë dhe përfshin nënlllog. 6040 “Transferime korente në nivele të tjera të qeverisë” në shumën 4,412,458 lekë; nënlllog. 6041 “transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme” në shumën 8,000,000 lekë dhe nënlllog.6044 “Transferime korente të organizatave jo fitimprurëse” në shumën 10,000,000 lekë;

- **Llog. 606** “transferime për buxhete familjare e individë” në shumën 257,530,739 lekë që përfshin nënlllog.6060 “transferime të paguara nga ISSH e ISKSH” në shumën 1,184,305 lekë dhe nënlllog. 6061 “transferime të paguara nga Inst.Tjera e Org.Pushteti. Vendor” në shumën 256,346,434 lekë, për pagesat për PAK, Ndihmë ekonomike, Ndihmë raste emergjente e të ndryshme, ndihmë për fatkeqesi natyrore, etj,

- **Llog. 63** “ndryshimi i gjendjes së inventarit” në vlerën -2,342,471 lekë, e cila kuadron me diferencën e klasës 3 të formatit 1 të bilancit;

- **Llog. 85** “teprica ose deficioni i periudhës (rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor)” është në vlerën 85,332,229 lekë dhe përbëhet nga fondet e papërdorura të cilat trashëgohen për tu përdorur në vitin 2025. Kjo vlerë rakordon me diferencën mes të ardhurave dhe shpenzimeve dhe kuadron me llog.85 të formatit 1 të bilancit..

Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullariteti i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:

Nga verifikimi me zgjedhje në lidhje me sa më sipër me konstatohet se: Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga

punëdhënësi dhe nga punonjësi etj., Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Realizimi i Buxhetit të Bashkisë Devoll për vitin 2024 paraqiten në tabelën mëposhtë.

Shpenzimet sipas llogarive ekonomike	Plani vjetor fillestar 2024	Plani përfundimtar 2024	Realizimi i shpenzimeve 2024	Në 000/lekë	
				% e realizimit/ planit vjetor	
Shpenzime për paga (600)	263,994	294,387	255,364		86.7
Shp. për sig shoq e shëndetësore (601)	48,141	54,353	42,402		78
Shpenzime operative (602)	178,927	246,434	175,332		71.1
Subvencione (603)	0	0	0		0
Transferta (604-606)	15,794	21,896	20,076		91.6
Shpenzime për projekte (230)	6,461	25,662	25,662		100
Shpenzime për Investime (231)	73,260	102,042	85,285		83.5
Total	586,577	744,774	604,121		81.1

Burimi: Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërm, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit:

Për **vitin 2024** fondet buxhetore janë realizuar 604,121 mijë lekë nga 744,774 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 81.1 %. Në këtë masë realizimi ka ndikuar mosrealizimi në zërat e buxhetit:

a) Në mosrealizim kanë ndikuar realizimi i fondeve në zërat, llog.602“Shpenzime operative” në masën 71.1%.

b) Shpenzimet për investime llog. 231 nga buxheti i Bashkisë së bashku me transfertën e kushtëzuar janë realizuar në masën 83 %,

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. E.D., me detyrë Kryetar i Bashkisë Devoll
2. Znj. A.F., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit

3. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

3.1. Hartimi i programit (Plan veprimi) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

3.2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

3.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Për sa më poshtë në mbështetje të shkronjave (a), (b) dhe (c) të nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 751/1 prot. datë 07.10.2024 i ka dërguar Bashkisë Devoll, “Raportin përfundimtar”, për përmirësimin e gjendjes, si dhe ka rekomanduar zbatimin e masave të mëposhtme:

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Bashkia Devoll nuk ka respektuar këtë afat.

Bashkia Devoll ka hartuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve sipas shkresës nr. 3451/1 prot., date 29.10.2024 (brenda afatit 20 ditë) për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit por nuk e ka dërguar me shkresë përcjellëse

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Referuar shkresës së dërgimit të raportit përfundimtar të auditimit me nr. 751/1 prot. datë 07.10.2025, nuk ka dërguar informacion referuar, planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.

Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se:

“Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

III. Rekomandimet e KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr. 751/1 prot., datë 07.10.2025, janë rekomanduar gjithsej:

a. Janë rekomanduar 13 masa organizative;

b. Janë rekomanduar 5 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike.

c. Është rekomanduar 1 masë për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore.

d. Janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Devoll që të shqyrtojë raportin përfundimtar të auditimit dhe ti kërkojë komisionit vendosjen e masave disiplinore për 9 punonjës të cilat janë trajtuar në raportin përfundimtar.

IV. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr. 751/1 Prot., datë 07.10.2024 statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar (Bashkia Devoll)	Pa pranuar
1	Organizative	13 masa	13 masa	-
2	Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike	5 masa	5 masa	-
3	Për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia	1 masë	1 masë	-
4	Masa Disiplinore	9 masa	9 masa	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmblëdhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	13 masa	4 masa	-	5 masë	4 masa
2	Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike	2 masa	1 masë	3 masa	1 masë	-
3	Për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia	1 masë	-	1 masë	-	-

4	Masa Disiplinore	9 masa	-	-	-	9 masa
---	------------------	--------	---	---	---	--------

Konkluzion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm (vendimi nr.193, datë 07.10.2024):

Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se:

-Janë lënë 13 masa organizative dhe janë pranuar plotësisht nga të cilat, 4 masa janë zbatuar, 5 masa në proces zbatimi dhe 4 masa nuk është zbatuar. Nga masat e zbatuara pjesërisht ose të pa zbatuara nuk rikërkohet 2 masë organizative pasi statusi i tyre është reflektuar në auditimin aktual.

-Për 5 masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifrat vendore, nga të cilat, 1 masë është zbatuar plotësisht, 3 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 1 masë në proces zbatimi.

- 1 masë për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore. Kjo masë është zbatuar pjesërisht e cila nuk do të rikërkohet sepse është reflektuar në auditimin aktual.

-Për marrjen e 9 masave disiplinore ndaj 9 punonjësve, asnjë prej tyre nuk është zbatuar

Për masat që janë cilësuar si në proces zbatimi, kërkohet vazhdimi i procedurave për realizimin e tyre.

Konkretisht rekomandimet e pazbatuara dhe zbatuar pjesërisht, për të cilat rikërkohet zbatimi i tyre, janë pasqyruar të grupuara sipas llojit të tyre, **në anekset e projekt raportit të auditimit**.

(Më hollësisht trajtuar në anekset e projekt raportit të auditimit, faqe 83-104, të Projekt Raportit të Auditimit).

Statusi i zbatimit të rekomandimeve sipas vendimit nr.66, datë 04.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimeve në Bashkinë Devoll”.

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr. 751/1 prot., datë 04.04.2025, janë rekomanduar gjithsej:

a. Janë rekomanduar 33 masa organizative;

b. Masa shpërblim dëmi 1 (një) në vlerën 1,428,100 lekë

b. Janë rekomanduar 5 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike.

c. Është rekomanduar 2 masë për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore.

d. Janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Devoll që të shqyrtojë raportin përfundimtar të auditimit dhe ti kërkojë komisionit vendosjen e masave disiplinore për 13 punonjës të cilat janë trajtuar në raportin përfundimtar.

IV. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr. 751/1 Prot., datë 04.04.2025 statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar (Bashkia Devoll)	Pa pranuar
1	Organizative	33 masa	33 masa	-
2	Masa shpërblim dëmi	1 masë	1 masë	
2	Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike	5 masa	5 masa	-
3	Për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia	2 masë	2 masë	
4	Masa Disiplinore	13 masa	13 masa	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	13 masa	4 masa	-	5 masë	4 masa
2	Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike	2 masa	1 masë	3 masa	1 masë	-
3	Për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia	1 masë	-	1 masë	-	-
4	Masa Disiplinore	9 masa	-	-	-	9 masa

Konkluzion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm (vendimi nr.66, datë 04.04.2025):

Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se:

Janë lënë 33 masa organizative dhe janë pranuar plotësisht nga të cilat, 6 masa janë zbatuar, 8 masa janë në proces zbatimi dhe 19 masa nuk janë zbatuar. Nga masat e zbatuara pjesërisht ose të pa zbatuara nuk rikërkohet 6 masë organizative pasi statusi i tyre është reflektuar në auditimin aktual.

- 1 masë shpërbllim dëmi në vlerën **1,428,100 lekë** pa TVSh nuk është zbatuar.

-Për 5 masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifrat vendore, nga të cilat, 1 masë është zbatuar plotësisht, 3 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 1 masë në proces zbatimi.

- 2 masë për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nuk janë zbatuar.

-Për marrjen e 13 masave disiplinore ndaj 13 punonjësve, asnjë prej tyre nuk është zbatuar.

Për masat që janë cilësuar si në proces zbatimi, kërkohet vazhdimi i procedurave për realizimin e tyre.

Konkretisht rekomandimet e pazbatuara dhe zbatuar pjesërisht, për të cilat rikërkohet zbatimi i tyre, janë pasqyruar të grupuara sipas llojit të tyre.

Në mënyrë të analitike statusi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

“Mjedisi i kontrollit”

Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar. Nuk ka dokument, që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut. Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet deri në njëfarë mase me ndryshimet e strukturave organike.

“Menaxhimi i Riskut”

Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit

të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

“Aktivitetet e Kontrollit”

-Bashkia Devoll nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (backup) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT, pasi një punonjës kontrollon të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin, e testimin etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari si dhe nuk është fushë drejtimi auditimi nga AB.

“Informimi dhe komunikimi”

-Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj.

“Monitorimi”

-Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 10-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll, me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së, të marrë masa për (i) hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut ku të identifikohen, analizohen, vlerësohen risqet që mund të ndikojnë në aktivitetin dhe përmbushjen e objektivave të institucionit, (ii) rishikimin periodik dy herë në vit të Regjistrisë të Riskut, (iii) të ngrihet struktura e kordinatorit dhe grupit të menaxhimit të riskut, (iv) të garantohet se njoftimi/shpallja e vendeve të lira të punës, të dërgohet zyrtarisht për tu publikuar në Portalin Kombëtar të Punësimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Brenda 6-mujorit të dytë 2024

1.1 Nga verifikimi rezultoi se: Në lidhje me rekomandimin 1.1, nga Bashkia Devoll është ngritur urdhri nr.68/1 datë 04.03.2025 me nr.662/2 prot për menaxhimin dhe kordinimin e riskut. Për vitin 2024 është hartuar strategjia e riskut.

Nga sektori i burimeve njerëzore është kryer njoftimi dhe shpallja e vendeve të lira të punës dhe është dërguar zyrtarisht për tu publikuar në Portalin Kombëtar të Punësimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Statusi: Në proces zbatimi

2.Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion konstatohet se nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk janë marrë masa që në raportin vjetore të auditimit të programohen dhe vlerësohen fusha me risk të lart në arritjen e objektivave, pasi planet vjetore nuk

janë hartuar bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, veprime në kundërshtim me nenin nr. 5 dhe nr. 6 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Bashkia Devoll nuk ka parashikuar në strukturën e saj, Komitetin e Auditimit të Brendshëm. Struktura e projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare pjesë e dosjeve të auditimit të zhvilluar në vitin 2023, nuk është hartuar plotësisht në përputhje me urdhrin nr. 4 dt. 10.10.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Në dosjet e auditimit të realizuar përgjatë vitit 2023, nuk janë bërë pjesë e Raportit Përfundimtar të Angazhimit, rubrikat e parashikuara si pjesë e Përmbledhjes Ekzekutive: a) Rezultatet e auditimit; b) Opinioni mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Nga verifikimi i Raporteve Përfundimtare të Angazhimit pjesë e dosjeve të auditimit u konstatua mungesa e rubrikës “Opinion i Përgjithshëm”, nuk është dokumentuar realizuar nga Njësia e Auditimit si dhe nuk janë konstatuar shkresa rikujtuuese nga ana e përgjegjësit të njësisë së auditimit drejtuar njësive të menaxhimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13, Urdhri nr. 4 dt. 10.10.2020 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Normave Tekniko Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 19 pika 1, Manuali i Auditimit të Brendshëm, paragrafi 4.1.12, Kreu 6, paragrafin 6.3, Kreun IV, paragrafi. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 16-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim. Të merren masa për të ngritur Komitetin e Auditimit, me qëllim rritjen e cilësisë të punës audituese

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1. Nga verifikimi rezultoi se: Në lidhje me rekomandimin 2.1, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka marrë masat si mëposhtë për zbatimin e rekomandimit.

1. Ka bërë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, sipas planit vjetor të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me shkresën me nr.2964/1prot, datë10.10.2023, mbi vlerësimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve.

Është kryer planifikimi vjetor i angazhimeve të auditimit në bazë risku sipas matricës së riskut

Statusi: Në proces zbatimi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Bashkisë Devoll rezulton se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe buxhetit të shtetit, për vitin 2023 kanë diferencë të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2023 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 648,890 mijë lekë, ndërsa realizimi vlerën 506,116 mijë lekë, ose në masën 78 %. Në mos realizimin e buxhetit ka ndikuar zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 281,095 mijë lekë dhe është realizuar në masën 82.3%. Zëri shpenzime operative (602) është planifikuar në vlerën 212,257 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 133,824 mijë lekë, ose në masën 63%. Zëri transfertat korentë të brendshme është planifikuar në vlerën 11,936 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 10,019 mijë lekë, ose në masën 84%. Zëri transfertat buxhete familjare është planifikuar në vlerën 3,921 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 3,432 mijë lekë, ose në masën 87.5%. Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 113,620 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 93,529 mijë lekë, ose në masën 82.3 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosarketimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Devoll në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale

të realizuara. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 gërma “c” dhe “ç”, Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 23-30 të raportit të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit si dhe drejtoritë/sectorët e tjerë të Bashkisë Devoll, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit dhe krijimin e faturave të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore.

Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.1. Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të buxhetit për vitin 2024 në Bashkinë Devoll planifikimi i shpenzimeve ka qënë në vlerën 744,774 lekë dhe realizimi në vlerën 604,120 mijë lekë ose 81.11%.

Statusi: Në proces zbatimi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Devoll nuk ka shlyer në kohë detyrimet ndaj të tretëve sipas detyrimeve kontraktuale. Rezulton se stoku i detyrimeve të prapambetura në datën 01.01.2023 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor vlerën 115,580,200 lekë dhe gjendja në fund të vitit 2023 rezulton në vlerën 93,897,067 lekë. Gjatë vitit 2023 janë likuiduar gjithsej 144,026,176 lekë dhe është shtuar me vlerën 122,343,043 lekë. Vlera totale e detyrimit në thesar rezulton prej 93,897,067, të cilat janë detyrime të Buxhetit të Bashkisë. Nga Bashkia Devoll konstatohet fenomeni i krijimit të detyrimeve të prapambetura gjatë vitit buxhetor, ku peshën kryesore të detyrimeve e zënë ato për investime. Këto detyrime të prapambetura janë krijuar nga marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, veprime të cilat janë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 52, Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 23-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Devoll dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuar në kontratë, duke shmangur krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Menjëherë

4.1. Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i likuidimit të kontratave të lidhura midis Bashkisë Devoll dhe Kontraktorëve u konstatua se në datën 31.12.2023 detyrimet e prapambetura kanë qënë në vlerën 93,897,067 lekë, gjatë vitit 2024 ka pasur shtesa në vlerën 47,656,390 lekë dhe pakësuar në vlerën 134,478,824 lekë. Në fund të vitit detyrimet e prapambetura kanë qënë në vlerën 7,074,633 lekë sipas shkresës me nr. 633, datë 12.02.2025 dërguar në Ministrinë e Financave.

Statusi: Në proces zbatimi

5. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave rezulton se Bashkia Devoll nuk ka marrë masa për evidentimin e diferencave të pa

mbledhura nga agjentët tatimore sipas llojit të taksës/tarifës, respektivisht nga; -Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë në lidhje me TFTH, - Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave në lidhje me rentën minerare, -ASHK në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Korçë në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 7, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 15 si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-38 të Rapiritit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga agjentët tatimorë sipas llojit të taksës apo tarifës të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat e nevojshme për penalizmin e Agjentëve Tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura në zbatim të Ligjit si dhe të krijojë bazën e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat të cilat mblidhen nga Agjentët Tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të kryhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.1. Nga verifikimi rezultoi se:

-Me Ujësjetës Kanalizime Korçë çdo fund muaj janë kryer rakordimet në lidhje me debitorët. Rakordimi është bërë me shkresën nr. 224 prot, datë 22.01.2025

-Me Drejtorinë Rajonale Tatimore Korçë në lidhje me TFTH, rakordimi është kryer çdo muaj.

-Me DRSHTRR Korçë në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura janë kryer rakordimet për çdo muaj është kryer rakordimi për diferencat. Rakordimi është bërë me datë 23.01.2025

Statusi: Në proces zbatimi

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencimit nuk ka hartuar regjistrin e abonentëve familjarë dhe private sipas Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7, Në regjistrim e mbajtur nga Bashkia Devoll gjendet si informacion vetëm lista emërore e personave të cilët duhet të ngarkohen me bazën e taksave. Regjistrim fizik i mbajtur nga Bashkia Devoll nuk është i plotësuar sipas abonentëve për detyrimet e tyre sipas paketës fiskale dhe pagesat e kryera prej tyre. Duke mos patur informacioni e saktë nga regjistri kjo do të sjelli edhe parashikim të gabuar për mbledhjen e taksave. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-38 të Rapiritit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të merren masa për hartimin e regjistrit të taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.1. Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi rezultoi se Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave nuk ka hartuar regjistrin e taksave.

Statusi: Pa zbatuar

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i evidencave analitike të llogarive të aktiveve afatgjata, u konstatua se: Në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” janë përfshirë 3 (tre) projekte “Përmirësimi i infrastrukturës Shkolla Miras” në vlerën 1,562,000 lekë, “Ndërtim ujësjetës në jashtëm dhe të brendshëm, NJA Miras” në vlerën 6,887,520 lekë, “Projektim Ujësjetës i

brendshëm në NJA Miras, nga ERALD-G” në vlerë 6,960,000 lekë (kosto historike). Këto projekte nuk duhej të kontabilizoheshin në këtë llogari pasi investimi për të cilin janë hartuar këto projekte ka përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projektit duhet të kishte kaluar në vlerën e investimit. Për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë, e cila ka sjellë pasqyrim të pasaktë të kësaj llogarie, ulje të vlerës reale të investimeve të përfunduara dhe rritje artificialisht e vlerës së projekteve, deformim të dhënash për llogarinë 212 “ Ndërtesa e Konstruksione” dhe llogarinë 213 “ rrugë rrjete e vepra ujore”.

Veprime të cilat kanë ardhur për shkak të mos njohjes së akteve ligjore e nënligjore për raportimin financiar, në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar” pika 1/b “Klasifikimi kontabël, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 2, klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) dhe pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 38-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi : Drejtoria e Financës në Bashkinë Devoll të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës prej 15,409,520 lekë të 3 (tre) studim-projektmeve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostonë së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogarinë përkatëse 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe llogarinë 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore” sipas zërave për të cilën janë realizuar, për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024

7.1. Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiarë për vitin 2024 u verifikua se vlera 15,409,520 lekë për 3 (tre) projektet e cila ishtë kontabilizuar në llogarinë 202 “Studime dhe Kërkime” është transferuar në llogarinë 212 “Ndërtesa” dhe llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

Statusi: Zbatuar plotësisht

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezulton se:

-Në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerë 767,647,588 lekë kosto historike, është përfshirë vlera 94,936,727 lekë (47,488,945 lekë nga ish-Komuna Qendër Bilisht + 47,447,782 lekë ish-Komuna Hoçisht) e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunës Qendër Bilisht dhe Hoçisht e paanalizuar. Këto vlera ndikojnë në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

- Në gjendjen e llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” në vlerën 2,404,624,620 lekë kosto historike në çelje të vitit 2023 dhe në vlerë 2,608,835,201 në mbyllje të vitit ushtrimor është përfshirë vlera 572,125,235 lekë (57,441 lekë nga ish-Komuna Miras + 338,481,513 lekë ish-Komuna Qendër + 233,586,281 lekë ish-Komuna Hoçisht) e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunës Miras, Qendër dhe Hoçisht. Për pasojë kjo mangësi ka ndikuar në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

Për sa më sipër veprimet dhe mos veprimet janë në kundërshtime me: UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 38-57 të Rapiritit Përfundimtar të Auditimit).

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare dhe të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024

8.1. Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiarë për vitin 2024 u verifikua se nuk është ndërmarrë asnjë masë për saktësimin e vlerave të kontabilizuar pa analizë në llogaritë 212 “Ndërtesa” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

9.Gjetje nga auditimi: Nga analiza e llogarisë 26 “Aktive afatgjata financiare”, rezulton se në çelje të vitit ushtrimor Bashkia Devoll, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si pjesëmarrëse me 7.76% tek “Shoqëria Rajonale e U. Ka. Ko.” Sh.A me NUIS M24431001N, me vlerë nominale 100.000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 7,762 mijë lekë e cila nuk është paraqitur në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2022 dhe 2023, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, në kundërshtim me urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivete Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35 ku citohet “Një investim në një pjesëmarrje kontabilizohet në pasqyrat financiare individuale të investitorit në përputhje me paragrafët 37-42 të SNK 27. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 38-57 të Rapiritit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandim: Drejtoria e financës me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024, të marrë masa për regjistrimin e vlerës 7,762 mijë lekë në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” të aksioneve të “Shoqëria Rajonale e U. Ka. Ko.” Sh.A me NUIS M24431001N”, me qëllim paraqitjen e saktë të vlerave kontabël në pasqyrat financiare.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024

9.1 Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2024 u verifikua se Drejtoria e Financës ka kontabilizuar në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, në pasqyrat financiare të vitit 2024 për “Shoqërinë Rajonale e U. Ka. Ko. Sh.a” për zotërimin e 7,762 aksione për vlerën 776,200 lekë dhe për Shoqërinë “KR. Sha” për zotërimin e 25 aksioneve me vlere 100 lekë për vlerën totale 413,750 lekë.

Statusi: Zbatuar plotësisht

10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezulton se llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata materiale” paraqitet në vlerën 8,095,000 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 150,085,559 lekë, në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, ku totali i këtyre llogarive nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të

investimeve” e cila paraqitet në vlerën 2,539,409 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grondeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi I, gërma “c”. Kjo vjen si pasojë e mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse në fuqi dhe sjell mos kuadrim të llogarive kontabile. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 38-57 të Raportin Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës për pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 “Fondi Bazë”.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024

10.1.Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2024 u verifikua se llogaria 231 “Investime në proces” është kontabilizuar për vlerë 42,085,797 lekë. Në këtë llogari nuk janë të kontabilizuara investime të përfunduara.

Statusi: Zbatuar plotësisht

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Devoll në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerë 26,089,133 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masë 5% e rakorduar me Degën e Thesarit Devoll. Nga analiza e llogarisë rezulton se për 5 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Devoll janë ngurtësuar fonde në vlerën 2,307,917 lekë për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Devoll, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiar dhe Buxhetit nuk janë marrë masa për zhblllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 5,461,258 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 38-57 të Raportin Përfundimtar të Auditimit).

11.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Devoll, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2023 e më parë, për të cilat ka humbur e drejta e përfitimit të tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Korçë, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.1 Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2024 u verifikua se në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në datën 31.12.2024 rezulton shuma 664,794 lekë për 3 garanci për të cilat ka kaluar afati i zhblllokimit. Ky rekomandim do të rikërkohet nga auditimi aktual në Bashkinë Devoll.

Statusi: Pa zbatuar

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, përmbledhësja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 99,212,495 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 4,672,394 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 4,897,267 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 672,949 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 4,524,882 lekë ku totali shkon në vlerën 174,573,505 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 42,533,338 lekë, në kundërshtim me Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 38-57 të Raportin Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” Veprimet e sistemuere të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024

12.1 Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2024 rezulton se llogaria 4342 “ Operacione me shtetin” është kontabilizuar për vlerën 85,443,509 lekë e cila kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm” e cila është kontabilizuar për vlerën 85,443,509 lekë.

Llogaria 4342 “ Operacione me shtetin” kuadron me llogaritë e klasës 4 si mëposhtë:

-401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to” është kontabilizuar në shumën 44,906,296 lekë

-42“Detyrime ndaj personelit” është kontabilizuar në shumën 23,011,037 lekë;

-431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” është kontabilizuar në shumën 5,839,448 lekë.

-435 “Sigurime shoqërore” është kontabilizuar në shumën 6,230,367 lekë.

-436 “Sigurime shëndetësore” është kontabilizuar në shumën 858,972 lekë.

-467 “Kreditorë të ndryshëm” është kontabilizuar në shumën 4,597,389 lekë.

Statusi: Zbatuar plotësisht

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se Bashkia Devoll ka në total 2,987 pasuri nga të cilat 1,403 pasuri në pronësi dhe 1,596 pasur në përdorim sipas VKM-ve përkatëse nga ku rezulton se nuk është bërë pasqyrimin në inventar dhe kontabilitet; nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (ASHK) Devoll; nuk ka rakordim me ZVRPP (ASHK) Korçë, për asetet pronë e Komunës, pasi nuk është marrë në dorëzim harta treguese e objekteve pronë e Komunës; nuk ka të dhëna dhe rakordim për objektet e privatizuar dhe evidencë të pronarëve që nuk kanë shlyer troje; nuk kanë filluar procedurat për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike dhe marrjen në dorëzim të aseteve, si dhe nuk është aplikuar në ZVRPP për regjistrimin e tyre si dhe nuk ka krijuar komisionit e përbashkët në zbatim të VKM së nr.28 datë, 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve – ASHK ku kërkohet një person nga ASHK-ja në krijimin e komisionit me qëllim inventarizimin dhe regjistrimin dhe përditësimin e inventarëve. Mosveprimet e mësipërme janë në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 33-2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe UMF-së nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pika 30, pika 35/a si dhe neni 37 i ligjit 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV. VKM së nr.28 datë,

27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve – ASHK. ”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 57-60 të Raportin Përfundimtar të Auditimit).

13.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës dhe të marrë masa për të krijuar një inventar të integruar për ish-komunat dhe për të koordinuar me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës me qëllim miratimin e inventarëve përfundimtare dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.1 Nga verifikimi rezultoi se: Në lidhje me rekomandimin 13.1 nga Bashkia Devoll nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimit.

Statusi: Pa zbatuar

B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesit që kanë ndaj Bashkisë Devoll konstatohet se deri më datën 31.12.2023, borxhi tatimor është në vlerën **14,421,928 lekë** shumë e cili i përket vetëm subjekte private. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, për subjektet private është krijuar borxhi tatimor në vlerën **2,480,171 lekë**. Ndërsa debitorët familjarë për vitin 2023 janë në vlerën **15,863,278 lekë**. Në total detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore gjendje 31.12.2023, janë në vlerën **30,285,206 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Devoll**. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të marrë masa për kontabilizimin e detyrimit si dhe të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri më datën 31.12.2023, në **vlerën totale 30,285,206 lekë**, e cila përbëhet nga:

-15,863,278 lekë detyrime nga abonentët familjarë;

-14,421,928 lekë detyrime nga biznesi i madh;

a. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Devoll, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë

1.1 Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve, Licencimit disponohet sipas regjistratit se debia e abonentëve biznes është në shumën 8,805,511 lekë.

Për 60 subjekte biznes është kryer bllokimi i llogarive bankare.

Për abonentët familjarë taksat dhe tarifat vendore është caktuar agjent tatimor Shoqëria Rajonale UK Korçë. Nga Drejtoria e Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve, Licencimit nuk na është vendosur në dispozicion debia e abonentëve familjarë.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

2. Gjetje nga auditimi Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Devoll në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga ASHK Korçë janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi.

Konkretisht për periudhën nga 01.01.2023 deri më 31.12.2023, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën 878,183 lekë për 22 persona, të cilët kanë paguar detyrimin. Për periudhën deri më 31.12.2022 nuk kanë paguar detyrimet 22 persona në vlerën **1,589,610** lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Devoll. Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27, pika “d”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-38 të Rapiritit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **1,589,610 lekë** ndaj **22** personave.

Brenda datës 31.12. 2024

Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për vlerën e detyrimit 1,589,610 lekë ndaj 22 personave gjatë vitit 2024 nuk është kryer asnjë pagesë dhe nga Drejtorinë e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave janë kryer vetëm njoftim detyrimet. Gjatë vitit 2024 për detyrimet e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje nuk ka pasur shtesa të debitorëve.

Statusi: Në proces zbatimi

3. Gjetje nga auditimi Nga auditimi i të ardhurave nga dhënia me qira e tokave bujqësore për periudhën nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, konstatohet se, Bashkia Devoll ka lidhur 8 kontrata të reja si dhe ka vazhduar me rinovimin e afatit të 13 kontratave të mëparshme. Në total për 6 njësitë administrative janë aktive 21 kontrata për vitin 2023 në vlerën 5,819,796 lekë nga të cilat janë likuiduar 16 kontrata në vlerën 2,100,556 lekë duke ngelur pa u arkëtuar vlera 3,719,240 lekë nga mos arkëtimi i 5 kontratave për vitin 2023, si dhe nuk është arkëtuar vlera prej 1,200,000 lekë për 1 kontratë që i përket periudhës përpara vitit ushtrimor 2023 nga subjekti “V” Sh.A. Në

total vlera debitorë sipas kontratave është në vlerën 4,907,240 lekë e cila konsiderohet e ardhur munguar në buxhetin e Bashkisë Devoll.

Referuar të dhënave të marra nga Sektori i Financës mbi zbatimin e detyrave të lëna nga auditim i mëparshëm në këtë bashki dhe konkretisht mbi problematikat për kontratat e qirave, rezulton se nga Sektori Juridik dhe Sektori i të Ardhurave Vendore nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e detyrimeve të evidentuara nga KLSH-ja për 5 subjekte me vlerë 21,171,780 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë Devoll.

Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-38 të Rapirtit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit të Pyjeve, Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Financë Buxhetit, të marrin masa për kontabilizimin e detyrimit si dhe të ndjek të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimit 4,907,240 lekë sipas aneksit nr. 2 pika 5 bashkëlidhur Rapirtit Përfundimtar të Auditimit.

3.2.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Liçensave dhe Lejeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit të Pyjeve, Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Financë Buxhetit, të të ndjek të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimit për qiranë e pa llogaritur dhe papaguar në shumë **21,171,780 lekë**, respektivisht:

-**vlera 1,150,000 lekë** nga shoqëria “V” sha;

-**vlera 300,000 lekë** nga shoqëria “I. 02” SHPK;

-**vlera 2,482,980 lekë** nga shoqëria “M.HEC-Qytezë” SHPK;

-**vlera 17,238,800 lekë** nga shoqëria “K. 93” SHPK.

Brenda datës 31.12. 2024

Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i dokumentacionit për arkëtimin e detyrimeve për detyrimet e lënë për rekomandimin 3.1 u verifikua si mëposhtë:

-“V” sha; me vlerë detyrimi 1,600,000 lekë është paguar në datën 06.08.2024

-“I. 02” SHPK; me vlerë detyrimi 300,000 lekë është paguar në datën 15.01.2024

-“V” sha; me vlerë detyrimi 250,000 lekë;

-“E” shpk me vlerë detyrimi 33,700 lekë nuk ka paguar.

-“D.S.” me vlerë detyrimi 2,723,540 lekë nuk ka paguar.

Në lidhje me rekomandimin 3.2 nga verifikimi i dokumentacionit kemi situatën si mëposhtë:

“V” sha me vlerë detyrimi 1,150,000 lekë është paguar në datën 06.08.2024 është e njëjta kontratë si në rekomandimin 3.1.

“I 02” SHPK; me vlerë detyrimi 300,000 lekë është paguar në datën 15.01.2024.

“M HEC-Qytezë” SHPK” shpk me vlerë detyrimi 2,482,980 lekë nuk ka paguar dhe Shoqëria “M HEC-Qytezë” është në proces gjyqësor me shoqërinë “A” sha.a blerësi i aksioneve të shoqërisë.

-“K 93” SHPK me vlerë detyrimi 17,238,800 lekë, kjo vlerë detyrimi nuk është pranuar nga shoqëria dhe do të shkoj në proces gjyqësor.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

4. Gjetje nga auditimi Sipas të dhënave të marra nga Bashkia Devoll dhe nga auditimi i tyre, rezultoni se ushtrojnë aktivitet të tregtimit të hidrokarbureve gjithsej aktivë **9 pika** të tregtimit të karburanteve dhe nënprodukteve të tij, ku detyrimi për taksën e autorizimeve që subjekte duhet të likuidojnë është 9,000,000 lekë. Kanë paguar detyrimin 7 subjekte me vlerë 7,000,000 lekë dhe 2 subjekte e kanë paguar atë pjesërisht, ku nga vlera 2,000,000 lekë është paguar vlera 1,400,000 lekë, **duke mbetur për likuidim vlera 600,000 lekë, të cilat konsiderohen të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Devoll.**

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit nr. 77, datë 19.5.2008 “Për procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, pasi marrëveshje është për detyrimet e palikujduara në fund të periudhave ushtrimore dhe zgjat vetëm një vit kalendarik. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave, të marrë masat për kontabilizimin e detyrimit si dhe të ndjek të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej **600,000 lekë** nga 2 subjektet, *respektivisht:*

1. **vlera 200,000 lekë** nga subjekti “MEC ShPK;
2. **vlera 400,000 lekë** nga subjekti “I. O” ShPK.

Brenda datës 31.12. 2024

Nga verifikimi rezultoi se: Subjekte “MEC” ShPK me vlerë detyrimi 200,000 lekë ka paguar 200,000 lekë në datën 06.08.2024.

“I.O” ShPK me vlerë detyrimi 400,000 lekë ka paguar 200,000 lekë në datën 16.12.2024.

Statusi: Zbatuar plotësisht

C.1. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të viti 2023 rezultoni se në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet më datën 01.01.2023, në vlerën 66,670,236 lekë, ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023 paraqitet në vlerën **66,664,236 lekë** me një zbritje në vlerën 6,000 lekë që i përket deturimeve të periudhës 2003-2018. Nga analiza e kësaj nuk është përfshirë vlera 58,553,508 lekë gjendje 31.12.2023 e cila i përket debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore të biznesit, familjarë dhe detyrime kontraktuale, dhe për pasojë kjo llogari nuk paraqet situatën reale debitorë. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në lidhje me këtë situatë nuk ka një korrespondencë ndërmjet Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Liçensave dhe Drejtorisë së Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 38-57 të Raportit të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçensave të merren masat për arkëtimin e detyrimeve të kontabilizuara, dhe të pa shlyera nga të ardhurat vendore gjendje 31.12.2023 në vlerën **66,664,236 lekë** sipas evidencave të Drejtorisë të Ardhurave Lejeve dhe Liçensave.

1.2.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e

vlerave debitoare.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin 1.1 detyrimet e kontabilizuara në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” janë detyrime të hershme dhe nga ish-komunat. Për këtë detyrime gjatë vitit 2024 nuk ka pasur arkëtime, nga Bashkia Devoll nuk është marrë asnjë masë për vlerësimin e këtyre debitorëve dhe vlerësimin e tyre si debitorë pa shpresë. Ky rekomandim do të rikërkohet nga auditimi aktual në Bashkinë Devoll.

Statusi: Pa zbatuar

D. MASA DISIPLINORE.

Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Devoll**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a- Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, sipas gurmës “c” e nenit 58, për 3 (tre) punonjësit e mëposhtëm:

1. Znj. A.F. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit Financiar, për mos kuadrim të shumatores së llogarisë 230 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” me mbylljen e shumatores së llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe llogarisë 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë. Për mos kuadrim të përmbledhësës së llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, 435 “Sigurime shoqërore”, 436 “Sigurime shëndetësore”, 467 “Kreditorë të ndryshëm” e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)”. Për arsye se informacioni kontabël i llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është nënvlerësuar në vlerën 120,774,784 lekë. (*Shih trajtimin në Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 59-90*).

2. Z. G.H., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave;

3. Znj. D.R., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Kontabilizimit të të Ardhurave;

4. Znj. V.B., me detyrë specialiste Sektorit i Kontabilizimit të të Ardhurave;

5. Z. I.D., me detyrë Përgjegjës Sektori i Inspektoriatit Tatimor, Kundëravajtjeve Administrative, Debitorëve, Konfiskimi dhe Sekuestrimi;

6. Z. G.M., me detyrë specialist i Sektorit të Kontabilizimit të të Ardhurave;

Për mos ndjekjen e të gjitha rrugëve për arkëtimin e detyrimeve nga taksat dhe tatimet për debitorët në vlerën **58,553,508** lekë. Për mos mbajtjen e regjistrave për abonentët familjarë dhe biznesit. Për tarifimin jo të saktë të taksës së ndërtesës dhe të truallit. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-38 të Raportit të Auditimit*).

7. Z. E.R., me detyrë përgjegjësi i sektorit të aseteve për mangësit e konstatuara në përcaktimin e procedurave të hollësishtme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpuniminndërmjet institucioneve – ASHK.

E. Për punonjësit **zj. A.K.**, me detyrë përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Brendshëm dhe **z. E.Sh.**, me detyrë specialist në Auditimin e Brendshëm nuk rekomandojmë masë disiplinore për arsye se shkeljet e konstatuara janë të një rëndësie të ulët dhe nuk janë materiale

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm nuk është marrë asnjë masë nga Kryetari i Bashkisë Devoll.

Statusi: Pa Zbatuar

F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Devoll pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Konkluzion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm Nga verifikimi i rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur i Raportit Përfundimtar të Auditimit me nr. 751/1 prot. datë 07.10.2024, statusi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

- **Mbi respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh**, Bashkia Devoll nuk ka respektuar këtë afat, në kundërshtim me nenin 15, shkronja "j", të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", duke mos kthyer përgjigje referuar shkresës me nr.751/1 prot, datë 07.10.2024 dërgimi i raportit përfundimtar të auditimit.

Bashkia Devoll ka hartuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve sipas shkresës nr. 3451/1 prot., date 29.10.2024 (brenda afatit 20 ditë) për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit por nuk e ka dërguar me shkresë përcjellëse

- **Mbi respektimin e afatit ligjor prej 6 muajsh, Bashkia Devoll.**

Referuar shkresës së dërgimit të raportit përfundimtar të auditimit me nr. 751/1 prot. datë 07.10.2025, nuk ka dërguar informacion referuar, planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.

Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se:

"Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna".

Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna sipas vendimit nr.193, datë 02.10.2024 në auditimin e mëparshëm rezultoi se:

-Janë lënë 13 masa organizative dhe janë pranuar plotësisht nga të cilat, 4 masa janë zbatuar, 5 masa në proces zbatimi dhe 4 masa nuk është zbatuar. Nga masat e zbatuara pjesërisht ose të pa zbatuara nuk rikërkohet 2 masë organizative pasi statusi i tyre është reflektuar në auditimin aktual.

-Për 5 masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, nga të cilat, 1 masë është zbatuar plotësisht, 3 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 1 masë në proces zbatimi.

- 1 masë për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore. Kjo masë është zbatuar pjesërisht e cila nuk do të rikërkohet sepse është reflektuar në auditimin aktual.

-Për marrjen e 9 masave disiplinore ndaj 9 punonjësve, asnjë prej tyre nuk është zbatuar.

Për masat që janë cilësuar si në proces zbatimi, kërkohet vazhdimi i procedurave për realizimin e tyre. Po ashtu, për masat që nuk janë zbatuar ose janë zbatuar pjesërisht, KLSH rikërkon realizimin e plotë të rekomandimeve, si më poshtë:

6.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të merren masa për hartimin e regjistrat të taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të ngrëjë një grup pune me specialistë të fushës dhe të marrë masa për të krijuar një inventar të integruar për ish-komunat dhe për të koordinuar me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës me qëllim miratimin e inventarëve përfundimtare dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.1 Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të marrë masa për kontabilizimin e detyrimit si dhe të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri më datën 31.12.2023, në **vlerën totale 30,285,206 lekë**, e cila përbëhet nga:

-15,863,278 lekë detyrime nga **abonentët familjarë;**

-14,421,928 lekë detyrime nga **biznesi i madh;**

a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Devoll, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit të Pyjeve, Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Financë Buxhetit, të marrin masa për kontabilizimin e detyrimit si dhe të ndjek të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimit 4,907,240 lekë sipas aneksit nr. 2 pika 5 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3.2.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit të Pyjeve, Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Financë Buxhetit, të të ndjek të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimit për qiranë e pa llogaritur dhe papaguar në shumë **21,171,780 lekë**, respektivisht:

-vlera **1,150,000 lekë** nga shoqëria “V” sha;

-vlera **300,000 lekë** nga shoqëria “I 02” SHPK;

-vlera **2,482,980 lekë** nga shoqëria “M.HEC-Qytezë” SHPK;

-vlera **17,238,800 lekë** nga shoqëria “K 93” SHPK.

Brenda datës 31.12. 2024

a- Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, sipas germës “c” e nenit 58, për 3 (tre) punonjësit e mëposhtëm:

1. Znj. A.F., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit Financiar, për mos kuadrim të shumatores së llogarisë 230 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” me mbylljen e shumatores së llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe llogarisë 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë. Për mos kuadrim të përmbledhësës së llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, 435 “Sigurime shoqërore”, 436 “Sigurime shëndetësore”, 467 “Kreditorë të ndryshëm” e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)”. Për arsye se informacioni kontabël i llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është nënvlerësuar në vlerën 120,774,784 lekë. *(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 59-90).*

2. Z. G.H., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave.

3. Znj. D.R., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Kontabilizimit të të Ardhurave.

4. Znj. V.B., me detyrë specialiste Sektorit i Kontabilizimit të të Ardhurave.

5. Z. I.D., me detyrë Përgjegjës Sektori i Inspektoriatit Tatimor, Kundravajtjeve Administrative, Debitorëve, Konfiskimi dhe Sekuestrimi.

6. Z. G.M., me detyrë specialist i Sektorit të Kontabilizimit të të Ardhurave

Për mos ndjekjen e të gjitha rrugëve për arkëtimin e detyrimeve nga taksat dhe tatimet për debitorët në vlerën **58,553,508 lekë**. Për mos mbajtjen e regjistrave për abonentët familjarë dhe biznesit. Për tarifimin jo të saktë të taksës së ndërtesës dhe të truallit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-38 të Raportit të Auditimit).*

7. Z. E.R., me detyrë përgjegjësi i sektorit të aseteve për mangësit e konstatuara në përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpuniminndërmjet institucioneve – ASHK.

E. Për punonjësit **zj. A.K.**, me detyrë përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Brendshëm dhe **z. E.Sh.**, me detyrë specialist ne Auditimin e Brendshëm nuk rekomandojmë masë disiplinore për arsye se shkeljet e konstatuara janë të një rëndësie të ulët dhe nuk janë materiale.

Në lidhje me vendimin nr. 66, datë 04.04.2025 në zbatim të programit të auditimit të sipër cituar, pika 3 u auditua zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm në Bashkinë Devoll. Për auditimin e kësaj pike u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti i audituar, si më poshtë vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

2.1. Rekomandimi: Bashkia Devoll, të marrë masa e nevojshme, që grupi i GMS të kryejë detyrat përkatëse, duke vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar si dhe të ndjekë realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Në lidhje me rekomandimin nr.2.1 në Bashkinë Devoll referuar programit të auditimit nr.614/1 prot, datë 30.05.2025 është audituar pika e programit nr.1 “Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm”. Nga auditimi, rekomandimi i mësipër do të rikërkohet në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

2.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll, drejtorët e drejtorive, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Në lidhje me rekomandimin 2.2, nga Bashkia Devoll është ngritur urdhri nr.68/1 datë 04.03.2025 me nr.662/2 prot për menaxhimin dhe kordinimin e riskut. Për vitin 2024 është hartuar strategjia e riskut.

Statusi: Në proces zbatimi

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit në bashkëpunim me drejtoritë/sectorët e tjerë të Bashkisë Devoll, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit dhe krijimin e faturave të palikuiduara në fund të periudhave ushtrimore.

Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të buxhetit për vitin 2024 në Bashkinë Devoll planifikimi i shpenzimeve ka qënë në vlerën 744,774 lekë dhe realizimi në vlerën 604,120 mijë lekë ose 81.11%.

Statusi: Në proces zbatim

4.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i likuidimit të kontratave të lidhura midis Bashkisë Devoll dhe Kontraktorëve u konstatua se në datën 31.12.2023 detyrimet e prapambetura kanë qënë në vlerën 93,897,067 lekë, gjatë vitit 2024 ka pasur shtesa në vlerën 47,656,390 lekë dhe pakësuar në vlerën 134,478,824 lekë. Në fund të vitit detyrimet e prapambetura kanë qënë në vlerën 7,074,633 lekë sipas shkresës me nr. 633, datë 12.02.2025 dërguar në Ministrinë e Financave.

Statusi: Në proces zbatimi

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryejë parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifave vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të Bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Referuar planifikimit të të ardhurave për vitin 2024, Bashkia Devoll ka planifikuar shumën 202,572 mijë lekë dhe realizimi është në vlerën 148,238 mijë lekë ose në masën 73%.

Statusi: Në proces zbatimi

6.1.Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga agentët tatimorë sipas llojit të taksës apo tarifës të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat e nevojshme për penalizimin e Agjentëve Tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, neni 17. Të krijojë bazën e të dhënave për subjektet, tarifave apo taksat të cilat mbledhen nga Agjentët Tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të kryhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se:

-Me Ujësullës Kanalizime Korçë çdo fund muaj janë kryer rakordimet në lidhje me debitorët. Rakordimi është bërë me shkresën nr. 224 prot, datë 22.01.2025

-Me Drejtorinë Rajonale Tatimore Korçë në lidhje me TFTH, rakordimi është kryer çdo muaj.

-Me DRSHTRR Korçë në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura janë kryer rakordimet për çdo muaj është kryer rakordimi për diferencat. Rakordimi është bërë me datë 23.01.2025

Statusi: Në proces zbatimi

7.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të merren masa për hartimin e regjistrit të taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi rezultoi se Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave nuk ka hartuar regjistrin e taksave. Rekomandimi i mësipërm është rikërkuar përsëri sipas vendimit nr.193, datë 02.10.2024.

Statusi: Pa zbatuar

8.1. Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të marrë masa në të ardhmen që në lidhje me procesin e asgjësimit të aktiveve të mbahet parasysht kuadri rregullativ ligjor për mbrojtjen e mjedisit si dhe të kërkohet plotësimi i saktë i dokumentacionit, të rregullt dhe justifikues, sipas përcaktimeve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2024 nga grupi i inventarizimit dhe vlerësimit, materiale me vlerë 4,358,198 lekë janë propozuar për dalje nga përdorimi. Asgjësimi i materialeve nuk është kryer brenda vitit 2024.

Statusi: Në proces zbatimi

9.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2023 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 520 “Disponibilitet në thesar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2024 llogaria 520 është kontabilizuar për vlerën 98,478,928 lekë, llogaria 466 është kontabilizuar për vlerën 13,146,699 lekë dhe llogaria 85 është kontabilizuar për vlerën 85,332,229 lekë.

Nga sa më sipër llogari 520 kuadron me llogaritë me lartë.

Statusi: Zbatuar plotësisht

10.1. Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë 470 “Të ardhura për t’u marrë”.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Devoll rezultoi se Drejtoria e Financës nuk ka kontabilizuar shumën e llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë 470 “Të ardhura për t’u marrë”.

Referuar programit të auditimit nr.614/1 prot, datë 30.05.2025 është audituar pika e programit nr.2 “Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e paqyrave financiare vjetore”. Nga auditimi, rekomandimi i mësipër do të rikërkohet në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 1,562,000 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiarë për vitin 2024 u verifikua se vlera 15,409,520 lekë për 3 (tre) projektet e cila ishtë kontabilizuar në llogarinë 202 “Studime dhe Kërkime” është kaluar në llogarinë 212 :Ndërtesa” dhe llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

Statusi: Zbatuar plotësisht

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të kryejë zbrëthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësisht të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiarë për vitin 2024 u verifikua se nuk është ndërmarrë asnjë masë për saktësimin e vlerave të kontabilizuar pa analizë në llogaritë 212 “Ndërtesa” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet në auditimin aktual. Rekomandimi i mësipërm është rikërkuar përsëri sipas vendimit nr.193, datë 02.10.2024.

Statusi: Pa zbatuar

13.1. Rekomandimi: Bashkia Devoll të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë asetëve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene”, 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave (të transferuara), sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në

fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

Bashkia Devoll të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për të kthyer pasuritë me nr. 626/1, ZK nr. 1254, me emërtimin “Ish-Kopshti Borsh” dhe nr. 1096/1, ZK nr. 1260, me emërtimin “Muzeu Bradvice” të zaptuara nga persona të tretë në përdorim si aset të Bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2024 u verifikua se nuk është ndërmarrë asnjë masë për saktësimin e vlerave të kontabilizuar pa analizë në llogaritë 212 “Ndërtesa” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet në auditimin aktual. Rekomandimi i mësipërm është rikërkuar përsëri sipas vendimit nr.193, datë 02.10.2024.

Statusi: Pa zbatuar

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit, pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” me kundërparti llogaritë 105 “Teprica e grondeve kapitale të brendshme”, 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 “Fondi Bazë”.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Rezultoi se rekomandimi i mësipërm është rikërkuar përsëri sipas vendimit nr.193, datë 02.10.2024.

Statusi: Pa zbatuar

15.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2023 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2024 rezulton se llogaria 4342 “ Operacione me shtetin” është kontabilizuar për vlerën 85,443,509 lekë e cila kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm” e cila është kontabilizuar për vlerën 85,443,509 lekë.

Llogaria 4342 “ Operacione me shtetin” kuadron me llogaritë e klasës 4 si mëposhtë:

-401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to” është kontabilizuar në shumën 44,906,296 lekë

-42“Detyrime ndaj personelit” është kontabilizuar në shumën 23,011,037 lekë;

-431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” është kontabilizuar në shumën 5,839,448 lekë.

-435 “Sigurime shoqërore” është kontabilizuar në shumën 6,230,367 lekë.

-436 “Sigurime shëndetësore” është kontabilizuar në shumën 858,972 lekë.

-467 “Kreditorë të ndryshëm” është kontabilizuar në shumën 4,597,389 lekë.

Statusi: Zbatuar plotësisht

16.1. Rekomandimi: Me qëllim që të mos krijohen detyrime të prapambetura dhe planifikimi i shpenzimeve të një viti buxhetor të mos rëndoj shpenzimet e vitit pasardhës, Kryetari i Bashkisë Devoll dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të marrë masa të menjëhershme për pagesën e faturave të palikuiduara në vlerën totale 16,646,691 lekë. Gjithashtu të paraqesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak një material për gjendjen e faturave të palikuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2024 rezulton se detyrimet e prapambetura janë në vlerën 7,074,633 lekë.

Statusi: Në proces zbatimi

17.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll, Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të marrë masa për kalimin e fondeve të secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2024 rezulton se në llogarinë 466 vazhdon të ketë të kontabilizuar fonde për garanci punimesh për të cilat ka kaluar afati i granacisë. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Në proces zbatimi

18.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2023 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2024 rezulton se llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” është kontabilizuar në vlerën 2,951,535,772 lekë në përputhje me udhëzimin nr.5.

Statusi: Zbatuar plotësisht

19.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Devoll dhe Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore të hartohen rregulla të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja si dhe për transferimet dhe ngritjen në detyrë për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Referuar programit të auditimit nr.614/1 prot, datë 30.05.2025 është audituar pika e programit nr.1, “Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm”, nga auditimi nuk janë konstatuar problematika në rekrutimin e punonjësve.

Statusi: Zbatuar plotësisht

20.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Devoll dhe Agjencia e Shërbimeve Utilitare, Komunitare dhe Administrative të merren masa për pajisjen e punonjësve që punojnë në pozicionet e punës elektrikistë me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik, për të parandaluar çdo ngjarje në dëm të shëndetit dhe jetës së tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga verifikimi i 2 prej punonjësve të kësaj Agjencie u verifikua se janë të pajisur me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik.

Statusi: Zbatuar plotësisht

21.1. Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Devoll, Përgjegjësi i Prokurimeve si dhe Njësia e Prokurimit, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Referuar programit të auditimit nr.614/1 prot, datë 30.05.2025 auditim financiar në Bashkinë Devoll nuk është audituar pika e procedurave të prokurimit.

Statusi: Pa Zbatuar

22.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, (komisioni përkatës), të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, përpara hartimit të urdhrimit të prokurimit të aplikojë mënyrën dhe përlllogaritjen e vlerës së kontratës me qëllim dokumentimin dhe argumentimin e saj në përputhje me fondet buxhetore të miratuara. Gjithashtu të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e tekniko-ligjor të përzgjedhjes së procedurës së prokurimit referuar specifikimeve teknike të objektit të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Referuar programit të auditimit nr.614/1 prot, datë 30.05.2025 auditim financiar në Bashkinë Devoll nuk është audituar pika e procedurave të prokurimit.

Statusi: Pa Zbatuar

23.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, (komisioni përkatës), të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, të përcaktojnë saktë sasinë për karburant, duke argumentuar me dokumentacion justifikues dhe provues nevojat e Institucionit.

Titullari i AK të caktojë në komisionet e ngritura, specialist të fushës me qëllim vlerësim sa më objektiv të procesit të prokurimit. Gjithashtu të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e tekniko-ligjor të specifikimeve teknike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Referuar programit të auditimit nr.614/1 prot, datë 30.05.2025 auditim financiar në Bashkinë Devoll nuk është audituar pika e procedurave të prokurimit.

Statusi: Pa Zbatuar

24.1. Rekomandimi: Bashkia Devoll, Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla të marrë masa që:

-Përgjatë hartimit të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve, të shmangët mundësia e copëzimit të fondeve për të njëjtin grup mallrash apo shërbimesh.

-Të argumentohen kriteret e veçanta për kualifikim.

-Për çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit publik të respektohet afati i kalimit nga një operatorë ekonomikë tek tjetri në rastet e tërheqjes apo s'kualifikimit të tyre.

-Për rastet që mallrat e prokuruar nuk paraqiten nga operatori ekonomikë brenda afateve të përcaktuara në ftesën për ofertë të bëhet s'kualifikimi i tyre.

-Për çdo rast likuidimi i faturave të kryhet brenda afateve ligjore duke shmangur krijimin e detyrimeve kontraktuale.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Referuar programit të auditimit nr.614/1 prot, datë 30.05.2025 auditim financiar në Bashkinë Devoll nuk është audituar pika e procedurave të prokurimit.

Statusi: Pa Zbatuar

25.1 Rekomandimi: Bashkia Devoll në bashkëpunim me Ujësjetës Kanalizime Devoll ShA dhe sistemin OSHEE të marrë masa të menjëhershme për lidhjen e energjisë elektrike për vendosjen në funksion të sistemit të klorinimit, duke mbajtur në parametrat e kërkuar sasinë e klorit e për rrjedhojë ruajtjen e shëndetit publik dhe uljen e kostove të klorinimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Referuar programit të auditimit nr.614/1 prot, datë 30.05.2025 auditim financiar në Bashkinë Devoll nuk është audituar pika e zbatimit të kontratave.

Statusi: Pa Zbatuar

26.1 Rekomandimi: Nga Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT), Bashkia Devoll të merren masa për respektimin e distancave dhe kondicioneve urbane sipas përcaktimeve ligjore dhe rregullatorë në fuqi, për shqyrtimin e vetëm atyre aplikimeve që kanë informacion të saktë në dokumentacionin shoqëruar, si dhe për të kërkuar në çdo rast evidentimin e përcaktimeve për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapësira publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Referuar programit të auditimit nr.614/1 prot, datë 30.05.2025 auditim financiar në Bashkinë Devoll nuk është audituar Sektori Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Statusi: Pa Zbatuar

27.1 Rekomandimi: Nga SPZHT dhe Bashkia Devoll të merren të gjitha masat për të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose certifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqëruar të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi, si dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi me mangësi të tilla. SPZHT duhet të kërkojë në çdo rast dokumentacionin që vërteton statusin aktiv dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) të subjekteve që kanë hartuar projektin ndërtimor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Referuar programit të auditimit nr.614/1 prot, datë 30.05.2025 auditim financiar në Bashkinë Devoll nuk është audituar Sektori Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Statusi: Pa Zbatuar

27.2 Rekomandimi: SPZHT dhe Bashkia Devoll të marrin masa për të kontrolluar të gjithë dokumentacionin e dorëzuar mbi saktësinë dhe plotësinë e tij, me qëllim marrjen e të gjithë informacionit të nevojshëm mbi objektin në zhvillim, duke respektuar gjithashtu afatet e përcaktuara në ligj për shqyrtimin e aplikimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Referuar programit të auditimit nr.614/1 prot, datë 30.05.2025 auditim financiar në Bashkinë Devoll nuk është audituar Sektori Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Statusi: Pa Zbatuar

27.3 Rekomandimi: SPZHT dhe Bashkia Devoll të marrin masa për të kërkuar në çdo rast që aplikohet për leje ndërtimi, rifreskimin e kartelave të pasurisë së paluajtshme në më pak se tre muajt e fundit, me qëllim marrjen e sigurisë së mbi pronë nuk janë aplikuar tjetërsime.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Referuar programit të auditimit nr.614/1 prot, datë 30.05.2025 auditim financiar në Bashkinë Devoll nuk është audituar Sektori Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Statusi: Pa Zbatuar

27.4 Rekomandimi: Nga SPZHT dhe Bashkia Devoll të merren të gjitha masat për të shqyrtuar vetëm ato aplikime për leje zhvillimi, të cilat kanë ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, ndër të tjera, edhe projekt-idenë arkitektonike të objektit që kërkohet të zhvillohet, me qëllim dhënien e një vlerësimi të saktë mbi respektimin e kriteve urbane në varësi të funksionit të saj dhe të përdorimit të tokës, në përputhje me dispozitat ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Referuar programit të auditimit nr.614/1 prot, datë 30.05.2025 auditim financiar në Bashkinë Devoll nuk është audituar Sektori Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Statusi: Pa Zbatuar

28.1 Rekomandimi: Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT) dhe Bashkia Devoll të marrin të gjitha masat për të kërkuar dhe respektuar, në çdo rast që aplikohet për leje ndërtimi, mendimin e autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, me

qëllim marrjen e sigurisë së plotë mbi konformitetin e objektit në zhvillim me kriteret, dispozitat, infrastrukturën si dhe projektet e planifikuara të këtyre autoriteteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Referuar programit të auditimit nr.614/1 prot, datë 30.05.2025 auditim financiar në Bashkinë Devoll nuk është audituar Sektori Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Statusi: Pa Zbatuar

29.1 Rekomandimi: Bashkia Devoll, Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT) dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të marrin të gjitha masat për të ushtruar kontroll mbi objektin me leje të miratuar, me vendim për miratim nr. 1442/1 prot; datë 13.05.2022, për verifikimin e situatës, në lidhje me objektet e evidentuara si objekte të paparashikuara në lejen e ndërtimit, si dhe për verifikimin e situatës për ndryshimin e pozicionit të objektit ndihmës funksional, si dhe nisjen e procedurave administrative ndaj kundërvajtësve. Në rast se zhvilluesi aplikon për pajisje me certifikate përdorimi, SPZHT dhe Bashkia Devoll të marrin masa për miratimin e aplikimit, vetëm pasi të vërtetohet përputhshmëria e objektit të ndërtuar me projektin e miratuar në lejen e ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Referuar programit të auditimit nr.614/1 prot, datë 30.05.2025 auditim financiar në Bashkinë Devoll nuk është audituar Sektori Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Statusi: Pa Zbatuar

29.2 Rekomandimi: Bashkia Devoll, Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, si dy struktura përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme, por edhe kontrollin e zbatimit të objekteve të ndërtuara me leje apo në shkelje të saj, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga kuadri ligjor në fuqi, të marrin të gjitha masat për të rritur bashkëpunimin ndër-institucional në lidhje me kryerjen e inspektimeve përpara miratimit të lejeve të ndërtimit, si dhe gjatë ndërtimit dhe para procesit të certifikimit të objektit, me qëllim minimizimin e rasteve kur zhvilluesi nis ndërtimin e objektit përpara miratimit të lejes së ndërtimit, ose kur objekti i miratuar nuk është i njëjtë me atë të ndërtuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Referuar programit të auditimit nr.614/1 prot, datë 30.05.2025 auditim financiar në Bashkinë Devoll nuk është audituar Sektori Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Statusi: Pa Zbatuar

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1.1 Rekomandimi: Bashkia Devoll të marrë masa, për arkëtimin e shumës **1,428,100 lekë pa TVSh**, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE "Z" ShPK & "K" ShPK sipas kontratës së lidhur me Nr. 3322 Prot., datë 10.01.2020 për realizimin e punimeve civile.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm 1.1 nga Bashkia Devoll nuk është marrë asnjë masë.

Statusi: Pa Zbatuar

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR(TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1.1 Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për

arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri më datën 31.12.2022, në **vlerën totale 34,559,770 lekë**, e cila përbëhet nga:

-21,081,338 lekë detyrime nga **abonentët familjarë**;

-8,312,347 lekë detyrime nga **biznesi i madh**;

-4,464,085 lekë detyrime nga **biznesi i vogël**;

-702,000 lekë detyrime nga **institucionet**;

a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave, të bëhet kallëzim penal.

e. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Devoll, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Rezultoi se rekomandimi i mësipërm është rikërkuar përsëri sipas vendimit nr.193, datë 02.10.2024.

Statusi: Në proces zbatimi

2.1 Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **1,815,258 lekë** ndaj **21** personave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Rezultoi se rekomandimi i mësipërm është rikërkuar përsëri sipas vendimit nr.193, datë 02.10.2024.

Statusi: Në proces zbatimi

2.2. Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria së Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave, për personat të cilat nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leja, t'i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Korçë vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Rezultoi se rekomandimi i mësipërm është rikërkuar përsëri sipas vendimit nr.193, datë 02.10.2024.

Statusi: Në proces zbatimi

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit të Pyjeve, Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Financë Buxhetit, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimit për qiranë e pa llogaritur dhe papaguar në shumë **19,720,980 lekë**, respektivisht:

-vlera 2,482,980 lekë nga shoqëria "M.HEC-QYTEZË" ShPK;

-vlera 17,238,800 lekë nga shoqëria “K 93” ShPK.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Rezultoi se rekomandimi i mësipërm është rikërkuar përsëri sipas vendimit nr.193, datë 02.10.2024.

Statusi: Në proces zbatimi

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Devoll, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve, Mbrojtjes së Tokës dhe Konsumatorit duhet të marrë masa të menjëhershme lidhur me:

1. T’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kulloror këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorore të mbetura.

2. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkohej Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

3. Të vendosen marrëdhënie kontraktuale me Operatorët Ekonomikë duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale prej 113 ha, duke aplikuar tarifën dysheme/minimal për të llogaritur vlerat e sakta të qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit (**7,006,000**, për 3 subjektet e mësipërme).

Menjëherë dhe në vijimësi

5.1.Rekomandimi:Bashkia Devoll, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej **600,000 lekë** nga 2 subjektet, *respektivisht* 1. **vlera 200,000 lekë** nga subjekti “MEC” ShPK; dhe 2. **vlera 400,000 lekë** nga subjekti “I.O” ShPK.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Rezultoi se rekomandimi i mësipërm është rikërkuar përsëri sipas vendimit nr.193, datë 02.10.2024.

Statusi: Në proces zbatimi

6.1. Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Devoll, për ndërtimet e kundërligjshme të nxjerrë urdhrat e ekzekutimit dhe të ri kërkohej edhe njëherë Inspektorati Kombëtar të Mbrojtjes Territorit, për hartimin e një plani të përbashkët veprimi duke mbështetur me forca dhe mjete me qëllim zbatimin vendimeve të ekzekutimit të ndërtimeve të kundërligjshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Rezultoi se rekomandimi i mësipërm është rikërkuar përsëri sipas vendimit nr.193, datë 02.10.2024.

Statusi: Në proces zbatimi

6.2. Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Devoll, të përcjellë në kontabilitet dhe të vazhdojë procedurat për arkëtimin për arkëtimin e **2** kundërvajtësve në vlerën **100,000 lekë**), duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore. Ndërkohë për rastet e mos pagesës të vlerës gjobave brenda afatit 5-ditor kur të dërgohen në gjykatë për kthimin në tituj ekzekutiv të përllogariten edhe kamat vonesat 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm në bazë të ligjit nr.127/2024 , datë 19.12.2024 “Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 1 janar 2015 deri në datë 30 nëntor 2024”.

Statusi: Zbatuar plotësisht

E. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË TYRE.

1.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, të bëjnë vlerësim objektiv ndërmjet OE-së pjesëmarrës, duke mbajtur parasysh parimet dhe qëllimin e kuadrit ligjor të Prokurimit Publik me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike me efikasitet dhe ekonomikitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Referuar programit të auditimit nr.614/1 prot, datë 30.05.2025 auditim financiar në Bashkinë Devoll nuk është audituar pika e procedurave të prokurimit.

Rekomandimi i mësipër do të rikërkohet përsëri në auditimin e ardhshëm.

Statusi: Pa Zbatuar

2.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të evidentohen të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Referuar programit të auditimit nr.614/1 prot, datë 30.05.2025 auditim financiar në Bashkinë Devoll nuk është audituar pika e procedurave të prokurimit.

Rekomandimi i mësipër do të rikërkohet përsëri në auditimin e ardhshëm.

Statusi: Pa Zbatuar

F. MASA DISIPLINORE.

F. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë Kryetarin të Bashkisë Devoll**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

Z. G.K., me detyrë Drejtor i Agjencisë së Shërbimeve Publike, në cilësinë e hartuesit të kriterëve të kualifikimit, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik në 2 procedura, në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuar në vlerësimin e ofertave, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 1 procedurë prokurimi. (*Shih trajtimin në Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156*).

1. Zj. A.H., me detyrë Specialiste e PAK, në sektorin e Shërbimeve Sociale, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 1 procedurë prokurimi. (*Shih trajtimin në Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156*).

2. Z. N.L., me detyrë kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), në lidhje me problemet dhe parregullsitë e konstatuara, për mos-ushtrimin e inspektimit në objektet e pajisur me leje ndërtimi, për lejimin e zhvillimit të objektit përpara miratimit të

lejes së ndërtimit, si dhe për mosevidentimin e shmangieve nga projekti i miratuar të objekteve të pajisur me leje përdorimi në një rast. *(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 156-167).*

3. Z. F.Ç., me detyrë inspektor pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), në lidhje me problemet dhe parregullsitë e konstatuara, për mos-ushtrimin e inspektimit në objektet e pajisur me leje ndërtimi, për lejimin e zhvillimit të objektit përpara miratimit të lejes së ndërtimit, si dhe për mos-evidentimin e shmangieve nga projekti i miratuar të objekteve të pajisur me leje përdorimi në një rast. *(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 156-167).*

4. Z. J.S., me detyrë inspektor pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), në lidhje me problemet dhe parregullsitë e konstatuara, për mos-ushtrimin e inspektimit në objektet e pajisur me leje ndërtimi, për lejimin e zhvillimit të objektit përpara miratimit të lejes së ndërtimit, si dhe për mos-evidentimin e shmangieve nga projekti i miratuar të objekteve të pajisur me leje përdorimi në një rast. *(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 156-167).*

“Vërejtje” në zbatim të pikës “b” të nenit 58, për 12 punonjës:

5. Znj. T.S., në funksionin e drejtorit pranë Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në lidhje me problemet dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit për **3 (tre)** raste, me problematika si: mosrespektim i kondicioneve urbane në një rast; miratimi i lejeve të ndërtimit me mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqëruar të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj në **3 (tre)** raste; për përllogaritjen e gabuar të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë në **1 (një)** rast; nuk është kërkuar dhe respektuar mendimi i autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit në **2 (dy)** raste. *(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 156-167).*

6. Znj. A.F., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit Financiar: Për mos kuadrimin e llogarisë 520 “Disponibilitet në thesar” me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”. Duke nënvlerësuar llogarinë 520 “Disponibilitet në thesar” në vlerën 20,627,875 lekë. Për arsye se në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë projekti “Përmirësimi i infrastrukturës Shkolla Miras” në vlerën 1,562,000 lekë (kosto historike) i cili nuk duhej të kontabilizohet në këtë llogari pasi investimi për të cilin është hartuar ky projekt ka përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projektit duhet të kishte kaluar në vlerën e investimi për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë. Për mos kuadrimit të shumatores së llogarisë 230 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” me mbylljen e shumatores së llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe llogarisë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë. Për mos kuadrimit të përmbledhëses së llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, 435 “Sigurime shoqërore”, 436 “Sigurime shëndetësore”, 467 “Kreditorë të ndryshëm” e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)”. Për arsye se informacioni kontabël i llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” është nënvlerësuar në vlerën 120,774,784 lekë. *(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 59-90).*

7. Z. E.K., me detyrë përgjegjës i sektorit të Ujitjes dhe Kullimit, në cilësinë e hartuesit të kriterëve të kualifikimit, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 2

procedura prokurimi. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).

8. **Z. K.M.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Transporti të Agjencinë e Shërbimeve Publike, në cilësinë e hartuesit të kritereve të kualifikimit, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 2 procedura prokurimi. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).
9. **Z. M.M.**, me detyrë Drejtor i Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, në cilësinë e hartuesit të kritereve të kualifikimit, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 1 procedurë prokurimi. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).
10. **Z.Th.K.**, me detyrë Specialist në sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e hartuesit të kritereve të kualifikimit, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 1 procedurë prokurimi. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).
11. **Z. F.Z.**, anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).
12. **Znj. M. H.**, anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Oferta(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).ve, për arsye se ka shpallur fitues BOE “A II” ShPK & “N” ShPK, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, me mangësi në dokumentacionin e paraqitur, për procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Bilisht-Vernik Loti II” me fond limit në vlerën 47,802,971.60 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021 nga Bashkia Devoll. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nuk është masë asnjë masë për punonjësit e mësipërm.

Statusi: Pa Zbatuar

Rekomandimet e mëposhtme të cilat do të rikërkohen i përkasin vendimit nr.66, datë 04.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimeve në Bashkinë Devoll”.

Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna sipas vendimit nr.66, datë 04.04.2024 në auditimin e mëparshëm rezultoi se:

-Janë lënë 33 masa organizative dhe janë pranuar plotësisht nga të cilat, 6 masa janë zbatuar, 8 masa janë në proces zbatimi dhe 19 masa nuk janë zbatuar. Nga masat e zbatuara pjesërisht ose të pa zbatuara nuk rikërkohet 6 masë organizative pasi statusi i tyre është reflektuar në auditimin aktual.

- 1 masë shpërbllim dëmi në vlerën **1,428,100 lekë** pa TVSh nuk është zbatuar.

-Për 5 masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, nga të cilat, 1 masë është zbatuar plotësisht, 3 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 1 masë në proces zbatimi.

- 2 masë për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nuk janë zbatuar.

-Për marrjen e 13 masave disiplinore ndaj 13 punonjësve, asnjë prej tyre nuk është zbatuar.

Për masat që janë cilësuar si në proces zbatimi, kërkohet vazhdimi i procedurave për realizimin e tyre. Po ashtu, për masat që nuk janë zbatuar ose janë zbatuar pjesërisht, KLSH rikërkon realizimin e plotë të rekomandimeve, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

21.1. Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Devoll, Përgjegjësi i Prokurimeve si dhe Njësia e Prokurimit, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

Menjëherë dhe në vijimësi

22.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, (komisioni përkatës), të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, përpara hartimit të urdhrimit të prokurimit të aplikojë mënyrën dhe përlllogaritjen e vlerës së kontratës me qëllim dokumentimin dhe argumentimin e saj në përputhje me fondet buxhetore të miratuara. Gjithashtu të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e tekniko-ligjor të përzgjedhjes së procedurës së prokurimit referuar specifikimeve teknike të objektit të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

23.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, (komisioni përkatës), të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, të përcaktojnë saktë sasinë për karburant, duke argumentuar me dokumentacion justifikues dhe provues nevojat e Institucionit.

Titullari i AK të caktojë në komisionet e ngritura, specialist të fushës me qëllim vlerësim sa më objektiv të procesit të prokurimit. Gjithashtu të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e tekniko-ligjor të specifikimeve teknike.

Menjëherë dhe në vijimësi

24.1. Rekomandimi: Bashkia Devoll, Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla të marrë masa që:

-Përgjatë hartimit të regjistrimit të parashikimeve të prokurimeve, të shmangjet mundësia e copëzimit të fondeve për të njëjtin grup mallrash apo shërbimesh.

-Të argumentohen kriteret e veçanta për kualifikim.

-Për çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit publik të respektohet afati i kalimit nga një operatorë ekonomikë tek tjetri në rastet e tërheqjes apo s'kualifikimit të tyre.

-Për rastet që mallrat e prokuruar nuk paraqiten nga operatori ekonomikë brenda afateve të përcaktuara në ftesën për ofertë të bëhet s'kualifikimi i tyre.

-Për çdo rast likuidimi i faturave të kryhet brenda afateve ligjore duke shmangur krijimin e detyrimeve kontraktuale.

Menjëherë dhe në vijimësi

25.1 Rekomandimi: Bashkia Devoll në bashkëpunim me Ujësjellës Kanalizime Devoll ShA dhe sistemin OSHEE të marrë masa të menjëhershme për lidhjen e energjisë elektrike për vendosjen në funksion të sistemit të klorinimit, duke mbajtur në parametrat e kërkuar sasinë e klorit e për rrjedhojë rruajtjen e shëndetit publik dhe uljen e kostove të klorinimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

26.1 Rekomandimi: Nga Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT), Bashkia Devoll të merren masa për respektimin e distancave dhe kondicioneve urbane sipas përcaktimeve ligjore dhe rregullatorë në fuqi, për shqyrtimin e vetëm atyre aplikimeve që kanë informacion të saktë në dokumentacionin shoqëruar, si dhe për të kërkuar në çdo rast evidentimin e përcaktimeve për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapësira publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

27.1 Rekomandimi: Nga SPZHT dhe Bashkia Devoll të merren të gjitha masat për të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose certifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi, si dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi me mangësi të tilla. SPZHT duhet të kërkojë në çdo rast dokumentacionin që vërteton statusin aktiv dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) të subjekteve që kanë hartuar projektin ndërtimor.

Menjëherë dhe në vijimësi

27.2 Rekomandimi: SPZHT dhe Bashkia Devoll të marrin masa për të kontrolluar të gjithë dokumentacionin e dorëzuar mbi saktësinë dhe plotësinë e tij, me qëllim marrjen e të gjithë informacionit të nevojshëm mbi objektin në zhvillim, duke respektuar gjithashtu afatet e përcaktuara në ligj për shqyrtimin e aplikimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

27.3 Rekomandimi: SPZHT dhe Bashkia Devoll të marrin masa për të kërkuar në çdo rast që aplikohet për leje ndërtimi, rifreskimin e kartelave të pasurisë së paluajtshme në më pak se tre muajt e fundit, me qëllim marrjen e sigurisë së mbi pronë nuk janë aplikuar tjetërsime.

Menjëherë dhe në vijimësi

27.4 Rekomandimi: Nga SPZHT dhe Bashkia Devoll të merren të gjitha masat për të shqyrtuar vetëm ato aplikime për leje zhvillimi, të cilat kanë ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, ndër të tjera, edhe projekt-idenë arkitektonike të objektit që kërkohet të zhvillohet, me qëllim dhënien e një vlerësimi të saktë mbi respektimin e kriterëve urbane në varësi të funksionit të saj dhe të përdorimit të tokës, në përputhje me dispozitat ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

28.1 Rekomandimi: Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT) dhe Bashkia Devoll të marrin të gjitha masat për të kërkuar dhe respektuar, në çdo rast që aplikohet për leje ndërtimi, mendimin e autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, me qëllim marrjen e sigurisë së plotë mbi konformitetin e objektit në zhvillim me kriteret, dispozitat, infrastrukturën si dhe projektet e planifikuara të këtyre autoriteteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

29.1 Rekomandimi: Bashkia Devoll, Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT) dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të marrin të gjitha masat për të ushtruar kontroll mbi objektin me leje të miratuar, me vendim për miratim nr. 1442/1 prot; datë 13.05.2022, për verifikimin e situatës, në lidhje me objektet e evidentuara si objekte të paparashikuara në lejen e ndërtimit, si dhe për verifikimin e situatës për ndryshimin e pozicionit të objektit ndihmës funksional, si dhe nisjen e procedurave administrative ndaj kundërvajtësve. Në rast se zhvilluesi aplikon për pajisje me certifikatë përdorimi, SPZHT dhe Bashkia Devoll të marrin masa për miratimin e aplikimit, vetëm pasi të vërtetohet përputhshmëria e objektit të ndërtuar me projektin e miratuar në lejen e ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

29.2 Rekomandimi: Bashkia Devoll, Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, si dy struktura përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme, por edhe kontrollin e zbatimit të objekteve të ndërtuara me leje apo në shkelje të saj, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga kuadri ligjor në fuqi, të marrin të gjitha masat për të rritur bashkëpunimin ndër-institucional në lidhje me kryerjen e inspektimeve përpara miratimit të lejeve të ndërtimit, si dhe gjatë ndërtimit dhe para procesit të certifikimit të objektit, me qëllim minimizimin e rasteve kur zhvilluesi nis ndërtimin e objektit

përpara miratimit të lejes së ndërtimit, ose kur objekti i miratuar nuk është i njëjtë me atë të ndërtuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1.1 Rekomandimi: Bashkia Devoll të marrë masa, për arkëtimin e shumës 1,428,100 lekë pa TVSh, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE “Z” ShPK & “K” ShPK sipas kontratës së lidhur me Nr. 3322 Prot., datë 10.01.2020 për realizimin e punimeve civile.

E. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË TYRE.

1.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, të bëjnë vlerësim objektiv ndërmjet OE-së pjesëmarrës, duke mbajtur parasysh parimet dhe qëllimin e kuadrit ligjor të Prokurimit Publik me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike me efikasitet dhe ekonomikitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të evidentohen të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

F. MASA DISIPLINORE.

F. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

1. Z. G.K., me detyrë Drejtor i Agjencisë së Shërbimeve Publike, në cilësinë e hartuesit të kriterëve të kualifikimit, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik në 2 procedura, në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuar në vlerësimin e ofertave, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 1 procedurë prokurimi. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).

2. Zj. A.H., me detyrë Specialiste e PAK, në sektorin e Shërbimeve Sociale, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 1 procedurë prokurimi. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).

3. Z. N.L., me detyrë kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), në lidhje me problemet dhe parregullsitë e konstatuara, për mos-ushttrimin e inspektimit në objektet e pajisur me leje ndërtimi, për lejimin e zhvillimit të objektit përpara miratimit të lejes së ndërtimit, si dhe për mosevidentimin e shmangieve nga projekti i miratuar të objekteve të pajisur me leje përdorimi në një rast. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 156-167).

4. Z. F.Ç., me detyrë inspektor pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), në lidhje me problemet dhe parregullsitë e konstatuara, për mos-ushttrimin e inspektimit në objektet e pajisur me leje ndërtimi, për lejimin e zhvillimit të objektit përpara miratimit të lejes së ndërtimit, si dhe për mos-evidentimin e shmangieve nga projekti i miratuar të objekteve të pajisur me leje përdorimi në një rast. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 156-167).

5. Z. J.S., me detyrë inspektor pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), në lidhje me problemet dhe parregullsitë e konstatuara, për mos-ushtimin e inspektimit në objektet e pajisur me leje ndërtimi, për lejimin e zhvillimit të objektit përpara miratimit të lejes së ndërtimit, si dhe për mos-evidentimin e shmangieve nga projekti i miratuar të objekteve të pajisur me leje përdorimi në një rast. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 156-167).

“Vërejtje” në zbatim të pikës “b” të nenit 58, për 12 punonjës:

6. Znj. T.S., në funksionin e drejtorit pranë Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në lidhje me problemet dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit për 3 (tre) raste, me problematika si: mosrespektim i kondicioneve urbane në një rast; miratimi i lejeve të ndërtimit me mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqëruar të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj në 3 (tre) raste; për përllogaritjen e gabuar të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë në 1 (një) rast; nuk është kërkuar dhe respektuar mendimi i autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit në 2 (dy) raste. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 156-167).

7. Znj. A.F., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit Financiar: Për mos kuadrin e llogarisë 520 “Disponibilitet në thesar” me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtimore” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”. Duke nënvlerësuar llogarinë 520 “Disponibilitet në thesar” në vlerën 20,627,875 lekë. Për arsye se në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë projekti “Përmirësimi i infrastrukturës Shkolla Miras” në vlerën 1,562,000 lekë (kosto historike) i cili nuk duhej të kontabilizohet në këtë llogari pasi investimi për të cilin është hartuar ky projekt ka përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projektit duhet të kishte kaluar në vlerën e investimi për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë. Për mos kuadrin të shumatores së llogarisë 230 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” me mbylljen e shumatores së llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe llogarisë 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë. Për mos kuadrin të përmbledhësës së llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, 435 “Sigurime shoqërore”, 436 “Sigurime shëndetësore”, 467 “Kreditorë të ndryshëm” e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)”. Për arsye se informacioni kontabël i llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” është nënvlerësuar në vlerën 120,774,784 lekë. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 59-90).

8. Z. E.K., me detyrë përgjegjës i sektorit të Ujitjes dhe Kullimit, në cilësinë e hartuesit të kriterëve të kualifikimit, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 2 procedura prokurimi. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).

9. Z. K.M., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Transportit të Agjencinë e Shërbimeve Publike, në cilësinë e hartuesit të kriterëve të kualifikimit, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 2 procedura prokurimi. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).

10. Z. M.M., me detyrë Drejtor i Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, në cilësinë e hartuesit të kriterëve të kualifikimit, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 1 procedurë prokurimi. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).

11. Z.Th.K., me detyrë Specialist në sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e hartuesit të kriterëve të kualifikimit, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 1 procedurë prokurimi. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).

12. Z. F.Z., anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).

13. Znj. M.H., anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Oferta(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).ve, për arsye se ka shpallur fitues BOE “A II” ShPK & “N” ShPK, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, me mangësi në dokumentacionin e paraqitur, për procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Bilisht-Vernik Loti II” me fond limit në vlerën 47,802,971.60 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021 nga Bashkia Devoll. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).

Menjëherë dhe në vijimësi

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se, nuk është bërë mjaftueshëm në lidhje me:

“Mjedisi i Kontrollit”

- Nuk ka trajnim të dedikuar për etikën dhe integritetin si dhe nuk ka program të mirëfilltë trajnimi për kontrollin e brendshëm dhe për menaxhimin financiar për punonjësit e bashkisë.
- Nuk ka plane të veprimit për korrigjimin e mangësive në sistemin e kontrollit të brendshëm.
- Mungon përfaqësuesi i drejtuesit të auditit të brendshëm (pa të drejtë vote në vendimmarrje) në përbërjen e Grupit për Menaxhimin Strategjik.
- Nga verifikimi i kryer rezulton se Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) nuk ka marrë vendime të dokumentuara për zbutjen e ndikimit të rreziqeve të evidentuara në një nivel të pranueshëm. Kjo tregon se nuk janë adresuar në mënyrë të plotë kërkesat e Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK). Për më tepër, janë dokumentuar vetëm dy mbledhje të GMS-së gjatë vitit, në kundërshtim me udhëzimin përkatës që parashikon të paktën katër mbledhje në vit.
- Është evidentuar vetëm një urdhër për delegimin e detyrave, pa një sistem të qartë dhe të dokumentuar të delegimit të përgjegjësive në njësinë përkatëse.
- Nuk janë përcaktuar rregulla apo procedura të shkruara për aksesin në informacion të klasifikuar, duke rrezikuar kështu sigurinë dhe integritetin e këtij informacioni.

“Menaxhimin e Riskut”

- Nuk është kryer vlerësimi i riskut të mashtrimit dhe mungojnë politika e procedura për parandalimin e tij.
- Në rregulloren e brendshme nuk janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit dhe grupit të menaxhimit të riskut.
- Është hartuar Rregjistri i Riskut për vitin 2024, por nuk është realizuar përditësimi i riskut dy herë në vit.

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Proceset dhe procedurat e punës janë përcaktuar përgjithësisht në rregulloren e brendshme dhe për disa struktura, por vetëm Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore disponojnë manuale të proceseve të punës të miratuara nga Kryetari i Bashkisë, ndërsa mungojnë në strukturat e tjera, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.
- Mungojnë procedura të përshtatshme për menaxhimin e IT-së dhe ruajtjen e të dhënave, si dhe një plan i menaxhimit të riskut IT dhe rikuperimit e të dhënave në raste fatkeqësish.
- Nuk është ngritur Komisioni i Ekspertizës; nuk është kryer miratimi i listës së dokumentave shtetërore që administron institucioni dhe afatet e ruajtjes së tyre.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 3, pika 4; nuk ka një koordinator të deleguar të menaxhimit financiar e kontrollit, në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 10, ligjit nr.9154, datë 16.11.2023 “Për Arkivat” si dhe neneve 32, 33 të “Normave Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në RSH”. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1, faqe 13-25, të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Bashkia Devoll nëpërmjet strukturave përgjegjëse duhet të masa për të organizuar trajnime të rregullta mbi etikën, integritetin dhe kontrollin e brendshëm për stafin. Kryetari i Bashkisë të caktojë një koordinator për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të hartojë e miratojë manuale pune për njësitë strukturore, si dhe të sigurojë miratimin dhe zbatimin e gjurmës së auditimit për çdo drejtori, në përputhje me kërkesat ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2. Rekomandimi: Bashkia Devoll, nëpërmjet Sektorit të IT-së, të hartojë e miratojë rregullore për menaxhimin e IT-së dhe sigurinë e të dhënave, si dhe të krijojë një sistem të qartë monitorimi dhe raportimi për ndjekjen e objektivave dhe për rritjen e efektivitetit të kontrollit të brendshëm në të gjitha nivelet

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Devoll, u konstatuan këto problematika kryesore:

- Nuk është kryer vlerësimi i riskut për fushën/sistemin e llogarisë të kombinuar me mjedisin e kontrollit, duke penguar përcaktimin e nivelit të përgjithshëm të riskut dhe planifikimin e saktë të auditimit (format standard 4,5).

- Mungojnë testet individuale të auditimit (formati nr.9), e cila sjell risk për mos identifikimin e problemeve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm kapitulli 3 “Planifikimi i veprimtarive të auditit të brendshëm”, pika 3.1.2. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1, faqe 25-31, të Raportit të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm të marrë masa të përmirësive planifikimin e auditimeve përmes një frekuence të rregullt në të gjitha njësitë, vlerësimi të riskut dhe mjedisit të kontrollit, dhe përdorimit të testeve individuale për dokumentim më të mirë. Të vendoset sistem monitorimi dhe vetëvlerësimi periodik, si dhe të përcaktohen afate të qarta për zbatimin e rekomandimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” për vitin 2024.

Grupi i auditimit konstatoi se amortizimi i aktiveve të kontabilizuara në llogarinë 202 "Studime dhe Kërkime" është përlllogaritur në mënyrë jo të saktë, pasi nuk është zbatuar norma e parashikuar prej 15% sipas metodës lineare por është aplikuar norma 5% mbi vlerën e mbetur. Ky trajtim kontabël i pasaktë ka sjellë:

- nënvlerësim të amortizimit;
- mbivlerësim të vlerës neto kontabël në llogarinë 202;

Si pasojë, edhe mbivlerësim të vlerave të transferuara në llogaritë 212 “Ndërtesa dhe Konstrukione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” për projektet e zbatuara. Këto vlera janë reflektuar edhe në pasqyrën e pozicionit financiar në veçanti, kalimi i projekteve në zbatim me një vlerë të mbetur të llogaritur gabimisht, ka ndikuar në mbivlerësimin e aktiveve afatgjata, duke

evidentuar pasaktësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36, i ndryshuar. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 31-51, të Raportit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Devoll të kryejë saktë amortizimin e llogarisë së klasës 2, për të pasur informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2024, rezulton se:

Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstrukione” është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 681,918,447 lekë.

Nga auditimi i llogarisë u verifikua se në këtë llogari janë kontabilizuar 10 aktive me vlerë neto kontabël 119,680,203 lekë të cilat nuk janë aktive në posedim të Bashkisë Devoll. Këto janë asete në pronësi të komunitetit të cilët nëpërmjet programeve të ndryshme sociale janë përfitues të investimeve nga grante të ndryshme për rikonstruksionin e banesave të tyre.

Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme” , kapitulli 2, trajtimet kontabël për AAGJM, i ndryshuar. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 31-51, të Raportit të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kryejë një analizë të detajuar të dokumentacionit financiar dhe ligjor të të dhënave për llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstrukione”. Gjatë vitit 2025 të marrë masa për sistemimin e vlerës 119,680,203 lekë

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se gjendja e llogarive 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqitet në vlerën 8,095,000 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2024 paraqitet në vlerën 42,085,797 lekë.

Nga auditimi u konstatua se në Bashkinë Devoll janë 36 kontrata në proces, me vlerë kontrate 313,198,535 lekë. Nga këto kontrata, deri në datën 31.12.2024 janë realizuar punime në vlerën 273,652,147 lekë dhe vlera e mbetur e pa realizuar është në shumën 42,085,797 lekë. Referuar analizës së mësipërme llogaria 231 duhet të paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 273,652,147 lekë, kjo llogari është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën 42,085,797 lekë, e cila është vlera e pa realizuar e kontratave. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, trajtimet kontabël për AAGJM, i ndryshuar. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 31-51, të Raportit të Auditimit).

5.1. Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit, pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” me kundërparti llogaritë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme”, 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 “Fondi Bazë”.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Devoll më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 26,089,133 lekë ndërsa në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 13,146,699 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Për 5 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Devoll janë ngurtësuar fonde në vlerën 1,312,900 lekë. Për këto investime nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Korçë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve, sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Projekteve dhe Investimeve dhe Drejtoria e Financës nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 1,312,900 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 31-51 të Raportit të Auditimit).*

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Projekteve dhe Investimeve, të marrin masa, për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466 dhe duke njoftuar subjektet, për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm, për të sistemuar dhe zhbllokuar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Devoll së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2024, kanë diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2024, planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken ka vlerën 586,577 mijë lekë buxheti i rishikuar ka vlerën 744,774 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 604,121 mijë lekë ose në masën 81.1 %. Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 348,740 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 297,766 mijë lekë ose në masën 85%.

Zëri shpenzime operative (602) është planifikuar në vlerën 246,434 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 175,332 mijë lekë ose në masën 71%.

Zëri transfertat buxhete familjare është planifikuar në vlerën 21,896 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 20,076 mijë lekë ose në masën 98 %.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230*231) është planifikuar në vlerën 127,704 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 110,947 mijë lekë ose në masën 86%.

Mosrealizimit i të ardhurave, do të thotë se nga Bashkia Devoll në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 39, i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 9, pika 1.3, gërma “c” dhe “ç”, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, VKB përkatëse. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2 , faqe 31-51, të Raportit të Auditimit).*

7.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Devoll, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi

të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2024 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore është në vlerën 197,082 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 143,793 mijë lekë ose në masën 72 % me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 53,289 mijë lekë. Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulëta, kurse për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin. Kjo tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura të debitorëve. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nën-pika “c”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200. (Më hollësisht trajtuar në nën-pikën 2.2, faqe 31-51 të Raportit të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifatat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2024, mbështetur dhe në UMF 30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar, nga ana e titullarit të bashkisë është miratuar urdhri nr.607 datë 12.11.2024 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit, vlerësimit të aktiveve dhe të nxjerrjes jashtë përdorimit për vitin 2024” të Bashkisë Devoll, ku janë përcaktuar ngritja e 3 grupe te ndryshme sipas përgjegjësi.

Nga komisioni i ngritur për inventarizimin dhe vlerësimin nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi për aktivet e kontabilizuara në llogaritë 210 “Toka, Troje, Terrene”, 211 “Pyje, Kullota, 212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” pika 85. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 31-51 të Raportit të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Bashkia Devoll në çdo rast të kryerjes së inventarizimit të aktiveve, duhet të vlerësojë të gjitha aktive të cilat janë posedim të saj.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” e cila në datën 31.12.2023 paraqiten në vlerën 66,664,236 lekë, vlera e llogarisë 468 në datën 31.12.2024 është paraqitur në vlerën 66,664,236 lekë. Nga analiza e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk kemi

informacion të detajuar për detyrimet që janë konstatuar, si për vitin korrent 2024, por edhe për vitet e mëparshme.

Gjatë vitit 2024 nuk ka pasur shtesa llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” sepse informacioni i përcjell nga Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve, Licencave dhe Borxhit është refuzuar me shkresë nga Drejtoria e Financës me argumentin se informacioni i paraqitur është me mangësi.

Referuar shkresës me nr.906., prot, datë 07.03.2025 nga Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve, Liçencave dhe Borxhit shtesat e borxhit për vitin 2024 për abonentët familjarë dhe biznes janë në vlerën 17,003,191 lekë.

Moskontabilizimi i debitorëve në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” sjell risk të lartë për mosparaqitjen e informacionit të plotë dhe të saktë dhe mund të sjellë tejkalim të afateve ligjore për kërkimin e detyrimit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, shkronja “ë”, pika 3, neni 12, udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja “c”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 31-51, të Raportit të Auditimit)

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Devoll, të marrë masat e nevojshme, që të kryejë vlerësimin dhe kontabilizimi e plotë dhe të saktë të të drejtave të Bashkisë, për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr. 470 “Të ardhura për t’u marrë”.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Devoll në datën 01.01.2024 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta dhe granti në vlerën 93,897,067 lekë.

Gjatë vitit 2024 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 6,652,675 lekë dhe janë likuiduar detyrime në vlerën 93,475,109 lekë. Totali progresiv i detyrimeve të prapambetura në datë 31.12.2024 është në vlerën 7,074,633 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 56 “Vështirësia Financiare”, Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2 , faqe 31-51, të Raportit të Auditimit).

11.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Devoll, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrin masa, që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se:

Vendimi nr.193, datë 07.10.2024:

- Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 13 masa organizative dhe janë pranuar plotësisht nga të cilat, 4 masa janë zbatuar, 5 masa në proces zbatimi dhe 4 masa nuk është zbatuar. Nga masat e zbatuara pjesërisht ose të pa zbatuara nuk rikërkohet 2 masë organizative pasi statusi i tyre është reflektuar në auditimin aktual.

-Për 5 masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, nga të cilat, 1 masë është zbatuar plotësisht, 3 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 1 masë në proces zbatimi.

- 1 masë për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore. Kjo masë është zbatuar pjesërisht e cila nuk do të rikërkohet sepse është reflektuar në auditimin aktual.

-Për marrjen e 9 masave disiplinore ndaj 9 punonjësve, asnjë prej tyre nuk është zbatuar Nisur nga sa më sipër, *veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 15, "Të drejtat e KLSH" të ligjit Nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". (Më hollësisht trajtuar në anekset e raportit të auditimit, faqe 68-101).*

Vendimi nr.66, datë 04.04.2025:

- Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 33 masa organizative dhe janë pranuar plotësisht nga të cilat, 6 masa janë zbatuar, 8 masa janë në proces zbatimi dhe 19 masa nuk janë zbatuar. Nga masat e zbatuara pjesërisht ose të pa zbatuara nuk rikërkohet 6 masë organizative pasi statusi i tyre është reflektuar në auditimin aktual.

- 1 masë shpërblim dëmi në vlerën **1,428,100 lekë** pa TVSh nuk është zbatuar.

-Për 5 masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, nga të cilat, 1 masë është zbatuar plotësisht, 3 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 1 masë në proces zbatimi.

- 2 masë për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nuk janë zbatuar.

-Për marrjen e 13 masave disiplinore ndaj 13 punonjësve, asnjë prej tyre nuk është zbatuar.

Për masat që janë cilësuar si në proces zbatimi, kërkohet vazhdimi i procedurave për realizimin e tyre janë pasqyruar të grupuara sipas llojit të tyre, **në anekset e projekt raportit të auditimit**. (Më hollësisht trajtuar në anekset e raportit të auditimit, faqe 68-101).

12.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Devoll të analizojë situatën e zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe përshpejtimin e rekomandimeve në proces zbatimi si më poshtë:

a) Sipas vendimit nr.193, datë 07.10.2024 rikërkohen masat si mëposhtë:

- Për 2 masa organizative.

- Për 3 masa për eliminimin e efekteve negative të zbatuara.

- Për 9 masa disiplinore.

Sipas vendimit nr.66, datë 04.04.2025 rikërkohen masat si mëposhtë:

- Për 13 masa organizative.

- Për 1 masë shpërblim dëmi.

- Për 2 masa për eliminimin e efekteve negative të zbatuara.

- Për 12 masa disiplinore.

Sipas vendimit nr.193, datë 07.10.2024 rikërkohen masat si mëposhtë:

6.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të merren masa për hartimin e regjistrit të taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës dhe të marrë masa për të krijuar një inventar të integruar për ish-komunat dhe për të koordinuar me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës me qëllim miratimin e inventarëve përfundimtare dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH

1.1 Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të marrë masa për kontabilizimin e detyrimit si dhe të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri më datën 31.12.2023, në **vlerën totale 30,285,206 lekë**, e cila përbëhet nga:

-15,863,278 lekë detyrime nga **abonentët familjarë**;

-14,421,928 lekë detyrime nga **biznesi i madh**;

a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Devoll, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Liçensave dhe Lejeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit të Pyjeve, Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Financë Buxhetit, të marrin masa për kontabilizimin e detyrimit si dhe të ndjek të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimit 4,907,240 lekë sipas aneksit nr. 2 pika 5 bashkëlidhur Rapiritit Përfundimtar të Auditimit.

3.2.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Liçensave dhe Lejeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit të Pyjeve, Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Financë Buxhetit, të të ndjek të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimit për qiranë e pa llogaritur dhe papaguar në shumë **21,171,780 lekë**, respektivisht:

-vlera 1,150,000 lekë nga shoqëria "V" sha;

-vlera 300,000 lekë nga shoqëria "I 02" SHPK;

-vlera 2,482,980 lekë nga shoqëria "M. HEC-Qytezë" SHPK;

-vlera 17,238,800 lekë nga shoqëria "K 93" SHPK.

Brenda datës 31.12. 2024

D. MASA DISIPLINORE.

Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Devoll**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a- Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, sipas gurmës “c” e nenit 58, për 3 (tre) punonjësit e mëposhtëm:

1. Znj. A.F., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit Financiar, për mos kuadrim të shumatores së llogarisë 230 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” me mbylljen e shumatores së llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe llogarisë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë. Për mos kuadrim të përmbledhëses së llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, 435 “Sigurime shoqërore”, 436 “Sigurime shëndetësore”, 467 “Kreditorë të ndryshëm” e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)”. Për arsye se informacioni kontabël i llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është nënvlerësuar në vlerën 120,774,784 lekë. *(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 59-90).*

2. Z. G.H., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave.

3. Znj. D.R., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Kontabilizimit të të Ardhurave.

4. Znj. V.B., me detyrë specialiste Sektorit i Kontabilizimit të të Ardhurave.

5. Z. I.D., me detyrë Përgjegjës Sektori i Inspektoriatit Tatimor, Kundravajtjeve Administrative, Debitorëve, Konfiskimi dhe Sekuestrimi.

6. Z. G.M., me detyrë specialist i Sektorit të Kontabilizimit të të Ardhurave

Për mos ndjekjen e të gjitha rrugëve për arkëtimin e detyrimeve nga taksat dhe tatimet për debitorët në vlerën **58,553,508** lekë. Për mos mbajtjen e regjistrave për abonentët familjarë dhe biznesit. Për tarifimin jo të saktë të taksës së ndërtesës dhe të truallit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-38 të Raportit të Auditimit).*

7. Z. E.R., me detyrë përgjegjësi i sektorit të aseteve për mangësit e konstatuara në përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpuniminndërmjet institucioneve – ASHK.

E. Për punonjësit **zj. A.K.**, me detyrë përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Brendshëm dhe **E.Sh.**, me detyrë specialist ne Auditimin e Brendshëm nuk rekomandojmë masë disiplinore për arsye se shkeljet e konstatuara janë të një rëndësie të ulët dhe nuk janë materiale.

Sipas vendimit nr.66, datë 04.04.2024 rikërkohen masat si më poshtë:

21.1. Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Devoll, Përgjegjësi i Prokurimeve si dhe Njësia e Prokurimit, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

Menjëherë dhe në vijimësi

22.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, (komisioni përkatës), të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, përpara hartimit të urdhrat të prokurimit të aplikojë mënyrën dhe përlllogaritjen e vlerës së kontratës me qëllim dokumentimin dhe argumentimin e saj në përputhje me fondet buxhetore të miratuara. Gjithashtu të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e tekniko-ligjor të përzgjedhjes së procedurës së prokurimit referuar specifikimeve teknike të objektit të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

23.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, (komisioni përkatës), të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, të përcaktojnë saktë sasinë për karburant, duke argumentuar me dokumentacion justifikues dhe provues nevojat e Institucionit.

Titullari i AK të caktojë në komisionet e ngritura, specialist të fushës me qëllim vlerësim sa më objektiv të procesit të prokurimit. Gjithashtu të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e tekniko-ligjor të specifikimeve teknike.

Menjëherë dhe në vijimësi

24.1. Rekomandimi: Bashkia Devoll, Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla të marrë masa që:

-Përgjatë hartimit të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve, të shmanget mundësia e copëzimit të fondeve për të njëjtin grup mallrash apo shërbimesh.

-Të argumentohen kriteret e veçanta për kualifikim.

-Për çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit publik të respektohet afati i kalimit nga një operatorë ekonomikë tek tjetri në rastet e tërheqjes apo s'kualifikimit të tyre.

-Për rastet që mallrat e prokuruar nuk paraqiten nga operatori ekonomikë brenda afateve të përcaktuara në ftesën për ofertë të bëhet s'kualifikimi i tyre.

-Për çdo rast likuidimi i faturave të kryhet brenda afateve ligjore duke shmangur krijimin e detyrimeve kontraktuale.

Menjëherë dhe në vijimësi

25.1 Rekomandimi: Bashkia Devoll në bashkëpunim me Ujësjellës Kanalizime Devoll ShA dhe sistemin OSHEE të marrë masa të menjëhershme për lidhjen e energjisë elektrike për vendosjen në funksion të sistemit të klorinimit, duke mbajtur në parametrat e kërkuar sasinë e klorit e për rrjedhojë rruajtjen e shëndetit publik dhe uljen e kostove të klorinimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

26.1 Rekomandimi: Nga Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT), Bashkia Devoll të merren masa për respektimin e distancave dhe kondicioneve urbane sipas përcaktimeve ligjore dhe rregullatorë në fuqi, për shqyrtimin e vetëm atyre aplikimeve që kanë informacion të saktë në dokumentacionin shoqëruar, si dhe për të kërkuar në çdo rast evidentimin e përcaktimeve për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapësira publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

27.1 Rekomandimi: Nga SPZHT dhe Bashkia Devoll të merren të gjitha masat për të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose certifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqëruar të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi, si dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi me mangësi të tilla. SPZHT duhet të kërkojë në çdo rast dokumentacionin që vërteton statusin aktiv dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) të subjekteve që kanë hartuar projektin ndërtimor.

Menjëherë dhe në vijimësi

27.2 Rekomandimi: SPZHT dhe Bashkia Devoll të marrin masa për të kontrolluar të gjithë dokumentacionin e dorëzuar mbi saktësinë dhe plotësinë e tij, me qëllim marrjen e të gjithë

informacionit të nevojshëm mbi objektin në zhvillim, duke respektuar gjithashtu afatet e përcaktuara në ligj për shqyrtimin e aplikimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

27.3 Rekomandimi: SPZHT dhe Bashkia Devoll të marrin masa për të kërkuar në çdo rast që aplikohet për leje ndërtimi, rifreskimin e kartelave të pasurisë së paluajtshme në më pak se tre muajt e fundit, me qëllim marrjen e sigurisë së mbi pronë nuk janë aplikuar tjetërsime.

Menjëherë dhe në vijimësi

27.4 Rekomandimi: Nga SPZHT dhe Bashkia Devoll të merren të gjitha masat për të shqyrtuar vetëm ato aplikime për leje zhvillimi, të cilat kanë ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, ndër të tjera, edhe projekt-idenë arkitektonike të objektit që kërkohet të zhvillohet, me qëllim dhënien e një vlerësimi të saktë mbi respektimin e kriterëve urbane në varësi të funksionit të saj dhe të përdorimit të tokës, në përputhje me dispozitat ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

28.1 Rekomandimi: Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT) dhe Bashkia Devoll të marrin të gjitha masat për të kërkuar dhe respektuar, në çdo rast që aplikohet për leje ndërtimi, mendimin e autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, me qëllim marrjen e sigurisë së plotë mbi konformitetin e objektit në zhvillim me kriteret, dispozitat, infrastrukturën si dhe projektet e planifikuara të këtyre autoriteteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

29.1 Rekomandimi: Bashkia Devoll, Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT) dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të marrin të gjitha masat për të ushtruar kontroll mbi objektin me leje të miratuar, me vendim për miratim nr. 1442/1 prot; datë 13.05.2022, për verifikimin e situatës, në lidhje me objektet e evidentuara si objekte të paparashikuara në lejen e ndërtimit, si dhe për verifikimin e situatës për ndryshimin e pozicionit të objektit ndihmës funksional, si dhe nisjen e procedurave administrative ndaj kundërvajtësve. Në rast se zhvilluesi aplikon për pajisje me certifikate përdorimi, SPZHT dhe Bashkia Devoll të marrin masa për miratimin e aplikimit, vetëm pasi të vërtetohet përputhshmëria e objektit të ndërtuar me projektin e miratuar në lejen e ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

29.2 Rekomandimi: Bashkia Devoll, Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, si dy struktura përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme, por edhe kontrollin e zbatimit të objekteve të ndërtuara me leje apo në shkelje të saj, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga kuadri ligjor në fuqi, të marrin të gjitha masat për të rritur bashkëpunimin ndër-institucional në lidhje me kryerjen e inspektimeve përpara miratimit të lejeve të ndërtimit, si dhe gjatë ndërtimit dhe para procesit të certifikimit të objektit, me qëllim minimizimin e rasteve kur zhvilluesi nis ndërtimin e objektit përpara miratimit të lejes së ndërtimit, ose kur objekti i miratuar nuk është i njëjtë me atë të ndërtuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1.1 Rekomandimi: Bashkia Devoll të marrin masa, për arkëtimin e shumës **1,428,100 lekë** pa TVSh, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit nga BOE “Z” ShPK & “K” ShPK sipas kontratës së lidhur me Nr. 3322 Prot., datë 10.01.2020 për realizimin e punimeve civile.

Menjëherë dhe në vijimësi

E. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË TYRE.

1.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, të bëjnë vlerësim objektiv ndërmjet OE-së pjesëmarrës, duke mbajtur parasysh parimet dhe qëllimin e kuadrit ligjor të Prokurimit Publik me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike me eficientë dhe ekonomikitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të evidentohen të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

F. MASA DISIPLINORE

F. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

1. Z. G.K., me detyrë Drejtor i Agjencisë së Shërbimeve Publike, në cilësinë e hartuesit të kriterëve të kualifikimit, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik në 2 procedura, në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuar në vlerësimin e ofertave, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 1 procedurë prokurimi. (Shih trajtimin në Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).

2. Zj. A.H., me detyrë Specialiste e PAK, në sektorin e Shërbimeve Sociale, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 1 procedurë prokurimi. (Shih trajtimin në Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).

3. Z. N.L., me detyrë kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), në lidhje me problemet dhe parregullsitë e konstatuara, për mos-ushtimin e inspektimit në objektet e pajisur me leje ndërtimi, për lejimin e zhvillimit të objektit përpara miratimit të lejes së ndërtimit, si dhe për mosevidentimin e shmangieve nga projekti i miratuar të objekteve të pajisur me leje përdorimi në një rast. (Shih trajtimin në Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 156-167).

4. Z. F.Ç., me detyrë inspektor pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), në lidhje me problemet dhe parregullsitë e konstatuara, për mos-ushtimin e inspektimit në objektet e pajisur me leje ndërtimi, për lejimin e zhvillimit të objektit përpara miratimit të lejes së ndërtimit, si dhe për mos-evidentimin e shmangieve nga projekti i miratuar të objekteve të pajisur me leje përdorimi në një rast. (Shih trajtimin në Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 156-167).

5. Z. J.S., me detyrë inspektor pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), në lidhje me problemet dhe parregullsitë e konstatuara, për mos-ushtimin e inspektimit në objektet e pajisur me leje ndërtimi, për lejimin e zhvillimit të objektit përpara miratimit të lejes së ndërtimit, si dhe për mos-evidentimin e shmangieve nga projekti i miratuar të objekteve të pajisur me leje përdorimi në një rast. (Shih trajtimin në Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 156-167).

“Vërejtje” në zbatim të pikës “b” të nenit 58, për 12 punonjës:

6. Znj. T.S., në funksionin e drejtorit pranë Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në lidhje me problemet dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit për 3 (tre) raste, me problematika si: mosrespektim i kondicioneve urbane në një rast; miratimi i lejeve të ndërtimit me mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj në 3 (tre) raste; për përlllogaritjen e

gabuar të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë në 1 (një) rast; nuk është kërkuar dhe respektuar mendimi i autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit në 2 (dy) raste. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 156-167).

7. Z. E.K., me detyrë përgjegjës i sektorit të Ujitjes dhe Kullimit, në cilësinë e hartuesit të kriterëve të kualifikimit, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 2 procedura prokurimi. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).

8. Z. K.M., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Transporti të Agjencinë e Shërbimeve Publike, në cilësinë e hartuesit të kriterëve të kualifikimit, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 2 procedura prokurimi. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).

9. Z. M.M., me detyrë Drejtor i Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, në cilësinë e hartuesit të kriterëve të kualifikimit, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 1 procedurë prokurimi. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).

10. Z.Th.K., me detyrë Specialist në sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e hartuesit të kriterëve të kualifikimit, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 1 procedurë prokurimi. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).

11. Z. F.Z., anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).

1. Znj. M.H., anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Oferta(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).ve, për arsye se ka shpallur fitues BOE “A II” ShPK & “N” ShPK, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, me mangësi në dokumentacionin e paraqitur, për procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Bilisht-Vernik Loti II” me fond limit në vlerën 47,802,971.60 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021 nga Bashkia Devoll. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).

Menjëherë dhe në vijimësi

b). Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të rikërkohen në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.